

**DRAFT**

**Raporti Nr: 28023-KOS**

*Memorandumi Ekonomik  
i KOSOVËS*

**27 Prill 2004**

Njësia e Pakësimit të Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik  
Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore



**Dokument i Bankës Botërore**

## Valuta dhe Ekuivalentet

Njësia valutore US\$1 = €1.24  
(me 2 Mars, 2004)

## Viti Fiskal

1 Janar – 31 Dhjetor

## Akronimet dhe Shkurtime

AABPN	Anketimi i Ambjentit të Biznesit dhe Performacës së Ndërmarrjeve	NPP	Ndërmarrje me Pronësi Publike
AER	Agjensioni European për Rindërtim	NPSH	Ndërmarrje me Pronësi Shoqërore
AFP	Anketimi i Fuqisë Punëtore	NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
AKB	Të Ardhurat Kombëtare Bruto	NjQR	Njësia Rregullatore Qëndrore
AKBD	Të Ardhurat Kombëtare Bruto pas Pagesës së Taksave (në dispozicion)	OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
AKM	Agjensia Kosovare e Mirëbesimit	OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
AMSJ	Anketimi i Matjes së Standarteve të Jetesës	OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
ATM	Makinat për Tërheqjen e Parave	OPIC	Korporata për Investime Private Jashtë Shtetit
BE	Bashkimi Europian	PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	PES	Pikë e Shitjes
BPK	Autoriteti i Pagesave Bankare të Kosovës	PIP	Programi i Investimeve Publike
IHD	Investimet e Huaja Direkte	RFS	Republika Federale Socialiste e Jugosllavisë
IMF	Institucionet Mikrofinanciare	SATC	Standardet e Aftësive/ Punësimit, Sistemi i Testimit dhe Certifikimit
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes	SIMA	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Arsimor
IRJ	Ish-Republika Jugosllave e Macedonia	SITP	Sistemi i Informacionit të Tregut të Punës
KB	Kombet e Bashkuara	SMZ	Serbia dhe Mali i Zi
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës	ShEK	Shoqata e Eksportit e Kosovës
LK	Letra Krediti	ShZhN	Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	Tarifa KMF	Tarifa për Kombin më të Favorizuar
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	TKPK	Trusti i Kursimeve Private të Kosovës
MEK	Memorandumi Ekonomik i Kosovës	TREEJ	Tregu Rajonal i Energjisë për Europën JugLindore
MIGA	Agjensia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve	TVSH	Taksa e Vlerës së Shtuar
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale	UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MTL	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë		

Zëvendëspresident:	Shigeo Katsu (ECAVP)
Drejtori për vendin:	Orsalia Kalantzopoulos (ECCU4)
Drejtori i Sektorit:	Cheryl W. Gray (ECSPE)
Menaxheri i Sektorit:	Bernard Funck (ECSPE)
Menaxherja e Punimit:	Tracey Lane (ECSPE)

## **Njohje dhe Falenderime**

Ky raport u përgatit nga një ekip qëndror i përbërë nga Tracey Lane (drejtuesja e punës), Stuart Bell, Juan Carlos Ginarte, Mohinder Gulati, Silvia Minotti and Nand Shani. Kontribute specifike dhe dokumentet bazë u përgatitën nga Constantine Michalopoulos, Vassellios Panousopoulos (tregti), Jeanine Braithwaite (tregu i punës), Marvin Lamoureux, (arsim), V. Krishnaswamy (energjitikë), Paul-Andre Rochon and Michael Stanley (minierat) and Christian Henckes, Rabih Karaky and Silvia Mauri (bujqësi).

Ekipi gjithashtu u mbështet në punës dhe udhëzimet e Peter Darvas, Frauke Jungbluth, Alexandre Kolev dhe Boris Blazic.

Ekipi me mirësjellje e njeh edhe borxhin që i ka punimeve analitike të FMN-së, Komisionit European dhe RIINVEST-it.

Ekipi u është mirënjohës Bernard Funck, Ardo Hansson, Satu Kahkonen, Marina Wes, Sidi Boubacar, Robert Jauncey, Edgardo Favaro, Dimitri Demekas (IMF) dhe Prof. Vladimir Gligorov (Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare) për mbështetjen dhe këshillat e tyre.

Përgatitja e këtij raporti nuk do të kishte qënë e mundur pa mbështetje e shkëlqyer të Nancy Davies-Cole dhe Kathryn Rivera për përpunimin dhe editimin e dorëshkrimit.

## Përmbajtja

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....	I
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>1</b>
<b>2. PERFORMANCA MAKROEKONOMIKE .....</b>	<b>5</b>
A. SFONDI DHE ZHVILLIMET E KOHËVE TË FUNDIT .....	5
B. STABILITETI MAKROEKONOMIK .....	7
C. MUNDËSITË PËR RITJE NË PERIUdhËN AFATMESME .....	17
D. REKOMANDIMET RRETH LINJAVE TË VEPRIMIT: .....	21
<b>3. KLIMA PËR TREGTINË, INVESTIMET DHE FINANCAT .....</b>	<b>23</b>
A. HYRJE .....	23
B. TREGTIA NDËRKOMBËTARE .....	23
C. AMBIENTI I BIZNESIT .....	29
D. ZHVILLIMI I SEKTORI FINANCIAR .....	37
<b>4. POTENCIALET DHE PENGESAT PËR RITJEN NË NIVELIN SEKTORIAL .....</b>	<b>42</b>
<b>A. HYRJA .....</b>	<b>42</b>
B. SEKTORI ENERGHJITIK .....	42
C. SEKTORI MINERAR .....	49
D. SEKTORI BUJQËSOR .....	56
E. PËRFUNDIMET PËR SEKTORËT .....	60
<b>5. NDIKIMI I TREGUT TË PUNËS .....</b>	<b>62</b>
A. HYRJA .....	62
B. REZULATATET E TREGUT TË PUNËS .....	63
C. INSTITUCIONET E TREGUT TË PUNËS .....	66
D. TË RINJTË, AFTËSITË, DHE MUNDËSITË E PUNËSIMIT .....	69
E. REKOMANDIMI I POLITIKAVE .....	70
V. EKONOMIA .....	78
VII. DIALOGU .....	80
VIII. TRUPAT MBROJTËSE TË KOSOVËS .....	80
 ANEKS 1: Standardet për Kosovën .....	 72

### Tabelat

Tabela 1.1: Indikatorët Rezultues të Infrastrukturës së Rindërtuar dhe Riparuar .....	2
Tabela 2.1: Treguesit Kyç Ekonomikë .....	7
Tabela 2.2: Veprimtaritë e Konsoliduara të Qeverisë (milionë €) .....	10
Tabela 2.3: Përbërja Ekonomike dhe Funktionale e Shpenzimeve Qeveritare: Kosova dhe Vende të Përzgjedhura 1/ .....	13
Tabela 2.4: Një Krahasim Rajonal i të Ardhurave Qeveritare (si përqindje e PBB-së) ...	14
Tabela 2.5: Bilanci i Pagesave (përqindje e PBB) .....	16

Tabela 2.6: Përmbledhje e Rezultateve të Simulimeve .....	20
Tabela 3.1: Tregjet e Eksportit dhe Importit (për tregtinë e mallrave).....	25
Tabela 3.2: Normat e TVSH-ve rajonale dhe Tarifës Mesatare .....	27
Tabela 3.3: Treguesit e Ndërmjetësisë Financiare për Rajonin (2002) .....	38
Tabela 3.4: Cilësia e Portofolit të Huave .....	40
Tabela 4.1: Programi i Propozuar i Investimeve në Sektorin Energjistik nga PIP (në milion €).....	46
Tabela 4.2: Vlerësim i Kerkesave të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Sektorin e Minierave.....	53
Tabela 4.3: Importet e Kosovës sipas Llojit dhe Vendit të Origjinës (në milion €).....	59
Tabela 5.1: Karakteristikat e Tregut të Punës, 2002.....	65
Tabela 5.2: Vlerësimi i Punëtorëve sipas Kualifikimit në Shkollimin Formal.....	70

## **Boxes**

Kutia 1.1: Standardet për Kosovën .....	4
Kutia 2.1 Supozimet e skenarit Makroekonomik .....	18
Kutia 3.1 Institucionet Qeverisëse dhe Ato që Merren me Tregtinë .....	28
Kutia 3.2 Strukturat dhe dinamikat e sektorit të ndërmarrjeve për momentin.....	30
Kutia 5.1: Statusi i fuqisë punëtore të të papunëve të regjistruar, 2002.....	65

## **Figurat dhe Grafikët**

Figura 3.1: Ndryshimet në Shitje (2002 deri në 2003) .....	31
Figura 3.2: Vlerësimi i Pengesave të Përgjithshme për Veprimtari.....	33
Figura 4.1: Modeli i prodhimeve bujqësore në Kosovë, 2001.....	57
Grafiku 1.1: Fondet e shpenzuara dhe të angazhuara të donatorëve, 1999-2003 .....	1
Grafiku 1.2: Fondet e donatorëve të shpenzuara sipas sektorit, 1999-2003 .....	1
Grafiku 5.1: Nivelet e Papunësisë Rurale dhe Urbane, 2000 - 2002 .....	64
Grafiku 5.2: Shpërndarja e Pagave Mujore Neto Sipas Sektorit Publik and Privat, 2002 .....	67



## PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. **Ekonomia e Kosovës<sup>1</sup> e trashëguar në 1999 ishte e dëmtuar nga politikat e dobëta ekonomike, lidhjet e ndërprera të tregtisë së jashtme dhe financiare, sanksionet ndërkombëtare, mungesa e investimeve, dhe konflikti etnik.** Prodhimi u përgjysmua në fillimin e viteve '90, dhe u pakësua më tej me 20% si rezultat i konfliktit në fund të dekadës. Inflacioni mbeti në nivele shumë të larta gjatë gjithë viteve '90 për shkak të financimit monetar të deficitit fiskal dhe kuazifiskal që shkaktojnë mungesë të resurseve financiare. Deri në fund të dekadës, të ardhurat kishin rënë, gjysma e popullsisë ishte e papunë, dhe më shumë se gjysma ishin të varfër.
2. Që nga viti 1999, ka pasur një zhvendosje drejt politikave liberale të tregut. U krijua një regjim i hapur tregtar pa barriera sasiore dhe një normë tarifore të vetme prej 10 përqind. Përdorimi i valutës së huaj u legalizua për të gjitha transaksionet vendore, duke themeluar fillimisht markën gjermane e më vonë euron si valuta lokale de fakto. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK) u krijua për t'u marrë me pagesat vendore, licensimin dhe mbikqyrjen e sektorit bankar. Gjithashtu janë themeluar edhe një Ministri e Ekonomisë dhe Financave (MOFE), me përgjegjësi për buxhetin, si dhe një sistem tatimor dhe strukturë administrative.
3. **Të dhënat makroekonomike tregojnë që ka pasur një rimëkëmbje të aktivitetit ekonomik dhe rritje pozitive që nga viti 2000.**<sup>2</sup> Rritja e PBB-së, e cila reflekton nivele të larta të investimeve publike dhe private, arriti në 21 përqind në 2001 dhe që atëherë ka pasur vlera mesatare prej 4.3 përqind. PBB për frymë, rreth 400 dollarë amerikanë në 1995, është rritur në rreth 790 dollarë amerikanë në 2003. Të ardhurat kombëtare bruto pas pagesës së taksave (AKBD) u vlerësua të jenë rreth 1170 dollarë amerikanë për frymë në 2003. Është arritur stabilitet i cmimeve, me zbritje të normave të inflacionit nga vlera me dy shifra në vitin 2000 në vlera të inflacionit rreth zeros në 2003. Performanca e përmirësuar buxhetore dhe kursimet private në rritje kanë ndihmuar në më shumë se përgjysmimin e deficiteve të llogarisë korrente gjatë kësaj periudhe. Aktiviteti i sektorit privat tregon shenja të rimëkëmbjes, ku aktivitetet e ndërtimit kanë treguar fuqizim të konsiderueshëm dhe krediti bankar më shumë se është dyfishuar në secilin nga tre vitet e fundit.
4. **Por performanca e rritjes kohët e fundit është udhëhequr nga lulëzimi paskonfliktual, i financuar nga të hyrat zyrtare të ndihmës dhe nuk ka gjasa të jenë të qëndrueshme.** Normat e rritjes tashmë kanë rënë nga vlera dyshifrore (21.2% në 2000) në rreth 4.7 përqind në vitin 2003. Situata makroekonomike në Kosovë është e pazakontë për faktin se gjatë katër viteve të fundit, mjetet e huaja kanë financuar një deficit të konsiderueshëm tregtar, aktualisht rreth 125 përqind të PBB.

<sup>1</sup> Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, më tej përdoret termi Kosovë.

<sup>2</sup> Vlerësimet e të dhënave makroekonomike bazohen në vlerësimet e FMN-së dhe autoriteteve kosovare të përfunduara në Nëntor 2003. Për shkak të bazës së dobët statistikore në Kosovë, shumë nga të dhënat janë ndërtuar duke përdorur supozime. Ato janë në varësi të rishqyrtimeve të shpeshta dhe duhen trajtuar me kujdes. Me mbështetje nga FMN, BE dhe SIDA po bëhen përpjekje për ta forcuar shumë kapacitetin statistikor, sidomos në kompilimin e të dhënave ekonomike.

Mes viteve 1999 dhe 2003 komuniteti donator ndërkombëtar shpenzoi rreth 1.96 bilionë euro në Kosovë, për më tepër, remitancat i kanë shtuar kësaj shume rreth 550 milionë euro të tjera në vit gjatë kësaj periudhe. Që nga viti 2000, grantet e donatorëve kanë rënë me rreth 70 përqind, dhe parashihen të vazhdojnë të pakësohen. Ndërkohë që financimet e jashtme pakësohen, ekziston një pasiguri e konsiderueshme rreth faktit se si do të financohet deficit i mbetur tregtar. Sfida për bërësit e politikave në Kosovë është ruajtja e stabilitetit makroekonomik, parandalimi i rënieve të mëtejshme të prodhimit dhe ruajtja e normave të larta të rritjes.

5. Perspektiva për rritje ekonomike do të varet në masë të madhe nga suksesi i dy faktorëve qëndrorë dhe të ndërvarur (i) implementimi i një programi politikash që nxisin rritjen e udhëhequr nga sektori privat, duke përfshirë përfundimin e përpjekjes për rindërtim; dhe (ii) ruajtja e paqes dhe sigurisë për të gjithë njerëzit e rajonit dhe një qartësim të marrëveshjeve politike e ligjore. Investitorët gjithashtu do të kërkojnë njëfarë sigurie rreth vazhdimësisë së politikave liberale ekonomike pa marrë parasysh zhvillimet politike. Implementimi i programit të politikave gjithashtu duhet të ndihmojë në krijimin e stabilitetit politik dhe institucional dhe ligjvënës. Perspektivat për të adresuar çështjen e statusit politik të Kosovës janë të lidhura me përmbushjen e një sërë standardesh – parimi “Standardet para Statusit”. Këto standarde kanë për qëllim të sigurojnë që ekzistojnë institucionet funksionale demokratike, rregulli dhe ligji, korniza e shëndoshë e legjislacionit dhe politikave ekonomike dhe lëvizja e lirë e të gjithë njerëzve. Është e qartë se siguri i një ambienti stabil dhe të sigurtë për investitorët dhe krijimi i minimumit të institucioneve funksionuese, nevojiten për të zvogëluar rreziqet e një ambienti të pasigurtë që mund të rezultojë në një rënie të shpejtë të të ardhurave dhe indikatorëve socialë.
6. Për të ardhmen e afërt, qasja në tregjet kapitale dhe financimi i jashtëm me koncesion do të vazhdojnë të jenë të kufizuara. Për më tepër, pasiguria që shoqëron situatën aktuale të sigurisë, sistemin institucional dhe ligjor, rezultatet politike në rajon, dhe zbatimi i kontratave ligjore, i largon investimet e huaja direkte (IHD) të nevojshme për rivitalizimin e sektorëve industrialë. Vlerësimet e hyrjeve të IHD-ve tregojnë se më pak se 30 milionë euro janë investuar që nga viti 1999<sup>3</sup>. Progresi i vonuar dhe sporadik me privatizimin e ish ndërmarrjeve shoqërore dhe ristrukturimin e atyre publike (NPSH-të dhe NPP-të) po e pengon këtë edhe më tej.
7. **Ndërkohë, përmirësimi i ambientit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) e maksimizon në mënyrën më të mirë perspektivën e rritjes dhe të eksporteve.** Vlerësimi i Klimës së Investimeve arriti në përfundimin se një kornizë e shëndoshë ligjore për një ekonomi të lirë tregu në përgjithësi është krijuar dhe që ambienti i biznesit në përgjithësi perceptohet si më i favorshëm nga NVM-të vendore sesa në shumë vende të rajonit. Por, implementimi dhe zbatimi i kornizës së re të politikave dhe asaj ligjore, nuk është konsistent në pjesë të ndryshme të provincës, dhe duhen bërë përpjekje për të ndërtuar kapacitetet e administratave më të dobëta.

---

<sup>3</sup> Të gjitha vlerësimet e IHD janë eksperimentale. Shiko RIINVEST (2002).

8. **NVM-të e konsiderojnë furnizimin e pasigurtë me energji elektrike si pengesën më të madhe në veprimtarinë e tyre.** Kjo është çështja më e rëndësishme e politikave për të cilën është bërë progress i pamjaftueshëm dhe që po u kushton shumë si sektorit publik ashtu edhe atij privat. Një zgjidhje e shpejtë e problemit afatshkurtër të furnizimit me energji elektrike është një parakusht për rritje me bazë të gjërë.
9. **Reforma në sektorin e energjisë elektrike është urgjente jo vetëm për shkak të pengesës aktuale dhe kostos shtesë për pjesën tjetër të sektorit privat, por edhe për shkak të potencialit për fitime të konsiderueshme nga bashkimi me rrjetin rajonal të energjitikës dhe eksportimit të energjisë elektrike në rajon.** Depozitat e konsiderueshme të Kosovës në linjit janë nga më ekonomiket në Europë. Mungesa e burimeve të reja alternative të energjisë në vendet e tjera të rajonit të Europës Juglindore sjell një mundësi për përdorimin e linjitet për prodhimin e energjisë elektrike dhe shitjen e saj në rajon. Që të përfitohet nga një strategji e tillë kërkohet rehabilitimi i infrastrukturës ekzistuese, duke përfshirë minierat e linjitet; ristrukturimi i industrisë në përshtatje me krijimin e rrjetit rajonal; dhe përfshirja e operatorëve të sektorit privat për të zgjeruar bizneset e prodhimit të energjisë elektrike dhe atyre të minierave për eksport.
10. **Gjithashtu sektori i minierave, mund të japë mundësi për krijimin e vendeve të punës, por jo pa përpjekje intensive për lehtësimin e eksporteve dhe tërheqjen e IHD.** Si pjesë e RFS të Jugosllavisë, ndërmarrjet shoqërore të Kosovës prodhonin xeherorë dhe minerale të përpunuara për të furnizuar pjesën tjetër të vendit. Dikur ka qënë një industri e madhe, por veprimtaritë minerare dhe përpunuese kanë vuajtur nga një dekadë e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të dobët, dëmtimet e shkaktuara nga konflikti, dhe trashëgimitë shoqërore dhe ambientale. Si rezultat, shumica e tyre sot nuk janë operacionale. Sidoqoftë, ekzistojnë perspektiva për rivitalizimin e industrisë. Megjithëse sipas standardeve globale, depozitat e Kosovës janë modeste, ato kanë avantazhin relativ të të qenit afër Europës Perëndimore me kosto relativisht të ulëta të transportit nëpër tregje. Pengesa qendrore për rritje në këtë sektor është fakti që punimet nuk mund të rifillojnë apo të rimëkëmben pa injektime të mëdha të kapitalit dhe pa përmirësime teknike. Tërheqja e IHD-ve të nevojshme kërkon gjetjen e zgjidhjeve për të adresuar rreziqet politike dhe për të kapërcyer vonesat e përpjekjet e pasuksesshme për të filluar procesin e privatizimit.
11. **Një strategji e rritjes për sektorin e bujqësisë duhet të përqendrohet në mundësitë për agropërpunim dhe interesat e bujqëve komercialë.** Kosova është e pajisur me tokë pjellore dhe një klimë të butë të përshtatshme për prodhim bujqësor. Shoku që pësoi prodhimi vendor, i shkakuar nga konflikti, solli një shkatërrim të pasurive fermere dhe mbështetjen në importet bujqësore e ushqimore. Që nga ajo kohë, shumë pasuri janë zëvendësuar, por importet bujqësore vazhdojnë të jenë konkurrencë e fuqishme për prodhuesit vendorë. Produktiviteti dhe rendimenti bujqësor janë të ulët si rezultat i përmasave të vogla të fermave, stokut të kufizuar të kapitalit, mungesës së ekspertizës teknike, dhe përdorimit të keq të inputeve. Prandaj, nuk ka gjasa që Kosova të ketë avantazh relativ në prodhimin e mallrave voluminoze me vlerë të vogël si p.sh. drithrat. Nga ana tjetër, përmasat e vogla të fermave janë

indikatorë të një potenciali më të madh për prodhimin e perimeve, mishit dhe shpezëve, që tashmë kanë shfaqur një rritje të prodhimit dhe eksporteve komerciale.

12. **Megjithëse ka pasur rritje në aktivitetet e sektorit privat, kjo akoma nuk është transmetuar në një pakësim të papunësisë së lartë.** Orientimi më i mirë i politikave është ai që do të sjellë rritje nëpërmjet përdorimit intensiv të krahut të punës. Bërësit e politikave duhet t'i rezistojnë tundimit për ta ngarkuar tregun aktual të punës që është fleksibil, me rregullore shtesë dhe taksat më të larta në paga që do të shërbenin vetëm për të rritur kostot dhe për të zvogëluar mobilitetin e krahut të punës. Gratë dhe të rinjve përbëjnë një pjesë disproporcionalisht të lartë të të papunëve. Deri tani, papunësia është rezultat i ristrukturimit të sektorit të ndërmarrjeve. Autoritetet duhet të projektojnë paketa të ristrukturimit të krahur të punës që janë të përballueshme dhe të mirëqëlluara për krahun e tepërt të punës në NPSH-të dhe NPP-të që do të ristrukturohen në të ardhmen.
13. **Ruajtja e stabilitetit makroekonomik do të jetë e nevojshme për të maksimizuar mundësitë e rritjes.** Megjithë shformimet e paevitueshme që lidhen me të hyrat e huaja në sasi të madhe, ekonomia e ka një farë shkalle balancimi: adoptimi i euros sjell një normë stabile të këmbimit valutor dhe inflacion të ulët; dhe pamundësia për t'ju drejtuar huamarrjeve si vendore ashtu edhe ndërkombëtare përbën për autoritetet pengesën përfundimtare për buxhetit. Disiplina fiskale së bashku me një performancë më të mirë sesa pritej të të ardhurave vendore, kanë rezultuar në sufiçite buxhetore të grumbulluara gjatë tri viteve të fundit. Balanca e akumuluar e mjeteve të gatshme u vlerësua të jetë rreth 25 përqind e PBB-së deri në fund të vitit 2003.
14. Performanca e mirë e deritashme e të ardhurave vendore, ka mundësuar vazhdimin e shpenzimeve publike kapitale dhe të përsëritura ndërkohë që financimet ndërkombëtare janë pakësuar, si dhe krijimin e rezervave të mjeteve të gatshme. Në periudhën afatshkurtër, rezervat e akumuluar mund të përdoren për shpenzime kapitale modeste për të përfunduar rehabilitimin e infrastructures për të nxitur rritjen dhe lehtësimin e tranzicionit drejt një sektori publik më të vogël në ekonomi. Sidoqoftë, ekzistojnë një numër rreziqesh fiskale, që kërkojnë maturi fiskale për të shmangur ndonjë shok dramatik të prodhimit dhe ndërrime të politikave në të ardhmen. Së pari, baza e të ardhurave vazhdon të jetë e ngushtë dhe shumë e varur nga taksat e mbledhura nga importet. Me zvogëlimin e financimeve të jashtme, dhe me rënien e rritjes së PBB-së, pozicioni fiskal është i ndjeshëm ndaj rënies së importeve. Së dyti, gjatë viteve të fundit, tashmë ka pasur një rritje të shpejtë të shpenzimeve të qeverisë, duke përfshirë kostot e përsëritura si p.sh. pagat e sektorit publik. Për më tepër, më vonë, mund të ketë pretendime potenciale ndaj shpenzimeve publike, që shoqërojnë zgjidhjen politike, si p.sh. detyrimet e pagimit të borxhit të jashtëm. **Autoritetet duhet t'u rezistojnë presioneve për të shpenzuar në kosto të përsëritura dhe projekte kapitale të keqprojektuara, dhe të jenë të matur në këtë vit zgjedhesh, për të siguruar që nuk do të nevojiten ndryshime të kushtueshme të politikave në rast të zvogëlimit të rritjes dhe sosjes së rezervave të mjeteve të gatshme.**

15. **Si një ekonomi e vogël, pa dalje në det, e ardhmja e Kosovës varet në mënyrë kritike nga aftësia e saj për t'i hapur kufinj të dhe për të përfituar nga tregtia ndërkombëtare.** Dëshmitë empirike vërtetojnë se shtetet e vogla mund të arrijnë norma të larta rritjeje kur ekonomia është e hapur, nuk ka kontrole të lëvizjeve të kapitalit, ambienti i biznesit nuk pengohet nga rregulloret dhe ekziston një treg liberal i punës që rezulton në një fuqi punëtore të lëvizshme.<sup>4</sup> Deri tani, Kosova ka ndjekur politika tregtare që e vendosin atë në rrugën drejt regjimeve tregtare më liberale në botë. Ka vend për ta përmirësuar edhe më tej këtë regjim dhe një reduktim i përgjithshëm i normës tarifore në 5 përqind është i rekomanduar. Duhet të kihet parasysh implikimet në të ardhura, dhe duhet të merren masa për të rritur të ardhurat nga TVSH aty ku është e nevojshme. Duhet t'i rezistohet presionit të grupeve të ndryshme të interesit për të diferencuar normën tarifore me qëllim të një shkalle më të lartë të mbrojtjes për prodhuesit lokalë. Kosova tashmë përballet me pengesa të konsiderueshme jotarifore për tregtinë, në një rajon ku tregtia është pakësuar sidomos që nga ndarja e RSF të Jugosllavisë; prandaj duhet të vazhdojë të ndjekë politika që kanë për qëllim nxitjen e eksporteve në vend të prodhimit për tregun vendor.
16. Si përfundim, është arritur progres i konsiderueshëm që nga fundi i konfliktit në 1999. Progresi i rikonstruksionit, stabilitetit makroekonomik dhe themelimit të institucioneve publike, deri tani kanë sjellë rritje ekonomike dhe të ardhura të përmirësuara për frymë. Sidoqoftë, për të mbështetur rritjen ekonomike me bazë të gjërë, dhe reduktimin e varfërisë përtej lulëzimit postkonfliktual, ekzistojnë disa sfida përpara. Janë të domosdoshme një ambient i favorshëm i biznesit dhe një furnizim i sigurtë me energji elektrike, një regjim liberal i tregtisë dhe treg fleksibil i punës. Për më tepër, progresi me privatizimin dhe ndjekja e një rruge që do të mbronte investitorët nga rreziku politik, do të ndihmojnë tërheqjen e investimeve në sektorë kyç ekonomikë që mund të udhëhiqnin rrugën drejt një strategjie të rritjes të orientuar nga eksporti. Autoritetet kanë rënë dakort me një plan veprimi për implementimin e Standardeve gjatë tetëmbëdhjetë muajve të ardhshëm. Nevoja për t'i përmbushur këto Standarde i jep një premium shtesë politikave dhe reformave të shëndosha ekonomike gjatë kësaj periudhe.

---

<sup>4</sup> Shikoni për shembull, Slloveninë, Qipron, Letoninë dhe Irlandën.




# 1. HYRJE

## Me Anë të Programit të Rindërtimit Është Arritur Shumë


1.1 Pas pushimit të luftës në 1999, komuniteti ndërkombëtar dhe kosovarët filluan rindërtimin e infrastrukturës publike, kryerjen e shërbimeve publike, dhe krijimin e një kornize të re ligjore, themelimin e një strukture politike dhe administrate civile demokratike në Kosovë.<sup>5</sup> Megjithëkëtë shpërthime të dhunës vazhdojnë. Shpërthimet e kohëve të fundit të tensioneve etnike nënvizon nevojën që të shpejtohet reforma ekonomike dhe të mbrohen investitorët nga rreziqet politike për të siguruar që përparimi paqja dhe stabiliteti të jenë të siguruar për të gjitha grupet në Kosovë.

1.2 Ka pasur progres të konsiderueshëm të përpjekjeve për rindërtim. Komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë në mënyrë të suksesshme ka mobilizuar mbështetje për Kosovën dhe një total prej 1.96 miliardë euro nga fondet e donatorëve u shpenzuan mes viteve 1999 dhe 2003 (shikoni grafikët 1.1 dhe 1.2). Ashtu siç e tregon edhe tabela 1.1, kjo ka sjellë përfitime të prekshme si rrugë, shkolla dhe qendra shëndeti të riparuar. Rritja positive ekonomike, fillimisht e udhëhequr nga shpenzimet postkonfliktuale të rindërtimit nga një bazë e vogël vlerësohej të ishte më shumë se 20 përqind në 2001. Në vitet e fundit, kjo ka filluar të pakësohet deri në norma më të qëndrueshme. Sidoqoftë, norma e rritjes prej rreth 3.5 përqind, e vlerësuar në 2003 duhet të rritet nëq kërkohet të zvogëlohen papunësia dhe varfëria.

**Grafiku 1.1: Fondet e shpenzuara dhe të angazhuara të donatorëve, 1999-2003**



**Grafiku 1.2: Fondet e donatorëve të shpenzuara sipas sektorit, 1999-2003**



*Burimi:* Të dhëna nga RIMS, Njësia e Koordinimit të Donatorëve, MOEF.

<sup>5</sup> Kosova, Serbia dhe Mali i Zi, më tej përdoret termi Kosovë.

**Tabela 1.1: Indikatorët Rezultues të Infrastrukturës së Rindërtuar dhe Riparuar**

	1999	2000	2001	2002	2003	Totali
Km. Rrugë	0	487	926	36	26	1,475
Nr. i shtëpive	0	1,1782	5,828	2,074	0	19,684
Nr. i shkollave	81	89	110	99	80	459
Nr. i qendrave të kujdesit shëndetësor	10	28	46	18	73	175
Nr. i orëve me energji elektrike të ekonomive shtëpiake (milione)	4.0	4.6	5.1	5.6	5.5	24.8
m <sup>2</sup> të pastruara nga minat (milione)	4.7	27.5	0.2	0.3	0	32.7

*Burimi:* Njësia e Koordinimit të Donatorëve, MOEF.

### Qeverisja Karakterizohet nga një Administratë e Dyfishtë

1.3 Statusi final politik dhe ligjor i Kosovës do të vendoset gjatë negociatave në të ardhmen. Pas përfundimit të konfliktit në 1999, Kosova u vu nën administrimin e Misionit të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nën kushtet e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB.<sup>6</sup> Në 2001, u ra dakort për një Kornizë Kushtetuese, që themelonte Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), dhe përcaktonte një ndarje të përgjegjësive mes IPVQ dhe UNMIK-ut. Kjo marrëveshje e veçantë qeverisëse rezultoi në ndryshime radikale nga politikat ekonomike që kishin lidhje me ish-Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë (RFS e Jugosllavisë).

1.4 Gjithashtu, kjo administratë e dyfishtë rezultoi në një ambient sfidues qeverisëse, i cili adresohet në këtë raport. Në përgjithësi, bartja e përgjegjësive të IPVQ ka ecur mirë. Por, implementimi i suksesshëm i politikave që mbulojnë përgjegjësitë e ndara, do të kërkojë bashkëpunim të vazhdueshëm mes të dy administrative.

### Sfidat që Shtrihen Përpara

1.5 Mundësitë për rritje ekonomike varen nga suksesi i dy faktorëve themelorë: (i) zbutja e rreziqeve që kanë lidhje me pasigurinë politike dhe ruajtja e paqes dhe sigurisë në rajon; dhe (ii) implementimi i një programi politikash që nxit rritjen e udhëhequr nga sektori privat, duke përfshirë kompletimin e përpjekjeve për rindërtim. Një paketë e tillë reformash mund të përfshijë masat e mëposhtme:

- Brenda një pozicioni të shëndoshë fiskal të vazhdohet me projektet kapitale të prioritizuara për përfundimin e rehabilitimit të infrastrukturës, por t'i rezistohet harxhimeve të paqëndrueshme për shpenzime të përsëritura, si p.sh. fatura e pagave të sektorit publik.

<sup>6</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të KB riafirmoi angazhimin për sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë dhe Malit të Zi dhe gjithashtu kërkoi “autonomi të konsiderueshme” për Kosovën.

- Të ndiqen marrëdhënie të mira tregtie me rajonin. Të ruhet norma tarifore uniforme dhe të reduktohet kjo normë për të gjitha mallërat. Të konsiderohet një përpjekje kompensuese në të ardhura për të mbledhur taksa nga TVSH-ja, edhe nëpërmjet administratës së përmirësuar.
- Të vazhdohet me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike, përfshirë privatizimin e të drejtave të përdorimit të tokës së NPSH-ve të caktuara për likuidim.
- Të forcohet kapaciteti i gjykatave komunale për implementimin dhe zbatimin e të drejtave dhe kontratave të kreditorëve.
- Të rehabilitohet sektori energjistik, përfshirë minierat e linjitet, dhe të ndiqet një strategji për integrimin me rrjetin rajonal energjistik.
- Të zhvillohet një strategji për rivitalizimin e pjesës tjetër të sektorit të minierave.
- Të adresohen çështjet e stafit të tepërt në NPP dhe NPSH, të adresohen çështjet e papunësisë së përkohshme, dhe të lehtësohet ripunësimi në aktivitetet alternative produktive.
- Të ruhet tregu i punës relativisht i papenguar nga taksat mbi paga. Të lehtësohet kërkimi për punë nëpërmjet lidhjes së sistemeve të informacionit me anketimet e ndërmarrjeve dhe dhënien e training-ut profesional.

1.6 Në mënyrë që administrata lokale të përballet me sukses me rekomandimet sfiduese të politikave që përmbahen në këtë raport, komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë të japë ekspertizë teknike dhe të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve. Për më tepër, pozicioni i jashtëm e lë Kosovën të ndjeshme ndaj ndonjë shoku të jashtëm. Prandaj largimi i financimeve ndërkombëtare gjatë viteve të ardhshme duhet të ndodhë gradualisht. Për më tepër, duke pasur parasysh projeksionet që i konsideron ky raport, do të ketë nevojë për financimin me anë të granteve të donatorëve deri në vitin 2010.

1.7 Nën politikën e “standardet para statusit”, diskutimet rreth marrëveshjeve finale politike dhe ligjore të Kosovës do të varen nga progresi drejt një sërë objektivash. Standarde të detajuara për Kosovën u përpunuan nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB (PSSP) në dhjetor 2003 dhe janë miratuar nga Këshilli i Sigurimit i KB (lexoni Aneksin 1). Plani për Implementimin e Standardeve të Kosovës u ndërmor nga UNMIK-u në Mars 2004.<sup>7</sup> Një shqyrtim gjithëpërfshirës i progresit pritet në mes të vitit 2005, dhe vendimet se si dhe kur do të fillohen diskutimet rreth statusit final pritet të vazhdojnë pas këtij shqyrtimi.

1.8 Pasiguria dhe ndarjet politike në Kosovë kanë potencialin për të ndikur në progresin drejt Standardeve dhe në fund edhe në diskutimet rreth statusit final. Megjithëse mjaft është arritur, ngjarjet e fundit në Kosovë shërbejnë si një kujtesë e asaj se sa më tepër duhet të bëhet. Armiqësitë etnike dhe frustrimi mes njerëzve të Kosovës, ndryshimet mes partive kryesore politike dhe marrëdhëniet e tensionuara mes UNMIK-ut dhe IPVQ, si dhe zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare që pritet të mbahen në tetor 2004, e ndikojnë më tej klimën e pasigurtë politike dhe ambientin sfidues në të cilin duhet të arrihet progresi në planin e implementimit.

---

<sup>7</sup> Përfaqësuesit e Serbëve të Kosovës kanë ngritur rezervat e tyre rreth Planit të Implementimit të Standardeve të Kosovës.

### **Kutia 1.1: Standardet për Kosovën**

Qëllimi vetëpërshkrues i standardeve për Kosovën është që të caktojë kërkesat minimale për “një Kosovë ku të gjithë – pa dallim përkatësie etnike, race apo feje – të jenë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi apo rrezik, dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë”. Standardet caktojnë kërkesat minimale nën tetë tema të gjëra:

- (i) Institucione demokratike funksionale
- (ii) Sundimi i ligjit
- (iii) Liria e lëvizjes
- (iv) Kthime të qëndrueshme të njerëzve të zhvendosur dhe respect për të drejtat e të gjitha komuniteteve dhe anëtarëve të tyre.
- (v) Një ekonomik tregu konkurruese.
- (vi) Zbatim i paanshëm i të drejtave të pronës.
- (vii) Dialog konstruktiv dhe i vazhdueshëm mes IPVQ dhe Beogradit rreth çështjeve teknike.
- (viii) Transformimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës në një operacion civil në gjendje të jashtëzakonshme që përfaqëson të gjitha komunitetet e Kosovës.

Një temë kyç përgjatë të gjitha standardeve është nevoja që Kosova të lëvizë drejt standardeve europiane. Ata që merren me bërjen e politikave në Prishtinë e pranojnë që e ardhmja e Kosovës ka gjasa të varet nga integrimi më i madh europian.

1.9 Ky raport shqyrton mundësitë e përmirësimit të rritjes ekonomike në Kosovë, duke konsideruar në fillim çështjet themelore pa të cilat rritja nuk mund të jetë e qëndrueshme përtej lulëzimit postkonfliktual, dhe pastaj duke konsideruar veçantitë e disa sektorëve. Çështjet themelore shqyrtohen në kapitullin 2: stabiliteti makroekonomik dhe kapitullin 3: klima pa pengesa e biznesit. Në kapitullin 4, ne shqyrtojmë mundësitë për rritje të udhëhequr nga eksporti në sektorët e energjistikës, minierave dhe bujqësisë. Këta janë tre sektorë, në të cilët Kosova mund të ketë një avantazh relativ, meqë është relativisht e pasur me (i) linjit, (ii) minerale të tjera, dhe (iii) tokë bujqësore pjellore; gëzon tregti të lirë me BU dhe gjeografikisht shtrihet afër tregjeve të Europës Perëndimore. Në fund, në kapitullin 5 ne shqyrtojmë rezultatet dhe politikat e tregut të punës që nevojiten për një treg liberal të punës dhe një fuqi punëtore me aftësitë e përshtatshme.

## 2. PERFORMANCA MAKROEKONOMIKE

### A. SFONDI DHE ZHVILLIMET E KOHËVE TË FUNDIT

2.1 **Ekonomia e trashëguar në vitin 1999 ishte e dëmtuar nga politikat e dobëta ekonomike, lidhjet e shkatërruara tregtare dhe financiare, sanksionet ndërkombëtare, një mungesë investimesh, dhe konflikt etnik.** Të dhënat për këtë periudhë janë të kufizuara, por vlerësohet që prodhimi ra me më shumë se 50 përqind në fillimin e viteve '90, dhe 20 përqind të tjera si rezultat i konfliktit në fund të dekadës. Inflacioni mbeti në nivele shumë të larta gjatë viteve '90 për shkak të financimeve monetare të deficiteve fiskale dhe kuazifiskale. Këto deficite reflektonin një përpjekje për të ruajtur konsumin megjithë një baze mjaft më të vogël të resurseve. Rezultati ishte shkatërrim përfundimtar industrial dhe mungesë likuiditeti financiar. Në fund të dekadës, të ardhurat kishin rënë, gjysma e popullsisë ishte e papunë, dhe më shumë se gjysma ishte e varfër.

2.2 **Që nga viti 1999, ka pasur një zhvendosje drejt politikave liberale të tregut.** Regjimi i mëhershëm tregtar u zëvendësua me një regjim të thjeshtë pa pengesa sasiore dhe një normë të vetme tarifore prej 10 përqind. Përdorimi i valutës së huaj u legalizua për të gjitha transaksionet vendore, duke vendosur fillimisht markën gjermane e më vonë euron si valuta lokale de fakto. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (BPK) u themelua për t'u marrë me pagesat vendore, licensimin dhe mbikqyrjen e sektorit bankar. Gjithashtu është krijuar një ministri e ekonomisë dhe financave (MOEF), që është përgjegjëse për buxhetin e konsoliduar të Kosovës (BKK), dhe një një sistem i ri tatimor e një strukturë e re administrative.<sup>8</sup>

2.3 Vlerësimet e të dhënave makroekonomike bazohen në vlerësimet e FMN-së dhe autoriteteve kosovare të përfunduara në nëntor 2003. Për shkak të bazës së dobët statistikore në Kosovë, shumë nga të dhënat janë ndërtuar duke përdorur supozime dhe prandaj ato janë subjekt i rishqyrtimeve të shpeshta. Me mbështetjen e donatorëve, që përfshijnë FMN, BU dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim e Zhvillim Ndërkombëtar po ndërmirren përpjekje për të forcuar më tej kapacitetin statistikor, sidomos në përpilimin e të dhënave ekonomike.

2.4 **Të dhënat e PBB-së tregojnë se ka pasur një rimëkëmbje të aktivitetit ekonomik dhe rritje positive që nga viti 2000.** Rritja e PBB, që reflekton nivele të larta të investimeve publike e private, arriti në 21 përqind në 2001 dhe që atëherë ka pasur një mesatare vjetore prej 4.3 përqind. PBB për banor, rreth 400 dollarë amerikanë në 1995, është rritur në rreth 790 dollarë amerikanë në 2003 (shikoni Tabelën 2.1). Të ardhurat kombëtare bruto pas pagesës së taksave (AKBD) vlerësohen të jenë rreth 1034 euro për frymë në vitin 2002 (975 dollarë amerikanë për frymë); dhe 1040 euro për frymë në 2003

---

<sup>8</sup> Një shqyrtim më i detajuar i institucioneve ekonomike të krijuara nga UNMIK mund të gjendet në Demekas, Herderschee, dhe Jacobs (2002).

(1170 dollarë amerikanë për frymë). Është arritur stabilizimi i çmimeve, ku normat e inflacionit nga dyshifrore në vitin 2000 kanë zbritur në zero në 2003. Performanca e përmirësuar buxhetore dhe kursimet private në rritje gjatë kësaj periudhe kanë ndihmuar në më shumë se përgjysmimin e deficiteve të llogarisë korrente. Aktiviteti i sektorit privat tregon shenja rimëkëmbjeje, ku aktivitetet ndërtimore tregojnë fuqizim të konsiderueshëm dhe krediti bankar është rritur më shumë se dyfish gjatë secilit prej tre viteve të kaluara.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Rritjet e kreditit bankar bëhen nga një bazë e ulët dhe përqendrohen në kapitalin punues.

**Tabela 2.1: Treguesit Kyç Ekonomikë**

	2000v	2001v	2002v	2003v	2004p1/
<b>Llogaritë kombëtare</b>					
Rritja e PBB reale	..	21.2	3.9	4.7	6.5
Investimet (% PBB) 2/	35.6	40.0	40.7	38.0	45.3
Kursimet vendore bruto (% PBB)	-198.6	-114.7	-99.4	-85.2	-71.3
<b>Bilanci i qeverisë (% PBB)</b>					
Të Ardhurat	17.2	28.0	38.9	44.7	45.4
Shpenzimet	31.5	24.4	33.5	42.5	50.8
Nga të cilat, shpenzime kapitale	2.3	1.8	3.3	7.8	14.5
Bilanci (duke përjashtuar grantet)	-14.3	3.6	5.4	2.2	-5.5
Grantet e donatorëve	21.5	7.3	3.0	2.2	0.0
<b>Llogaritë e jashtme (% PBB)</b>					
Eksportet e mallrave	0.5	3.0	7.4	8.2	21.7
Importet e mallrave 3/	156.4	113.7	108.3	99.2	117.4
Remitancat e punëtorëve	73.7	52.0	42.9	43.2	42.5
Llogaria korrente para granteve	-174.6	-110.2	-96.5	-76.9	-69.8
<b>Kursimet dhe investimet (% PBB)</b>					
Kursimet kombëtare	44.9	38.5	14.8	7.6	7.1
Nga të cilat bruto vendore	-198.6	-114.7	-99.4	-85.2	-71.3
Investimet	66.9	57.7	48.3	40.5	45.3
Nga të cilat për shtëpi	28.0	30.0	26.4	19.3	16.6
<b>Agregatët monetarë (% PBB)</b>					
Paraja e gjërë	99.6	78.5	70.9	75.4	74.5
Kreditit bankar për sektorin privat	0.4	2.2	6.8	16.1	19.8
<b>Çmimet</b>					
Inflacioni i IÇK	..	11.7	3.6	0.0	0
<b>Memorandum:</b>					
Norma e papunësisë 4/	..	..	38	..	..

1/ Të dhënat nga 2000 në 2003 janë vlerësime (v) dhe të dhënat e 2004 janë projeksione (p)

2/ Duke përjashtuar shpenzimet e financuara nga donatorët.

3/ Duke përjashtuar importet që kanë të bëjnë me donatorët.

4/ Duke përjashtuar personat që e deklarojnë veten të papunë por zotërojnë tokë.

*Burimi:* Vlerësime dhe projeksione të stafit të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore.

## B. STABILITETI MAKROEKONOMIK

### Stabiliteti Makroekonomik është një Kusht i Nevojshëm për Rritje

2.5 Qëndrueshmëria e performancës së rritjes ekonomike mbetet një problem, meqë kryesisht është financiar nga të ardhurat nga jashtë, që tani po pakësohen. Injektimi i burimeve të huaja ka mundësuar importimin e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për rindërtimin e infrastrukturës dhe shtëpive që ishin shkatërruar gjatë

konfliktit; gjithashtu u ka dhënë Kosovarëve fuqinë blerëse, që është aq e nevojshme. Sidoqoftë, që nga viti 2001, komuniteti ndërkombëtar vazhdimisht e ka pakësuar ndihmën. Grantet e donatorëve ndërkombëtarë janë zvogëluar me 70 përqind prej 2000 deri në 2003. Si rezultat, rritja ka rënë në vlera njëshifrore. Remitancat e punëtorëve nga diaspora dhe punëtorët sezonalë gjithashtu kanë luajtur rol kritik në stimulimin e kërkesës vendore. Megjithëse vazhdojnë të jenë të larta, remitancat – duke përfshirë punëtorët sezonalë që jetojnë në vende të tjera gjatë një pjese të vitit -- në krahasim me periudhën e menjëhershme të paskonfliktit ato janë pakësuar dhe aktualisht vlerësohen të jenë rreth 300 euro për frymë.

**2.6 Ndërkohë që ndihma e huaj dhe remitancat pakësohen, Kosova sigurisht që ka nevojë për zëvendësimin e këtyre të ardhurave me fitime nga eksporti dhe investim të huaja.** Autoritetet duhet të sigurojnë stabilitet makroekonomik që të lehtësojnë rritjen e udhëhequr nga sektori privat. Krijimi i mundësive të reja për investime do të kërkojë rikthimin e paqes dhe sigurisë në Kosovë, shpejtimin e privatizimit dhe implementimin e një pakete reformash për përmirësimin e ambientit të biznesit dhe do të ndihmohet nga politikat për qartësimin e marrëveshjeve ligjore dhe politike të Kosovës.

### **Ruajtja e Qëndrueshmërisë Fiskale Është Shumë e Rëndësishme për Stabilitetin Makroekonomik**

**2.7 Duke mos pasur politikë monetare apo instrument të kursit të këmbimit, dhe pa mundësi të qasjes në huamarrje vendore apo të jashtme, për të ruajtur stabilitetin makroekonomik është shumë e rëndësishme një politikë fiskale e shëndoshë.** Të ardhurat e qeverisë janë rritur mjaft që nga viti 2000, e cila reflekton hyrjen në fuqi të taksave të reja si dhe përpjekjet e fuqizuara për mbledhjen e taksave. Të ardhurat totale u rritën nga rreth 17 në 39 përqind të PBB nga viti 2000 deri në 2002, dhe vlerësohen të jenë rritur në 45 përqind të PBB-së në 2003 (shikoni Tabelën 2.2). Buxheti i konsoliduar i Kosovës<sup>10</sup> gjithashtu është rritur gjatë kësaj periudhe, por me një përqindje më të ulët sesa rritja e të ardhurave, nga rreth 32 përqind të PBB në vitin 2000 në 42.5 përqind të PBB në 2003. Nga viti 2001 deri në 2003, suficitet buxhetore kanë qënë 3.5 përqind e PBB, dhe si rezultat rezervat e akumuluar të mjeteve të gatshme vlerësoheshin të ishin rreth 25 përqind e PBB në fund të vitit 2003.<sup>11</sup>

**2.8 Një rezervë buxhetore u sjell autoriteteve një mbrojtje për të zbutur rreziqet fiskale.** Në periudhën afatshkurtër, reserva buxhetore mund të përdoret për shpenzime modeste kapitale që do të ndihmonin në përfundimin e rehabilitimit të infrastrukturës, dhe të lehtësonin tranzicionin drejt një sektori më të vogël publik në ekonomi. Sidoqoftë, ekzistojnë disa rreziqe fiskale, me anë të të cilave argumentohet ruajtja e një pozicioni të rezervave për të shmangur ndonje shok të prodhimit në të ardhmen. Së pari, baza e të ardhurave vazhdon të jetë e ngushtë dhe e mbështetur në taksat e mbledhura nga importet dhe prandaj e ndjeshme ndaj ndonjë perkeqësimi ekonomik. Së dyti, ekzistojnë pretendime potenciale të shpenzimeve publike që kanë lidhje me një zgjidhje politike, si p.sh. detyrimet e pagimit të borxhit të jashtëm. Prandaj autoritetet duhet të sigurojnë që

<sup>10</sup> Përfsin shpenzimet nga UNMIK-u dhe institucionet e qeverisë qendrore dhe lokale të IPVQ.

<sup>11</sup> Një pjesë e bilancit të akumuluar të mjeteve të gatshme do të nevojiten për rizotimin e disa zotimeve të papërdorura nën kushtet e e Rregullores së Buxhetit 2004.

planet shpenzuese janë të arsyetuara mirë dhe të qëndrueshme. Duhet të ndërmerret një analizë rigoroze e investimeve para aprovimit të projekteve kapitale të reja. Kostot e përsëritura (p.sh. kostot e mirëmbajtjes) që i shoqërojnë këto shpenzime kapitale duhet të përfshihen në analizën e kostos-benefitit dhe analizën e qëndrueshmërisë. Projektet duhet të kenë prioritetet e tyre bazuar në strategjinë zhvillimore ekonomike afatmesme, dhe zgjerimi i shpenzimeve duhet të jetë në përputhje me një kornizë makroekonomike afatmesme. Presionet për të rritur shpenzimet publike, që tashmë janë të larta, ka gjasa të rritet në këtë vit të zgjedhjeve. Autoritetet duhet me kujdes të vazhdojnë të kenë parasysh rastësitë fiskale dhe rrethanat e qëndrueshmërisë. Pjesa tjetër e këtij seksioni shqyrton rreziqet fiskale, politikat e shpenzimeve dhe të ardhurave për qëndrueshmëri fiskale.

**Tabela 2.2: Veprimtaritë e Konsoliduara të Qeverisë (milionë €)**

	2000	2001	2002	2003
	(përqindje e PBB)			
Të ardhurat totale	17.2	28.0	38.9	44.8
Të ardhurat e qeverisë qendrore	16.3	24.7	34.7	42.7
Taksat e kufirit 1/	15.4	21.1	28.8	32.5
Taksat direkte vendore	0.6	2.5	3.8	4.7
Taksat indirekte vendore	0.2	1.1	2.2	2.3
Të ardhurat jotaksore	1.0	1.9	2.6	3.2
Të ardhurat nga burimet vetanake të komunave	0.0	1.3	1.6	2.1
Shpenzimet totale	31.5	24.4	33.5	43.4
Shpenzimet aktuale (korrente)	29.2	22.6	30.3	35.9
Konsumi	22.4	17.4	21.9	25.8
Rrogat dhe pagesat	12.4	9.5	10.3	11.1
Mallrat dhe shërbimet	10.1	7.9	11.6	14.8
Subvencionet dhe transferat	6.8	5.2	8.4	9.7
Pensionet	0.0	0.0	1.7	..
Asistenca sociale	0.0	0.0	3.0	..
Ndërmarrjet shtetërore	0.0	0.0	0.0	..
Nga të cilat energjia elektrike	0.0	0.6	1.6	..
Tjetër	0.0	0.0	0.0	0.2
Shpenzimet kapitale	2.3	1.8	3.3	7.4
Bilanci i përgjithshëm	-14.3	3.6	5.4	1.4
Financimi	14.3	-3.6	-5.4	-1.4
Ndryshimet në bilancet e fondeve të paracaktuara	-1.2	-0.6	0.5	0.0
Ndryshimet në bilancet e tjera të bankave	-6.1	-10.2	-8.9	-3.6
Grantet e donatorëve	21.5	7.3	3.0	2.2
Të paracaktuara	5.4	3.7	1.6	2.2
Mbështetje për buxhetin	16.2	3.6	1.4	0.0
<b>Memorandum:</b>				
Buxheti i UNMIK-ut	55.3	38.9	30.7	..
Programi i Investimeve Publike & OJQ-të	76.5	46.1	29.3	..
Nga të cilat pjesëmarrja e kapitalit	5.6	2.8	0.8	..
	131.9	84.9	60.0	..

Shënime 1/ Taksat e kufirit janë tarifat doganore, akcizat në kufi dhe TVSH për importe  
*Burimi:* Vlerësime të autoriteteve kosovare dhe FMN-së, 2003

### Ekzistojnë një Numër i Rreziqeve Fiskale që Duhet Marrë Parasysh

2.9 Potencialisht, dy byrimet më të rëndësishme të rreziqeve fiskale janë (i) marrja përsipër e detyrimeve për pagimin e një pjese të borxhit të jashtëm të Serbisë dhe Malit të Zi (SMZ) dhe (ii) zgjidhja e problemit të depozitave të ngrira të familjeve në valutë të huaj që u konfiskuan nga qeveria e RFS e Jugosllavisë.

Borxhi i jashtëm i RFS të Jugosllavisë vlerësohet të jetë rreth 1.2 miliardë euro, dhe aktualisht po paguhet nga SMZ. Rreth 75 përqind e kësaj shume i detyrohet kredidhënësve zyrtarë, të cilët kanë qënë zemërgjërë në dhënien e kushteve rristrukturuese. Sasia e borxhit është aq e madhe ( rreth 90 përqind e PBB-së së Kosovës në viting 2003) saqë në varësi të negociatave mes Kosovës dhe SMZ, marrja përsipër e pagesës së një pjese të borxhit dhe interesit që i bashkëngjitet mund të kërkojë përshtatje të konsiderueshme.<sup>12</sup> Për më tepër, eksperiencia nga vendet e ish-RFS të Jugosllavisë në lidhje me detyrimet që lindin nga depozitat e ngrira të valutës së huaj, tregon se presioni i konsiderueshëm politik mund të rezultojë në angazhime për të kompensuar depozituesit. Në rastin e Serbisë, angazhimet për kompensim përbëjnë rreth 28 përqind të PBB-së; në Ish-RY të Maqedonisë janë bërë angazhime, por kompensimet nuk po paguhet. Në rastin e Kosovës, pritet që kompensimet të konsiderohen së bashku me çështjet e tjera financiare si p.sh. pretendimet e pensioneve të papaguara në bazë të një vlerësimi të kostos së mundësive. Një vlerësim paraprak i depozitave të konfiskuara është rreth 500 milionë euro, apo rreth 40 përqind e PBB-së së Kosovës.

**2.10 Një burim tjetër potencial i rrezikut fiskal është edhe performanca e dobët financiare e sektorit të ndërmarrjeve.** Ndërmarrjet publike dhe shoqërore të trashëguara, aktualisht nën menaxhimin e UNMIK-ut, përfaqësojnë një detyrim kushtëzues serioz për burimet publike. Sektori i ndërmarrjeve përballet me problemet e aseteve të vjetra dhe të keqmbajtura, punësim të pjesshëm e jo të rregullt dhe ambient operativ të pasigurtë, të cilat rezultojnë në performancë të dobët financiare. Potencialisht, kostoja e kombinuar e dhënies së asistencës financiare dhe ritrajnimit mund të jetë 0.3 deri në 0.4 përqind e PBB-së në vit për dy vjet. Në total, ekzistojnë rreth 18,000 punëtorë aktivë në NPSH-të dhe 16,000 në NPP-të.<sup>13</sup> Vetëm në sektorin e minierave ekzistojnë rreth 5,000 punëtorë të tepërt (shikoni kapitullin 4). Ndërkohë që procesi i privatizimit dhe mbyllja e bizneseve vazhdojnë, do të jetë shumë i rëndësishëm krijimi i mundësive me qëndrueshmëri fiskale për të gjetur zgjidhje për çështjen e krahut të tepër të punës dhe tranzicionit drejt mundësive alternative të punësimit.

## **Politikat e Shpenzimeve dhe Alokimi i Resurseve**

**2.11 Suficitet buxhetore dhe rezervat qeveritare kanë rezultuar në një presion në rritje për shpenzime, sidomos për rroga e paga si dhe transfera sociale.** Presion buxhetor shtesë pritet të lindë nga përvetësimi i kostos së shërbimeve dhe investimeve që akoma kryhen nga komuniteti ndërkombëtar; dhe dëshira për të rritur shpenzimet sociale për të mbështetur objektivat e rritjes dhe zhvillimit. Tashmë ka pasur një rritje të shpejtë të shpenzimeve qeveritare dhe në mënyrë të qartë tani shfaqet potenciali për shpenzime joefektive ndërkohë që totali i shpenzimeve vazhdon të rritet. Suficiti buxhetor pjesërisht është shkaktuar si rezultat i kapacitetit të kufizuar të agjensive qeveritare për të shpenzuar, dhe rezultateve të buxhetit që kanë qënë më të ulëta sesa ishin zotimet e

<sup>12</sup> Simulimet për krejt SMZ, që në fund të vitit 2002 kishte një raport të borxhit publik me PBB-në prej rreth 90 përqind, sugjerojnë që interesi total i borxhit publik mund të variojë nga 4 deri në 8 përqind të PBB-së së Kosovës nën një program me reforma ekonomike të mira.

<sup>13</sup> Një anketim i kryer nga RIINVEST, një institucion hulumtues lokal, sugjeron që numri i njerëzve që janë të larguar nga puna pa pagesë mund të jetë përafërsisht i njëjtë. Besohet se planet rristrukturuese mund të kërkojnë kompensim për të dy llojet e punëtorëve.

pritshme. Prandaj, shpenzimet shitesë mund të rrisin më tej joefektshmërinë e shpenzimeve qeveritare.

**2.12 Mund të nevojitet racionalizimi i shpenzimeve për të krijuar hapësirë për zotime të reja, për reduktimin e barrës së tatimeve dhe përmirësimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së shpenzimeve.** Nevojitet një shqyrtim gjithëpërfshirës i shpenzimeve publike për të përcaktuar rialokimet buxhetore që nevojiten. Sidoqoftë, një shqetësim i qartë i shpenzimeve është fatura në rritje e pagave të sektorit publik si rezultat i politikave të kohëve të fundit për të rritur pagat dhe për të rritur numrin e punëtorëve të rinj. Fatura e pagave të sektorit publik aktualisht vlerësohet të jetë 11 përqind e PBB-së. Tabela 2.3 tregon nëndarjet ekonomike dhe funksionale të shpenzimeve qeveritare në 2003 dhe jep një krahasim me mesataret e shpenzimeve gjatë periudhës 1995-2001 në vendet e tjera të rajonit. Fatura e pagave të sektorit publik është aktualisht praën vlerave më të larta të interвалit në të cilin gjenden vlerat e rajonit si përqindje e PBB-së. Meqënëse aktualisht po shqyrtohet struktura e pagave dhe gradave, ndikimi, qëndrueshmëria dhe përshtatshmëria fiskale e mundësive për të rishikuar marrëveshjet e sektorit publik duhet të konsiderohen në detaje para adoptimit të një strukture të re pagash. Kjo duhet të përfshijë një vlerësim të kostove gjatë periudhës afatmesme (5 vjet) që duhet të përfshijë të gjithë elementet e kompensimit (p.sh. të përfshijë mëditjet për ushqim) dhe përshtatshmërinë e aplikimit të një structure të caktuar të gradave ndaj disa grupeve të caktuara si punonjësit e shëndetësisë dhe arsimit.

**2.13 Dëmtimi fizik gjatë konfliktit dhe një histori e lënies pas dore, krijuan një mungesë të investimeve kapitale.** Investimet totale publike janë rreth 10 përqind e PBB-së, duke përfshirë shpenzimet kapitale nën BKK (7.4 përqind e PBB-së) dhe investimet e financuara nga donatorët nën PIP (2.6 përqind e PBB-së). Megjithëse ka pasur shumë arritje, ekzistojnë një numër sektorësh ku rehabilitimi nuk ka përfunduar akoma dhe ku do të vazhdojë të ketë nevojë për investime kapitale gjatë disa viteve të ardhshme. Vlerësimet vetëm për rehabilitimin e sektorit energjistik kapin shumë prej rreth 300 milionë euro për të siguruar një furnizim të përshtatshëm me energji elektrike – që do të financohet pjesërisht nga fondet e donatorëve ndërkombëtarë dhe burimet e siguruara në vend.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> Kjo nuk përfshin financimin që duhet bërë nga investimet e sektorit privat që do të nevojiteshin nëq Kosova kërkon të shfrytëzojë potencialin për eksport të energjisë elektrike në rajon

**Tabela 2.3: Përbërja Ekonomike dhe Funktionale e Shpenzimeve Qeveritare: Kosova dhe Vende të Përzgjedhura 1/**

	Kosova	Shqipëria	Bosnia dhe Hercegovina	Kroacia	Serbia dhe Mali i Zi <sup>2/</sup>	Sllovenia
<b>A. Klasifikimi Ekonomik (përqindje e PBB)</b>						
Rrogat dhe pagesat	11.1	6.2	..	10.7	10.3	9.8
Mallra e shërbime	14.8	3.0	..	10.3	8.0	7.9
Subvencione dhe transfera	9.7	8.1	19.7	20.3	24.0	19.1
Interesi	0.0	3.7	1.1	2.2	1.0	1.6
Shpenzime kapitale	7.48	6.2	6.2	6.3	3.4	3.9
<b>B. Klasifikimi FunkSIONAL (% PBB) 3/</b>						
Çështje ekonomike	3.7	..	3.6	6.2	2.3	4.7
Sigurimi shoqëror & mirëqënia	6.3	..	16.1	18.3	13.1	17.0
Shëndetësia	4.5	..	6.2	6.8	5.9	5.5
Rendi publik & siguria	4.8	..	4.1	2.7	2.0	1.6
Arsimi	6.1	..	5.6	4.4	5.9	5.5
Tjetër	13.9	..	15.8	11.3	9.1	7.5
<b>B. Klasifikimi FunkSIONAL (struktura) 3/</b>						
Çështje ekonomike	9.4	..	7.0	12.5	6.0	11.2
Sigurimi shoqëror & mirëqënia	16.0	..	31.3	36.8	34.2	40.7
Shëndetësia	11.5	..	12.1	13.7	15.4	13.2
Rendi publik & siguria	12.2	..	8.0	5.4	5.2	3.8
Arsimi	15.6	..	10.9	8.9	15.4	13.2
Tjetër	35.4	..	30.7	22.7	23.8	17.9

1/ Kosova në 2003. Për të gjitha të tjerat, sasitë janë shpenzimet aktuale në 2002.

2/ Duke përfshirë Kosovën.

3/ Vlerat për Kosovën janë sasi të buxhetuara, por për të gjitha të tjerat sasitë janë shpenzime aktuale.

*Burimi:* Autoritetet kosovare dhe Studimi Rajonal i Europës Juglindore për Politikën e Shpenzimeve Publike që do të botohet së shpejti (Banka Botërore).

2.14 Është e rëndësishme të dihet që shpenzimet totale të “sektorit publik” janë shumë më të mëdha sesa buxheti i konsoliduar i Kosovës. Efektivisht, sektori publik përfshin buxhetin e UNMIK-ut, pjesën e Programit të Investimeve Publike të financuar nga donatorët, dhe projekte të ndryshme të donatorëve dhe OJQ-ve. Në fund të vitit 2002, shumat totale të shpenzimeve publike vlerësohej të ishte rreth 60 përqind e PBB-së. Shpenzimet jashtëbuxhetore janë zvogëluar që nga viti 2000 dhe transferimi i përgjegjësisë do të vazhdojë të shtojë nevojat për shpenzime të BKK-së.

## Politikat e të Ardhurave

2.15 Nga ana e të ardhurave, janë mbledhur më shumë mjete sesa pritej, dhe janë siguruar burime të mjaftueshme për të mbuluar zotimet buxhetore të deritashme. Në 2004, të ardhurat janë projektuar të arrijnë mbi 45 përqind të PBB-së. Kjo është e lartë në krahasim me vendet me të ardhura të ulëta, dhe është ndër vendet që e kanë më të lartë në rajonin e Europës Qendrore dhe Ballkanit. Shikoni Tabelën 2.4 më poshtë.

**Tabela 2.4: Një Krahasim Rajonal i të Ardhurave Qeveritare (si përqindje e PBB-së)**

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
<b>Europa Juglindore, mesatarja</b>	<b>47.6</b>	<b>45.1</b>	<b>39.9</b>	<b>43.5</b>	<b>45.1</b>	<b>40.9</b>	<b>41.5</b>	<b>43.9</b>
Bosnia dhe Herzegovina		51.9	39.9	46.3	48.7	48.5	49.6	49.0
Kroacia	47.6	49.7	48.3	51.8	48.8	47.2	45.7	45.4
Maqedonia		35.7	34.8	33.3	35.4	36.8	34.5	36.1
Serbia dhe Mali i Zi						37.5	39.6	43.9
Sllovenia		40.5	39.9	40.8	41.4	40.9	41.5	39.5
Kosova						17.2	28.0	38.9

*Burimet:* Vlerësimet e autoriteteve kombëtare, FMN-së dhe stafit të Bankës.

2.16 **Një shqyrtim i nivelit dhe strukturës së mjeteve të mbledhura, sugjeron që mbledhja më e mirë e taksave vendore do të ndihmonte në stabilitetin e të ardhurave dhe do të mbështeste zhvillimin e biznesit.** Më shumë se tri të katërtat e të ardhurave tatimore mbledhen në kufi, i cili është vendi ku zbatimi i kodit tatimor është më i forti. Vetëm rreth 11 përqind e të ardhurave janë nga taksat direkte. Nevojiten shqyrtim i mëtejshëm i shtrembërimeve, implikimeve të interesave të pronarëve dhe ndikimi i këtyre interesave mbi regjimin e tregtisë. Ekonomia joformale dhe volumi i transaksioneve që bazohen në mjete të gatshme pengojnë mbledhjen e taksave vendore. Nga ndërmarrjet që janë të regjistruara, një segment i vogël nuk i plotëson detyrimet e veta tatimore. Mes viteve 2000 dhe 2003 taksat totale të papaguara u rritën nga 0.2 në 4 përqind të PBB-së, pothuajse të gjitha taksa indirekte dhe TVSH të papaguara. Rreth 60 përqind e kësaj shume ishte detyrim i 100 kompanive, gjë që sugjeron se një shtysë relativisht e fokusuar për të zbatuar ligjet tatimore mund të rrisë shumë disiplinën e pagesave.

2.17 Mbledhja e taksave duket më e ulët në nivel komunal, meqë kapaciteti administrative është më i dobët. Në rastin e taksave në pronë, vetëm 13 përqind e faturave të dhëna në 2002 dhe 2003 ishin paguar në fund të vitit 2003. Problemi duket se është përkeqësuar në 2003, sepse vetëm 7 përqind e faturave dhe 11 përqind e detyrimeve u paguan atë vit. Si përgjigje, u përgatit legjislacioni që mund të ndihmonte në zbatimin e mbledhjeve të taksave. Po shqyrtohet edhe një program nxitës që u jep komunave grante plotësuese për çdo euro që mbledhet përtej një pragu të paracaktuar.

## **Ndjeshmëria ndaj Tronditjeve të Jashtme**

2.18 **Përmasat e vogla të ekonomisë dhe niveli i ulët i shumëllojshmërisë së eksporteve e bën Kosovën të ndjehet e rrezikuar nga shoket e raportit të çmimeve të mallrave të eksportit me ato të importit.** Një ngadalësim i rritjes ekonomike të partnerëve të vetë më të mëdhenj tregtarë do ta kufizonte shumë potencialin për zgjerim të eksporteve dhe aktivitet të përgjithshëm ekonomik. Përqendrimi i eksporteve në mallra që nuk përfshijnë lëndet djegëse, si dhe në produkte të tjera me vlerë të vogël të shtuar, dhe varësia pothuajse e plotë nga mallrat e prodhuar jashtë gjithashtu e bëjnë ekonominë të ndjeshme ndaj çmimeve të mallrave që mund të tregtohen.

2.19 **Duke pasur parasysh presionin për të rritur pagat e sektorit publik, nuk ka gjasa që efekti i shock-eve të jashtme të zbutet me anë të një përshtatjeje të pagave nominale duke i zvogëluar ato.** Në këto rrethana, është veçanërisht e rëndësishme të kihet fleksibilitet i mjaftueshëm i buxhetit, për të kufizuar tkurrjet e prodhimit. Nevoja për ta ruajtur ekonominë nga shok-et e jashtme i jep edhe më tepër rëndësi fuqizimit të sistemit financiar, sigurimit të qëndrueshmërisë fiskale, dhe krijimit të një ambienti që tërheq investimet e huaja.

2.20 Një nga aspektet positive të përdorimit të euros si ofertë legale për të gjitha transaksionet është që një regjim i kursit të këmbimit plotësisht i “dollarizuar” parandalon krizat e parasë, meqënëse nuk mund të ketë zhvlerësim.<sup>15</sup> Në parim, kjo mund të ndihmojë parandalimin e një krize bankare duke eliminuar mospërputhshmëritë valutore mes aseteve dhe detyrimeve të huamarrësve. Sidoqoftë, dollarizimi nuk mund ta mbrojë ekonominë plotësisht nga tronditjet reale, dhe në fakt mund t’i bëjë prodhimin dhe investimet më të paqëndrueshëm meqë zhvlerësimi nuk mund të përdoret për të ndryshuar çmimet relative.<sup>16</sup> Ky rrezik mund të jetë shumë i madh për Kosovën në periudhën afatshkurtër meqë ajo përballet me kufizime financiare strikte.

---

<sup>15</sup> “Dollarizimi” i plotë i referohet në përgjithësi adoptimit joformal apo zyrtar të një paraje të huaj për të gjitha pagesat.

<sup>16</sup> Duhet të vihet re se dollarizimi i plotë nuk e parandalon një krizë të rëndë financiare. Dhënia e kredive kompanive që nuk kanë performancë të mirë, gjithmonë përfshin rrezikun e mospagimit. Në fund të fundit, krizat mund të shmangen nëse ekziston një kornizë e fortë rregullatore dhe mbikqyrëse që udhëheq marrëdhëniet bankare. Për një diskutim të shkurtër rreth kësaj çështjeje mund të lexoni Lilian Rojas-Suarez, (2003).

**Tabela 2.5: Bilanci i Pagesave (përqindje e PBB)**

	2000	2001	2002	2003
	vlerës	vlerës	vlerës	vlerësi
	m			
Bilanci tregtar	-206.9	-127.2	-108.0	-97.4
Eksportet	0.5	3.0	7.4	8.2
Jo të huajt apo KFOR	0.5	3.0	7.4	8.2
Importet	207.4	130.1	115.4	105.5
Që kanë lidhje me donatorët	51.0	16.5	7.1	6.3
Që nuk kanë lidhje me donatorët	156.4	113.7	108.3	99.2
Shërbimet jofaktoriale	-58.7	-45.2	-39.7	-28.4
Të ardhurat	26.1	17.2	13.6	11.0
Të huajt apo KFOR	22.1	14.5	11.4	8.5
Pagesat	84.9	62.4	53.3	39.4
Pagat që u atribuohen të huajve	60.0	46.7	39.8	28.8
Pagat që u atribuohen punëtorëve lokalë				
Tjetër	7.6	5.5	5.3	5.0
Transferat Private	73.7	52.0	42.9	43.2
Remitancat e punëtorëve	73.7	52.0	42.9	43.2
Të ardhurat faktoriale	17.3	10.2	8.2	5.7
Pagat e UNMIKut dhe donatorëve për punëtorët lokalë	17.3	10.2	8.2	5.7
Bilanci i llogarisë korrente (para granteve)	-174.6	-110.2	-96.5	-76.9
Asistenca e huaj	152.5	91.0	63.0	44.0
Nga e cila UNMIK	55.3	38.9	30.3	28.0
PIP	76.5	46.1	29.3	13.2
Llogaria kapitale	22.1	19.1	33.5	32.9
Pjesëmarrja e kapitalit të donatorëve	5.6	2.8	0.8	0.1
Ndryshimet e depozitave të qeverisë jashtë (- rritje)	-9.8	0.4	6.1	-0.6
Ndryshimet në paranë në qarkullim (- rritje)	-11.3	18.9	-5.8	-0.5
Ndryshimet në NFA-në e sistemit bankar (- rritje)	-16.1	-39.9	-5.2	-1.5
Ndryshimet në asetet e huaja të TKPK	0.0	0.0	0.0	-2.4
Gabimet dhe mospërfshirjet	53.5	37.0	37.7	37.9

*Burimi:* Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2003.

## Pengesat Financiare

2.21 Pozicioni i jashtëm financiar është përmirësuar dukshëm që nga viti 2000 (Tabela 2.5). Deficiti i llogarisë korrente, para granteve, është pothuajse përgjysmuar në tre vitet e fundit dhe ka arritur vlerën prej 77 përqind të PBB-së, kryesisht për shkak të përmirësimit të bilancit të tregtisë së mallrave si rezultat i tkurrjes së importeve.<sup>17</sup> Situata e jashtme

<sup>17</sup> Duhet të vihet re se ekziston pasiguri e konsiderueshme rreth saktësisë së vlerësimeve të bilancit të pagesave. Gabimet dhe pjesët e lëna jashtë janë rritur në madhësi dhe përbënin 49 përqind të deficitit të llogarisë korrente në 2003. Sidoqoftë, për shkak të përpjekjeve për të frenuar kontrabandën, nuk ka gjasa që

nuk është aspak e qëndrueshme: deficitit tregtar në 2003 ishte rreth 97 përqind e PBB-së. Eksportet janë rritur shpejt në katër vitet e fundit, por nga një bazë shumë e vogël; eksportet e mallrave aktualisht janë vetëm rreth 4 përqind e importeve.

2.22 Rënia e asistencës së huaj sjell ndërlikime për financimin dhe përballimin e deficitit tregtar. Pjesa e deficitit të tregtisë së mallrave të financuar nga asistenca e huaj<sup>18</sup> ka rënë nga 73 përqind në 45 përqind nga viti 2000 në 2003, dhe si pasojë barra financuese gjithnjë e më tepër ka rënë tek remitancat. Por, norma e rritjes së remitancave gjithashtu është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme në vitet e fundit dhe tani është pothuajse e njëjtë me normën nominale të rritjes së ekonomive të Europës Perëndimore. Qasja në tregjet e kapitalit është e kufizuar si rezultat i statusit ligjor të Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, qasja në financimin me koncesion deri tani nuk ka qënë e mundur, megjithësi autoritetet dhe KB aktualisht po konsiderojnë marrëveshje ligjore që mund t'i mundësonin Kosovën të merrte kredi të jashtme nga INF-të (Institucionet Ndërkombëtare Financiare). Për më tepër, nevoja për të shmangur përqendrimin në shtim e sipër të sektorit privat nga tregjet e kreditit, do të thotë që kredimarrja vendore nuk ka gjasa të jetë një mundësi e financimit në të ardhmen e afërt.

## C. MUNDËSITË PËR RITJE NË PERIUdhËN AFATMESME

### Skenaret Afatmesme të Rritjes

2.23 Për të eksploruar perspektivën e rritjes ekonomike për Kosovën, u kryen një numër simulimesh për të përcaktuar normat e mundshme të rritjes sipas tre skenarëve të ndryshëm. Sigurisht, baza e dobët statistikore e pengon një ushtrim më teknik të parashikimit ekonometrik dhe duhet pasur parasysh edhe mungesa e të dhënave të sigurta makroekonomike. Këto simulime ilustron faktin se si supozimet e ndryshme rreth të ardhmes, mund të sjellin rezultate të ndryshme ekonomike. Skenari i rastit bazë supozon (i) një përpjekje të fuqishme reformash për përmirësimin e klimës së tregtisë dhe investimeve dhe rehabilitimin e sektorëve industrialë e bujqësorë dhe (ii) veprime që do të zbusnin rreziqet politike si p.sh. qartësimi i marrëveshjeve politike dhe ligjore për Kosovën në vitin 2006, që pranohet nga të gjitha palët. Nuk bëhen supozime rreth natyrës së saktë të këtij rezultati politik, vetëm rreth ndikimit ekonomik të sigurisë më të madhe për situatën politike dhe ligjore. Këto paraqiten qartë në kutinë 2.1 më poshtë. Për krahasim, konsiderohen edhe dy skenarë alternativë. Së pari, reformat e shpejta vazhdojnë sipas rastit bazë, por rreziqet politike janë më të mëdha marrëveshjet politike nuk janë qartësuar deri në vitin 2008. Skenari i fundit që konsiderohet shqyrton perspektivën në rast se reformat vazhdojnë në mënyrë të ngadalshme, ndërkohë që rreziqet politike mbesin të mëdha.

---

lëvizjet e paregjistruara tregtare të shpjegojnë plotësisht papërputhshmëritë në kontabilitet dhe një shumë për kontrabandën tashmë përfshihet në vlerësimet e eksporteve të BoP-së.

<sup>18</sup> Përfshin buxhetin e UNMIK-ut.

## Kutia 2.1 Supozimet e skenarit Makroekonomik

Një program i fortë reformash përfshin supozimet e mëposhtme:

- Reformat në sektorin e ndërmarrjeve, tregun e punës, dhe sektorin energjitik në mënyrë të konsiderueshme e përmirësojnë ambientin e biznesit dhe efikasitetin e ekonomisë. Integrimi me tregjet rajonale dhe të tjera përshpejtohet, gjë që e përmirëson shumë potencialin për eksport, sidomos për prodhime bujqësore.
- Ka një rritje graduale të IHD që tërhiqen nga programi i privatizimit dhe potenciali për eksport, sidomos në sektorët e minierave<sup>19</sup> Por të ardhurat nga privatizimi, supozohet të jenë të neglizhueshme, e prandaj nuk merren parasysh.
- Reforma fiskale përfshin një reduktim gradual të faturës së pagave nga 11.7 përqind e PBB-së në 2004 deri në mesataren rajonale prej 8 përqind të PBB-së deri në vitin 2010.
- Investimet kapitale të financuara nga BKK rriten në mënyrë domethënëse duke filluar në 2004 deri në 200 milionë euro, apo 14.5 përqind e PBB-së. Si pasojë, ka një rënie graduale si përqindje e PBB-së, por duke konsideruar sasinë në euro kjo mbetet konstante. Supozohet se kapaciteti për të shpenzuar mjetet e caktuara buxhetore përmirësohet me rritjen, duke rezultuar në infrastrukturë publike të përmirësuar, duke përfshirë rrjetet e rrugëve, shkollat, qendrat e shëndetit etj. PIP i financiar nga donatorët në mënyrë graduale do të mbarojë përfundimisht in 2005.
- Ndihma totale e granteve të donatorëve zvogëlohet vazhdimisht deri në 3 përqind të PBB-së në 2010 nga 30 përqind e PBB-së në vitin 2004.

Për qëllimet e simulimit, rreziqe më të ulëta politike arrihen nëpërmjet qartësisimit më të madh të marrëveshjeve ligjore dhe politike për Kosovën që rezultojnë me supozimet e mëposhtme:

- Stabilitet politik dhe institucional dhe zotërimi i plotë i ligjit.
- Qasja në kredinë e huaj mundësohet në mënyrë direkte apo indirekte me SHZHNn dhe kredihënës të tjerë zyrtarë. Kushtet mesatare i japin peshë të barabartë kushteve të SHZHN-s dhe kushtet që janë aplikuar kohët e fundit nga BEI dhe BERZH ndaj SMZ.
- Për shkak të pasigurisë së detyrimeve të jashtme neto, stoku dhe detyrimet e borxhit të huaj për provincën supozohen të jenë zero.
- IHD të konsiderueshme tërhiqen në investimet që sjellin ndërtimin e ndërmarrjeve të reja prodhuese në sektorët e energjitikës dhe minierave (të ashtëquajtura investime Greenfield), sapo që marrëveshjet politike dhe ligjore të mundësojnë sigurinë e këtyre asetëve. Kjo përfshin hapjen e minierave të reja të linjtit, prezantimin e një uzine të prodhimit të energjisë elektrike që drejtohet nga sektori privat e që do të prodhonte energji të mjaftueshme për eksport, dhe investitorë të rinj në minierat e plumbit/zinkut, që fillimisht kanë nevojë për importe të konsiderueshme të kapitalit por që e rrisin shumë eksportin në vitet në vazhdim

2.24 Tabela 2.6 paraqet rezultatet e këtyre simulimeve. Në skenarin e rastit bazë, investimi rritet shpejt, nga një vlerë e pritshme prej 45 përqind të PBB-së në vitin 2004

<sup>19</sup> Supozohet se në disa sektorë (si p.sh. nënsektori i ferronikelit) kompromisi midis rrezikut dhe rezultatit është i tillë që rreziqet politike mund të zbuten lehtësisht duke mundësuar tërheqjen e investimeve të huaja dhe shfrytëzimin e potencialit për eksport.

në një mesatare prej 59 përqind të PBB-së në tre vitet në vazhdim.<sup>20</sup> Kjo përfshin një mesatare të IHD prej rreth 15 përqind të PBB-së nga 2005 në 2007 të tërhequra nga investimet në sektorët e energjitikës dhe minierave, që më vonë do të pakësohen drejt mesatares së Europës Qendrore prej 4 përqind të PBB-së në fund të dekadës. Ruhët disiplina fiskale. Reformat çojnë në një ndryshim të deficiteve në fillim të periudhës së projektuar, duke rezultuar në një suficit mesatar prej 1 përqind të PBB-së. Në këtë skenar, kushtet e jashtme përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme. Rritja e eksporteve është shumë e fuqishme nga 2005 në 2007, me një mesatare prej 11 përqind, që do të ketë fitime nga bujqësia dhe sektori i minierave. Rritja e eksporteve arrin gati 29 përqind në fund të dekadës, kryesisht për shkak të supozimit që investimi i brendshëm rezulton në eksporte neto të energjisë elektrike.

2.25 Simulimi i rastit bazë përfaqëson perspektivën më optimiste për mundësitë e rritjes në të ardhmen. Ky skenar rezulton në rritje positive të PKB-së (Prodhimit të Brendshëm Bruto) për frymë. Rritja mesatare e PBB-së reale do të ishte rreth 6.7 përqind mes viteve 2005 dhe 2007, dhe 5 përqind gjatë periudhës së fundit të dekadës. Deficiti i llogarisë korrente rritet si pasojë e rritjes së importeve të mallrave kapitale që kanë lidhje me IHD dhe rivitalizimin e sektorëve kyç ekonomikë. Sidoqoftë, rritja e shpejtë e eksporteve ndihmon parandalimin e një rritjeje të paqëndrueshme të deficitit të llogarisë korrente. Në këtë model, deficiti i jashtëm, që vlerësohet të jetë 45 përqind e PBB-së në vitin 2004, rritet në 53 përqind të PBB-së mesatarisht gjatë viteve 2005 dhe 2007, dhe bie në 25 përqind të PBB-së në 2010. Këto nevoja të jashtme financiare plotësohen pjesërisht me hyrjet e IHD, dhe pagesat nga kredithënësit zyrtarë që arrijnë vlera mesatare prej 6 përqind të PBB-së në 2005 deri në 2007 dhe 7.5 përqind të PBB-së në 2008 deri në 2010.<sup>21</sup> Mbeten të pacaktuara nevojat financiare prej rreth 5 përqind të PBB-së në periudhën e parë dhe 3 përqind në të dytën.

2.26 Kolona e dytë dhe e tretë e tabelës 2.6 japin rezultatet e dy skenarëve alternativë: reformë e shpejtë dhe reformë e ngadaltë me rreziqet politike më të mëdha dhe marrëveshjet politike e ligjore të sqaruara dy vjet më vonë se në rastin bazë. Në skenarin e dytë, siç pritet, fillimisht do të ketë një rritje prej 4.2 përqind në vit që bie në rreth 3.5 përqind pas vitit 2008. Kjo është me e ulët se rasti bazë, sidomos në periudhën fillestare, duke rezultuar në rritje zero të PKB-së për frymë gjatë gjithë periudhës. Supozohet se disa IHD do të hyjnë në nënsektorët e minierave, por investimet e konsiderueshme që sjellin ndërtimin e ndermarrjeve të reja prodhuese vonohen edhe për dy vite. Rritja e eksportit në këtë skenar do të ishte rreth 60 deri 70 përqind e normës së projektuar në rastin bazë. Rezultati është një rritje më e ulët dhe një boshllëk më i madh i pacaktuar i financimit me një vlerë mesatare prej 8 përqind të PBB-së mes viteve 2005 dhe 2010, që pjesërisht reflekton qasjen e reduktuar në kredimarrjen e huaj në gjysmën e parë të periudhës së projektimit.

2.27 Nëse reformat vonohen, dhe marrëveshjet politike e ligjore nuk qartësohen, do të vonohet edhe më tepër progresi për tërheqjen e investimeve dhe nxitjen e eksporteve. Si

---

<sup>20</sup> Projektioni i të gjitha ndryshoreve për vitin 2004 supozohet të jetë i njëjtë në të gjitha skenaret.

<sup>21</sup> Deficiti i llogarisë korrente përfshin kostot e projektuara të interesit që kanë lidhje me kredimarrjen e re dhe rikthimin e profitit sipas një norme prej 10 përqind të stokut të IHD pas tre viteve. Amortizimi i borxhit është zero gjatë gjithë periudhës së projektimit për shkak të periudhave të gjata të mospagimit të dënimeve edhe kur kalon afati, ku nuk paguhen interesa shtesë.

rezultat, rritja e PBB-së projektohet të jetë pak më shumë se 2 përqind. Rritja e PKB-së për frymë ka gjasa të jetë negative. Si në skenarin paraardhës, fillimisht rritja e eksporteve është e vogël, IHD janë të ulëta, dhe financimi ndërkombëtar është më pak i pranishëm. Boshllëqet e financimit, pas projeksioneve zyrtare të kredimarrjes janë shumë të larta, mesatarisht 19 përqind e PBB-së në këtë skenar.

2.28 Është gjithashtu interesante të krahasohen me njëri-tjetrin dy skenarët alternativë. Edhe me rreziqe politike më të mëdha, dhe marrëveshje ligjore të pasqaruara rezultatet që vijnë nga reforma e shpejtë janë: norma më të larta reale të rritjes, ruajtja e PKB për frymë, dhe një boshllëk financiar më i qëndrueshëm i arritur para fundit të periudhës së projeksionit. Për më tepër, këtu duhet theksuar që në këto skenare fillimisht kemi supozuar që IHD do të jenë të disponueshme pas zgjidhjes paqësore të marrëveshjeve politike e ligjore për të gjithë njerëzit, zbutjen e rrezikut politik dhe një numri minimal të reformave institucionale e ekonomike. Prandaj, investimet e konsiderueshme që sjellin ndërtimin e ndermarrjeve të reja prodhuese nuk ndikohen shumë nga shpejtësia e programit të reformave. Nqs supozojmë që tërheqja e IHD do të ishte më pak e suksesshme me një program reformash të ngadaltë, sigurisht që do të kishte një ndryshim edhe më të madh në performancën e rritjes, eksportit dhe IHD mes skenarëve të shpejtë e të ngadaltë të reformave ekonomike.

2.29 Këto skenarë dëshmuar sugjerojnë që implementimi i shpejtë i reformave, zbutja e rrezikut politik dhe qartësia më e madhe e marrëveshjeve politike dhe ligjore që i kënaq të gjithë njerëzit kanë gjasa të sjellin norma më të larta të rritjes dhe një pozicion të jashtëm më të qëndrueshëm. Sidoqoftë skenarët janë thjesht dëshmuar, dhe duhet të jetë e qartë se supozohet se programi i reformave, qartësimi i marrëveshjeve ligjore e politike të kënaqshme për të gjithë njerëzit dhe rreziqet e zvogëluara politike për investitorët do të rezultojnë në rritjen domethënëse të IHD dhe eksporteve. Në realitet, cilësia e implementimit të programit të reformave, dhe natyra e saktë e statusit të ardhshëm politik do të përcaktojnë madhësinë se sa do të rriten investimet dhe eksportet, natyrën e mundësisë për të marrë hua të jashtme, duke përfshirë ato me koncesion, dhe përfundimisht normën e rritjes së ekonomisë dhe begatinë e Kosovës. Progresi me programin e ‘Standardet për Status’ është një hap i domosdoshëm për ta siguruar këtë stabilitet. Pa minimumin e institucioneve funksionuese, ekziston rreziku i krijimit të një ambienti të paqëndrueshëm si dhe pasiguri ekstreme, dhe si rezultat i një rënieje të shpejtë të të ardhurave dhe indikatorëve socialë që vërehen në rajonet e paqëndrueshme të botës.

**Tabela 2.6: Përmbledhje e Rezultateve të Simulimeve**

	<b>Reformë e Shpejtë, Rreziqe Politike të Zbutura</b>	<b>Reformë e Shpejtë, Rreziqe Politike të Mëdha</b>	<b>Reformë e Ngadaltë, Rreziqe Politike të Mëdha</b>
Rritja e PBB-së (% , reale mesatare)			
2005-2007	6.7	4.2	2.3
2008-2010	5.0	3.5	2.2
Rritja e Eksporteve (% , nominale në €)			
2005-2007	11.4	7.1	5.6
2008-2010	28.5	29.9	29.6

<b>Investimet (% e PBB)</b>			
2005-2007	37.1	28.6	24.9
2008-2010	24.7	34.0	31.9
<b>Kursimet vendore bruto (% PBB)</b>			
2005-2007	-52.9	-71.4	-77.4
2008-2010	-24.5	-52.1	-64.4
<b>Investimet publike (% PBB)</b>			
2005-2007	13.3	13.9	7.8
2008-2010	10.0	11.0	7.8
<b>Bilanci buxhetor (% PBB)</b>			
2005-2007	-3.6	-3.8	1.3
2008-2010	0.4	0.0	1.7
<b>Bilanci i llogarisë korrente (% PBB)</b>			
2005-2007	-52.9	-43.1	-44.8
2008-2010	-24.5	-41.4	-48.6
<b>Investimet e huaja direkte (% PBB)</b>			
2005-2007	14.8	1.2	1.2
2008-2010	8.7	15.0	16.0
<b>Kredidhënia zyrtare</b>			
2005-2007	5.9	0.0	0.0
2008-2010	7.5	8.3	8.9
<b>Boshllëku total i financimit gjatë periudhës (% PBB)</b>			
2005-2007	5.0	12.4	13.9
2008-2010	3.1	3.4	8.2
<b>Memorandum:</b>			
<b>Kredidhënia zyrtare (mesatare., milionë €)</b>			
2005-2007	100	0	0
2008-2010	150	150	150
<b>Remitancat e Punëtorëve (mesatarja 2004-2010)</b>			
	663	663	663
<b>Asistenca e huaj (mesatarja 2004-2010)</b>			
	175	175	175
<b>Rritja reale e PBB-së në 2004</b>			
	6.5	6.5	6.5
<b>PKB për frymë në 2010 (€) 1/</b>			
	893	865	797
<b>Rritja e PKB mesatare për frymë (2004-2010)</b>			
	0.6	0.0	-1.4

1/ PKB përkufizohet si PBB plus të ardhurat neto të faktorëve, që përfshin riatdhesimin e profitit që ka lidhje me IHD.

*Burimi:* Banka Botërore.

#### **D. REKOMANDIMET RRETH LINJAVE TË VEPRIMIT:**

- Të sigurohet që pozicioni fiskal të jetë në gjëndje të përballet me ndryshimet që vijnë pas rënies së financimeve të jashtme. Të ruhen rezerva buxhetore që do të mbronin financat publike dhe ekonominë më të gjërë, dhe të shmangen ndryshimet e kushtueshme të politikave.

- Brenda këtij pozicioni fiskal të vazhdohen projektet e mireplanifikuara dhe të prioritizuara kapitale për përfundimin e rehabilitimit të infrastrukturës.
- T'u rezistohet presioneve për të harxhuar në shpenzime të përsëritura të paqëndrueshme, duke përfshirë edhe pagat e sektorit publik.
- Të kryhet një analizë e detajuar e efikasitetit të shpenzimeve publike, dhe më tej të zhvillohet një kornizë afatmesme shpenzimesh që do të siguronte stabilitetin buxhetor.
- Të përmirësohen administrata tatimore dhe baza e të ardhurave indirekte vendore.
- Të rishqyrtohet politika e të ardhurave për të hetuar nëse ekziston një nivel i lartë i tatimeve që vepron si frenues i rritjes ekonomike.
- Të ndiqet implementimi i Standardeve dhe të merren masa për të zbutur rreziqet politike; dhe të rritet siguria ligjore e politike.

### 3. KLIMA PËR TREGTINË, INVESTIMET DHE FINANCAT

#### A. HYRJE

3.1 Ky kapitull shqyrton ambientin e biznesit dhe tregtisë në Kosovë. Seksioni i parë shqyrton regjimin tregtar ndërkombëtar dhe performancën e tregtisë. Seksioni i dytë vlerëson klimën e biznesit nga perspektiva e NVM-ve, bazuar në rezultatet e një Vlerësimi të Klimës së Investimeve Seksioni i fundit shqyrton gjëndjen e zhvillimit të sektorit financiar në Kosovë bazuar në një anketim të institucioneve financiare lokale. Lëmitë që kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm dhe rekomandimet e politikave jepen në fund të secilit prej këtyre seksioneve.

#### B. TREGTIA NDËRKOMBËTARE

3.2 Nga një regjim tepër mbrojtës si pjesë e RSF të Jugosllavisë, regjimi tregtar në Kosovë është bërë një nga më liberalët në rajon. Pas vitit 1999, u pranua që Kosova “zotëronte një administratë tatimore”, dhe UNMIK-ut iu dha autoriteti për të bërë marrëveshje tregtie me administratat e tjera. Kosova gjithashtu përfiton nga marrëveshjet ekzistuese tregtare që ishin bërë me RSF të Jugosllavisë si p.sh. marrëveshja e tregtisë së lirë me IRJ të Maqedonisë, sipas së cilës e gjithë tregtia mes Kosovës dhe IRJ të Maqedonisë i nënshtrohet vetëm një pagese administrative prej 1 përqind. Të gjitha kufizimet sasiore janë zhdukur, dhe kursi i këmbimit i hapi rrugë adoptimit të euros. Një normë tarifore uniforme prej 10 përqind u adoptua, me një listë të kufizuar të përjashtimeve (p.sh. mallrat farmaceutike, plehurat). Nuk ka pagesa apo kosto shtesë për importet apo eksportet.<sup>22</sup>

#### Performanca e Tregtisë

3.3 Mbledhja e të dhënave tregtare dhe përcaktimet e ndryshme që përdoren për tregtinë e brendshme dhe ndërkombëtare pengojnë analizën e performancës tregtare të Kosovës.<sup>23</sup> Ky seksion shqyrton trendet tregtare bazuar në të dhënat e tregtisë së mallrave, që nuk përfshijnë importet e komunitetit ndërkombëtar, që nga 1999.

---

<sup>22</sup> TVSH aplikohet për importet por jo eksportet e mallrave përfundimtare.

<sup>23</sup> Të dhënat tregtare nuk janë të konsoliduara dhe e kufizojnë analizën e tregtisë ndërkombëtare që nga shpërbërja e RFS të Jugosllavisë. Që nga viti 1999 janë përdorur përkufizime të ndryshme për të përcaktuar cila është tregtia ndërkombëtare dhe e brendshme, p.sh. shqyrtimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për tregtinë në 2000 dhe 2001 nuk përfshinin importet nga Serbia dhe Mali i Zi. Për më tepër, shitjet vendore që u bëhen të huajve rezidentë konsiderohen si eksporte në Llogaritë e të Ardhurave Kombëtare. Performanca e tregtisë së mallrave përjashton shitjet që u bëhen të huajve rezidentë dhe importet e financuara nga komuniteti i donatorëve që hyjnë pa paguar taksa doganore dhe nuk paraqiten në statistika. Eksportet dhe importet e mallrave përbënin respektivisht 14 dhe 51 përqind të eksporteve të përgjithshme,

3.4 Megjithëse situata është përmirësuar gjatë tre viteve të fundit, prapë ekziston një mosbilancim i madh tregtar. Bilanci i mallrave dhe shërbimeve vlerësohet të ketë rënë nga një deficit prej 265 përqind e PBB-së në 125 përqind nga 2000 në 2003. Të dhënat e tregtisë së mallrave tregojnë që eksportet janë aktualisht më pak se 4 përqind e importeve. Tabela 3.1 tregon performancën e eksporteve dhe importeve dhe partnerët kryesorë tregtarë që nga viti 2000. Tregtia zhvillohet kryesisht me BE, Serbinë dhe Malin e Zi, dhe IRJ të Maqedonisë, që së bashku përbëjnë dy të tretat e vlerës së tregtisë totale. BE është tregu më i madh, që rezulton në një tipar indirekt të tregtisë në rajon.

3.5 **Në vitet e fundit Kosova ka arritur të eksportojë volume të vogla në bujqësi, tekstile, pajisje elektrike dhe metale, duke përfshirë nikelin.** Vlera e mallrave totale të eksportuara vlerësohet të jetë rritur me më shumë se 90 përqind nga 2000 në 2003, megjithëse ka filluar prej një baze shumë të vogël. Në 2003, vlera e metaleve dhe mbetjeve dhe vlera e eksportit ushqimor, vlerësoheshin të ishin pesë herë më të mëdha se vlerat respektive në euro në vitin 2001. Eksportet pothuajse ekskluzivisht janë për BE dhe rajonin e Europës Juglindore.

3.6 Përbërja e importeve kosovare që nuk financohen nga donatorët, shfaq dominimin e konsumit aktual në vend të mallrave industriale në vlerën e importeve. Megjithatë, ka evidencë të një rritje graduale të aktivitetit industrial. Megjithëse importet e makinerive vazhdojnë të përfaqësojnë vetëm 12 përqind të importeve të përgjithshme, vlera e këtyre importeve është rritur me 70 përqind në periudhën mes 2000 dhe 2003. Por importi ushqimor vazhdon të jetë komponenti më i madh – duke përfaqësuar rreth 34 përqind të vlerës së importeve në 2003.

3.7 **Performanca tregtare e Kosovës duhet parë në kontekstin e marrëdhënieve rajonale të cilat kanë vuajtur që nga ndarja e RSF të Jugosllavisë.** Struktura tregtare rajonale gjithashtu e ndikon Kosovën – sidomos meqë tregtia mbetet minimale mes SMZ dhe Kroacisë, Shqipërisë dhe Kroacisë dhe Shqipërisë dhe SMZ<sup>24</sup>. Për më tepër, tregtia në rajon është më pak e hapur në përgjithësi sesa në vendet e Europës Qendrore e Lindore.

---

duke përfshirë shitjet që u bëhen të huajve dhe importet e përgjithshme, duke përfshirë ato që financohen nga komuniteti ndërkombëtar.

<sup>24</sup> Shiko Banka Botërore 2003a për një shqyrtim më gjithëpërfshirës të tregtisë në Ballkanin Perëndimor.

**Tabela 3.1: Tregjet e Eksportit dhe Importit (për tregtinë e mallrave)**

	Eksportet				Importet			
	2000	2001	2002	2003	2000	2001	2002	2003
<b>Totali (milionë €)</b>	18.88	10.65	27.32	36.20	635.2	874.4	988.7	968.5
<b>Nga të cilat %</b>								
<b>BE<sup>25</sup></b>	30.0	45.5	43.2	38.4	27.0	20.3	23.6	25.9
<b>IRJ, Maqedonia</b>	26.7	18.7	12.4	19.2	25.6	20.1	15.4	14.6
<b>Serbia</b>	0.1	3.7	16.4	16.5	2.4	20.2	18.0	14.7
<b>Shqipëria</b>	20.8	12.0	5.0	5.2	1.6	3.5	4.9	0.8
<b>Kroacia</b>	0.3	1.3	7.0	5.0	0.4	1.1	1.6	3.3
<b>Turqia</b>	8.1	2.4	4.2	4.8	5.2	8.9	7.9	9.5
<b>Mali i Zi</b>	1.6	6.2	0.5	2.8	16.9	7.1	6.4	1.1
<b>Bosnia dhe Hercegovina</b>	0.9	2.6	5.1	2.4	4.1	2.6	2.2	2.4
<b>Bullgaria</b>	1.5	0.8	0.6	0.5	6.7	5.7	5.7	4.3
<b>Tjetër</b>	9.9	6.7	5.6	5.2	10.2	10.5	14.3	23.5

*Burimi:* Shërbimi doganor i Kosovës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## Marrëdhëniet Tregtare dhe Kushtet e Qasjes në Tregje

3.8 **Kosova dhe rajoni përfitojnë mjaft nga qasja që kanë në tregjet e BE pa paguar taksa.** Në fund të vitit 2000, BE krijoi një skemë uniforme dhe bujare të Preferencës së Tregtisë Autonome (PTA), e cila i jep mundësinë gjithë Europës Juglindore, që të eksportojë praktikisht pa paguar taksa dhe kuota në tregjet e BE.<sup>26</sup> BE filloi procesin e Stabilizimit dhe Asociimit (SAP) për të caktuar kornizën e përgjithshme ligjore për marrëdhëniet e ardhshme ekonomike dhe politike mes BE dhe pesë vendeve të rajonit.<sup>27</sup>

3.9 Tregtia në rajon është nxitur me anë të krijimit të një rrjeti të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë (MTL) bilaterale, nën udhëheqjen e Grupit Punues të Paktit të Stabilitetit rreth Liberalizimit dhe Lehtësimit të Tregtisë.<sup>28</sup> Autoritetet kosovare tashmë kanë përfunduar një MTL me Shqipërinë. **Për momentin, ky rrjet i marrëveshjeve dypalëshe nuk përbën një Zonë të vertetë të Tregtisë së Lirë meqë ka përjashtime dhe orare të ndryshme për liberalizim mes vendeve pjesëmarrëse.** Në periudhën afatgjatë, rajoni ka rënë dakort që të krijojë një MTL multilaterale mes të gjithë partnerëve tregtarë të Ballkanit. Kosova, nëpërmjet përfshirjes së saj në Grupin Punues duhet të vazhdojë të mbështesë qasjen për liberalizimin e tregtisë në rajon, të heqë pengesat administrative dhe tarifore dhe të punojë drejt një MTL rajonale.

<sup>25</sup> Të dhënat për BE përfshijnë Zvicrën.

<sup>26</sup> Kuotat aplikohen për mishin e viçit, tekstilet dhe verën.

<sup>27</sup> Pesë vendet janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, IRJ e Maqedonisë dhe Serbia e Mali i Zi (duke përfshirë Kosovën).

<sup>28</sup> Pakti i Stabilitetit u themelua me iniciativën e BE në 1999 për të nxitur paqen, demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe begatinë ekonomike me qëllim të arritjes së stabilitetit në krejt rajonin. Sipas rregullave dhe parimeve të OBT, dhe në kontekstin e integritimit më të madh me Bashkimin Europian, Grupi Punues rreth Liberalizimit dhe Lehtësimit të Tregtisë ka për qëllim të reduktojë dhe eliminojë pengesat tarifore e jotarifore për tregtinë. Ka kapacitetin për të koordinuar, lehtësuar dhe shqyrtuar përpjekjet e vendeve për të zgjeruar tregtinë në rajon.

**3.10 Ka disa shqetësime se marrëveshjet bilaterale tregtare aktuale janë burim potencial i distorcioneve tregtare, dhe ekziston potenciali për të abuzuar me rregullat e origjinës aty ku ekzistojnë marrëveshjet e qasjes preferenciale.** Në rastin e MTL me IRJ të Maqedonisë ekziston një perceptim i përhapur që po ndodh falsifikimi i certifikatave të origjinës. Në 2001, UNMIK-u ktheu 183 palë dokumente doganore që shoqëronin mallrat e IRJ të Maqedonisë te autoritetet doganore për verifikim. Ekziston shqetësimi që MTL-të e saponegociuara do të paraqesin mundësi të ngjashme. Prandaj autoritetet duhet të peshojnë me kujdes kostot dhe përfitimet potenciale ekonomike të MTL bilaterale individuale gjatë negociatave dhe duhet të vazhdojnë punën drejt krijimit të një MTL rajonale.

**3.11 Kosova përballet me pengesa të tjera tarifore dhe jotarifore për tregtinë në rajon.** Tregtia brenda SMZ disa herë konsiderohet e brendshme dhe disa herë ndërkombëtare për qëllimet e aplikimit të tarifave dhe taksave. Mallrat me origjinë kosovare që hyjnë në Serbi i nënshtrohen një takse të shitjes prej 5 përqind, (diferenca mes TVSH-së në Kosovë dhe taksës së shitjes në Serbi) por përndryshe janë të lira nga nga tarifatat, por mallrat që hyjnë në Malin e Zi trajtohen sikur vijnë nga një vend i tretë dhe i nënshtrohen regjimit tarifor. Përveç taksave tregtare, vendet e rajonit shpesh aplikojnë një taksë tranzit për mallrat që kalojnë nëpërmjet territorit të tyre doganor (një pagesë tranzite prej 5 përqind aplikohet për mallrat që hyjnë në Shqipëri, Mal të Zi, dhe Serbi) dhe në disa raste edhe një pagesë për menaxhimin e doganave (p.sh., 1 përqind në Bosnje dhe Hercegovinë). Pengesat administrative përfshijnë mosnjohjen e targave kosovare për tranzit nëpër vendet fqinje dhe mungesa e barkodit të Kosovës për artikujt e prodhuar.

### **Politikat dhe Institucionet Tregtare**

**3.12 Ekziston një normë tarifore prej 10 përqind për të gjitha importet, e cila është një normë tarifore e arsyeshme mesatare e ulët brenda rajonit.** Akcizat gjithashtu vihen ekskluzivisht për importe: aktualisht janë të kufizuara me lëndët djegëse, alkoholin, cigaret dhe purot, duhanin, kafënë dhe pijet e ëmbla. Tarifa një-nivele e është një regjim transparent që redukton mundësitë për kontrabandë, korrupsion dhe manipulime dhe mundësinë e keqklasifikimit të produkteve.<sup>29</sup> Sidoqoftë, siç diskutohet në seksionin e ardhshëm, komuniteti i biznesit kosovar i konsideron politikat tregtare si pengesë. Flitet se norma e kombinuar e TVSh-së dhe tarifës së importeve është e lartë për prodhuesit vendorë, sidomos për ata që për inputet e tyre mbështeten në lëndën e parë dhe mallrat gjysëm të gatshme të importuara. Por, TVSH-ja e paguar për të gjitha inputet, duke përfshirë importet kreditohet. Tabela 3.2 paraqet TVSH-në dhe normat mesatare të tarifave në rajon. Ulja e normës uniforme tarifore për të gjitha mallrat do të ulte edhe koston e inputeve të importuara, dhe do të përmirësonte më tej konkurrueshmërinë e prodhuesve vendorë. Nevojitet hulumtim i mëtejshëm i normave me të cilat përballen prodhuesit në sektorët individualë dhe konkurruesit e tyre rajonale për të përcaktuar ndikimin në sektorët specifikë ekonomikë.

<sup>29</sup> Por, ka pretendime që zyrtarët e doganave përdorin çmime reference të aplikuara në mënyrë të parregullt.

**Tabela 3.2: Normat e TVSH-ve rajonale dhe Tarifës Mesatare**

	TVSH (%)	Tarifa mesatare e kombit më të favorizuar (%)
Kosova	15	10.0
Republika Ceke	22	4.6
Kroacia*	22	5.0
Shqipëria*	20	7.4
Serbia*1/	20	9.4
IRJ Maqedonia*	19	12.6
Polonia	22	10.0

*Burimi:* \*P. Messerlin dhe S. Miroudot, 'Liberalizimi i Tregtosë në Europën Juglindore; Shqyrtim i Pajtueshmërisë së 23 MTL-ve me MOU' Group D'Economie Mondiale, Paris, 2004

Qendra për Informacion të Biznesit në Europën Qendrore dhe Lindore.

(<http://www.mac.doc.gov/ceebic>)

3.13 Norma uniforme tarifore aplikohet për të gjitha mallrat e importuara. Kjo mund të dekurajonte eksportet, meqë eksportuesit kosovarë paguajnë çmime më të larta se ato të tregut botëror për inputet e tyre, duke u vënë kështu në një disavantazh konkurrencial. Me qëllim të nxitjes së eksportuesve vendorë, duhen konsideruar mënyra për të eliminuar tarifën për inputet e importuara që përdoren për prodhimin e eksporteve, si p.sh. prezantimi i një skeme të kthimit të taksës dhe mundësisht të zonave të përpunimit(zhvillimit) të eksporteve (ekziston evidencë e përzier rreth suksesit të marrëveshjeve të tilla dhe këshillohet që të bëhet punë e mëtejshme rreth potencialit të prezantimit të tyre në Kosovë). Kodi aktual i doganave lejon përdorimin e skemës së tërheqjes dhe nevojitet punë e mëtejshme për të përcaktuar si mund të implementohet kjo.

3.14 Norma uniforme gjithashtu rezulton në një normë të ulët efektive të mbrojtjes për prodhuesit kosovarë – dhe kjo ka rezultuar në një kërkesë në rritje nga komuniteti i biznesit për diferencimin e regjimit për të krijuar një normë më të ulët që vlen për mallrat investuese dhe lëndën e parë, dhe për të ruajtur normën më të lartë për mallrat e konsumit. Një strukturë e diferencuar tarifore, do të rriste në mënyrë të konsiderueshme normën efektive të mbrojtjes në tregun vendor, dhe nuk do të jepte stimul për prodhim për tregun e jashtëm. Politikat proteksioniste tregtare nuk kanë qënë të qëndrueshme apo të suksesshme në vende të tjera, dhe promovimi i prodhimit për eksport, dhe jo tregu vendor duhet të jetë prioriteti për Kosovën. Një mundësi e një politike shumë më të preferueshme do të ishte adoptimi i zbritjes së tarifës për të gjitha mallrat për të ulur koston e importeve dhe shqyrtimi i politikave shtesë që mund të nxisnin prodhimin për eksporte.

### **Kutia 3.1 Institucionet Qeverisëse dhe Ato që Merren me Tregtinë**

UNMIK-u ka përgjegjësi për administrimin e doganave, mbledhjen e tarifave doganore dhe taksave të tjera që mbledhen në kufi, për nxjerrjen e certifikatave të importit, licensave për eksport (EUR-1), dhe dokumenteve doganore.<sup>30</sup> Nga ana e IPVQ, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për politikën tregtare, zhvillimin e kushteve të kornizës për tregti dhe implementimin e programeve për nxitjen e tregtisë së jashtme.

**Institucionet që merren me tregtinë janë në një fazë fillestare dhe nuk e kanë kapacitetin e plotë për të ndihmuar eksportuesit të penetrojnë në tregjet e huaja.** Shoqata e Eksportit e Kosovës (ShEK) e themeluar kohët e fundit, mund të bëhet një instrument efektiv ndihmues për eksportuesit. ShEK është një organizatë jo-fitimprurëse, e sponsorizuar nga industria, që lehtëson zhvillimin e aktiviteteve të biznesit nëpërmjet përkrahjes së nxitjes së eksporteve, bërjes së trajnimeve dhe rrjetëzimit të anëtarëve, dhe mbështetjen e klimës së përgjithshme të eksportit në Kosovë.

**Sektori bankar ofron vetëm mundësi të kufizuara për financimin e tregtisë:** Siç e diskutojmë më vonë në këtë kapitull, vetëm një bankë komerciale jep letra krediti për importet, dhe mungesa e një sistemi modern bankar shkakton probleme me pagesat në të gjithë rajonin. Në Kosovë, pagesat për importe bëhen me mjete të gatshme, pranohen depozitat bankare dhe në disa raste garancitë bankare.

## **Rekomandimet e Politikave**

### 3.15 Rekomandohen politikat e mëposhtme tregtare:

- Të përmirësohet qasja në tregjet rajonale nëpërmjet përmirësimit të marrëdhënieve me partnerët tregtarë rajonalë; sidomos me IRJ të Maqedonisë dhe Serbinë dhe Malin e Zi; dhe nëpërmjet një përfshirjeje më të madhe në Grupin Punues të Paktit të Stabilitetit për zhvillim dhe lehtësim të tregtisë. Objektivi duhet të jetë reduktimi i pengesave jotarifore për tregtinë dhe njohja e Kosovës nga partnerët rajonalë si një territor doganor dhe të sigurohet që administratat doganore ta përfshijnë Kosovën në agjendat e tyre si të tillë. Kosova duhet të mbështesë një MTL rajonale.
- Ruajtja e strukturës uniforme tarifore dhe reduktimi i normës për të gjitha mallrat (p.sh. në 5 përqind për të qënë në të njëjtin nivel me proteksionin mesatar në tregjet më pak të mbrojtura të rajonit). Implikimet që kjo politikë sjell në të ardhurat duhet të konsiderohen me imtësi, dhe nëse është e nevojshme duhet të balancohen pjesërisht me masa kompensuese për ngritjen e të ardhurava nga TVSh-ja, ose duke e ngritur normën, ose duke e ulur kufirin.
- Duhet konsideruar hulumtime të mëtejshme të politikave shoqëruese për lehtësimin e rritjes së eksporteve. Këto përfshijnë
  - Potencialin për të prezantuar një system të kthimit të tarifave për të gjitha mallrat kapitale dhe inputet ndërmjetëse që përdoren për eksporte;

<sup>30</sup> Administrata Tatimore është përgjegjëse për mbledhjen e TVSH-së vendore.

- Krijimin e zonave për përpunimin (zhvillimin) e eksporteve, magazinave ku rrinë mallrat para pagimit të taksave dhe ambiente të ngjashme ku nuk paguhen taksa për eksporte;
- Prezantimin e zhvleftësimit të përshpejtuar për investimet.

### **C. AMBIENTI I BIZNESIT**

3.16 Cilësia e ambientit të biznesit pjesërisht përcaktohet nga natyra e rregulloreve që zbatohen për bizneset dhe efektshmëria e institucioneve që kanë marrë përsipër zbatimin e këtyre rregulloreve. Gjithashtu ndikohet nga niveli dhe cilësia e shërbimeve të infrastrukturës, mundësisë për t'u financuar, nivelit të konkurrencës, dhe shkallës së sigurisë fizike.

3.17 Për të vlerësuar gjëndjen e klimës lokale të biznesit, u përdorën rezultatet e një Vlerësimi të Klimës së Investimeve në 2003 bazuar në një anketim të firmave të vogla e të mesme kudo nëpër Kosovë; në diskutimet me zyrtarët komunalë; dhe intervista të mëtejshme me ndërmarrjet. Mostra e anketimit u mor nga katër sektorë: prodhimtari, ndërtimtari, transport dhe komunikacion, dhe tregti me shumicë e pakicë që lejon të bëhen krahasime me anketime të ngjashme në vende të tjera të rajonit, dhe përmes rajoneve të ndryshme të territorit.<sup>31</sup> Kjo na bën të kuptojmë pengesat për biznesin për ato firma që tashmë veprojnë në Kosovë.

---

<sup>31</sup> Mostra e nxjerrur nga të dhënat e regjistrimit të ndërmarrjeve e bërë nga Regjistri i Biznesit të Kosovës, përmban 319 firma të vogla dhe 10 firma të madhësisë mesatare. Anketimi përbëhej nga sektorët e mëposhtëm: tregti me shumicë dhe pakicë (99), transport dhe komunikim(82), veprimtari prodhuese (77), dhe ndërtimore(71). Mostra përfshin firma me bazë në Prishtinë (120), Prizren (43), Pejë (41), Mitrovicë (45), Gjilan (37), dhe Gjakovë (43).

### **Kutia 3.2 Strukturat dhe dinamikat e sektorit të ndërmarrjeve për momentin.**

Sektor i ndërmarrjeve në Kosovë përmban rreth 30.000 biznese zyrtare dhe është i dominuar nga firma shumë të vogla (mikro-ndërmarrje).<sup>32</sup> Numri më i madh i firmave janë të organizuara në formë të pronësisë personale ose në formë të partneritetit, me më pak se katër të punësuar (gjysma prej tyre kanë vetëm një të punësuar), dhe në të shumtën e rasteve mirren me tregti me shumicë ose pakicë ose me aktivitet shërbyes (60 % të firmave). Ekonomia kosovare tradicionalisht ka qenë e dominuar nga prodhimi i lëndëve të para, posaçërisht në bujqësi, ekstraktionin e linjtit për prodhim të rrymës, dhe përpunime të tjera të mineraleve. Edhe sot, një numër shumë i vogël i firmave është i ndërlidhur me aktivitetet e vlerës së shtuar. Sektorë të tjera me rëndësi të madhe (sipas numrit të firmave) përfshijnë prodhimin (15%), ndërtimtarinë (10%), dhe transportin, deponimin dhe komunikimet (5%).<sup>33</sup>

**Investimi privat komercial (duke përjashtuar investimet për shtëpi) është rritur nga 5.4 përqind të PBB-së në 2000 në 11 përqind në 2002 dhe 2003.** Kjo është e krahasueshme me Serbinë dhe Malin e Zi gjatë vitit 2002 (11.3%) dhe Shqipërinë (12.5%).<sup>34</sup> Mesatarisht, shfrytëzimi i kapaciteteve mes ndërmarrjeve është 72%. Investimet totale private në Kosovë, që mesatarisht ishin rreth 37 përqind e PBB-së gjatë periudhës 2001-2002, vlerësohet të kenë rënë në 30 përqind të PBB-së gjatë 2003.<sup>35</sup> Ndërtimtaria e objekteve të banimit ka qenë bartësi kryesor i investimeve prej vitit 1999 ( e financuar kryesisht nga dërgesat e të hollave) dhe në fund të vitit 2003 përbënte 64 përqind të investimeve të përgjithshme private, një rënie nga 70 përqind në 2002.

Që nga viti 2002, shitjet ndërmjet ndërmarrjeve vazhduan të jenë të larta, me atë që më se gjysma e ndërmarrjeve të kontrolluara raportojnë të kenë pasur rritje në shitje prej 26% gjatë vitit 2002 në krahasim me vitin e kaluar (shikoni figurën 3.1). Për më tepër, numri i firmave të cilat kanë raportuar rritje të shitjes gjatë vitit 2002 është rritur 60% mbi vitin 2001. Duket se gjatë vitit 2002 numri i firmave të cilat raportojnë rënie të shitjes fillon të zmadhohet. Duket se viti 2002 shënon fillimin e tërmeteve që pësojnë firmat e vogla të krijuara pas konfliktit, në krahasim me firmat më të suksesshme të cilat përfitojnë tregun dhe bëjnë që firmat e dobëta të ngelin jashtë biznesit. Kjo duket qartë nga figura 3.1 më poshtë, ku përqindja e firmave që raportojnë rënie të shitjeve u rrit; pritet që ky trend të ketë vazhduar gjatë vitit 2003.


<sup>32</sup> Numri i firmave të regjistruara është zvogëluar prej 50.000 në vitin 1999 (kur ishte kërkuar regjistrimi përbrenda Kosovës) në 30.000 në vitin 2003 (pasi u bë regjistrimi i ri) Vihet deri tek përfundimi se shumica e ketyre ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 1999 ishin vetëm “në letër”, të cilat në të vërtetë kurrë s’kanë operuar. Të tjerat ose kanë dalur jashtë biznesit ose kanë kaluar në joformale (kanë operuar pa status ligjor). Nuk ekzistojnë të dhëna për firmat joformale, por numri aktual i firmave të cilat operojnë përbrenda territorit të Kosovës besohet të jetë shumë më më i madh se 30.000.

<sup>33</sup> Burimi: Regjistri i Biznesit Kosovar. Nuk ka qasje për të dhënat për vlerën e shtuar në sektore.

<sup>34</sup> Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Nuk mirren parasysh ndërmarrjet publike dhe shoqërore. PREM/DEC treguesi për investimet private si pjesë e prodhimit bruto vendor është 15.3%.

<sup>35</sup> Vlerësime të FMN-së/Bankës Botërore. Investimet totale dhe komerciale përfshijnë NPSH-të dhe NPP-të.

**Figura 3.1: Ndryshimet në Shitje (2002 deri në 2003)**



### Aspektet Pozitive të Mjedisit të Biznesit në Kosovë

**3.18 Vlerësimi arrin në përfundimin që ambienti i biznesit konsiderohet nga NVM-të si relativisht i favorshëm.** Gjatë katër viteve pas mbarimit të konfliktit, janë aprovuar një seri e ligjeve të reja në fushën e ekonomisë, të gjitha këto të orientuara sipas standardeve të BE-së dhe janë formuar institucione të reja publike dhe private që përkrahin implementimin e këtyre ligjeve. Në këtë mënyrë janë venduar themelet për një ekonomi të orientuar kah tregu. Është me interes të vërehet se kur u pyetën rreth faktorëve që i pengojnë firmat të fillojnë një biznes të ri apo të investojnë në një biznes ekzistues, vetëm 12 përqind cituan pasigurinë politike si një faktor, ndërkohë që 70 përqind cituan mungesën e kapitalit, 10 përqind konkurrencën me firmat vendore apo të huaja, dhe vetëm 3 përqind iu referuan një klime të papërshtatshme të investimeve.

**3.19 Barrierat për të hyrë në biznes në Kosovë, në kuptimin e lehtësisë të qasjes së tokës dhe kostos në përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe administrative, janë në përgjithësi të ulëta.** Kërkesat që duhen përmbushur të ranguar si më të ulëta në përgjithësi ishin licencimi i biznesit dhe lejet për operim, ligjet për punëtorët, qasja e tokës, si dhe aftësimi dhe edukimi i forcës punëtore. Këto kushte, të kombinuara me qasjen relativisht të mirë të financimit dhe me një shkallë të lartë të konkurrencës, bëjnë që pronarët e bizneseve të ballafaqohen me një numër relativ të barrierave për të startuar biznesin e tyre. Këta indikatorë krahasojnë në mënyrë të favorshme Kosovën me vendet e tjera në rajon. Derisa vetëm 5% e të intervistuarve nga Kosova kanë deklaruar se marrja e licencës të biznesit dhe lejeve për operim ka qenë ngarkesa "më e madhe" apo "e rëndë", 23% të firmave nga Shqipëria si dhe 17% të firmave nga Maqedonia identifikuan

këtë si ngarkesa më e rëndë për t'u përmbushur.<sup>36</sup> Duke konsideruar qasjen e tokës, vetëm 8% e bizneseve Kosovare e ndjenë këtë si një kërkesë me rëndësi të madhe, ndërsa dy herë më shumë firma nga Shqipëria e cilësuan qasjen në tokë si një problem të madh.

3.20 Stabiliteti makro-ekonomik, si parakusht themelor për rritje është poashtu karakteristikë pozitive në mjedisin e biznesit në Kosovë, i cituar prej vetëm 25% të firmave si një pengesë kryesore. Renditja e këtij indikator është dukshëm më e lartë në Shqipëri (59%), diçka më e lartë në Serbi dhe Mal të Zi (37%) dhe në Maqedoni (35%).


3.21 **Konkurenca (matur me numrin e konkurrentëve, madhësinë e tregut dhe konkurrencën në çmime) është poashtu mjaft e fuqishme në Kosovë.** 80% të firmave që tregojnë se konkurrojnë në tregun e prodhimit të tyre kryesor me më se 20 firma të tjera dhe se gati gjysma e të intervistuarve ka më se 20 furnizues. Tre të katërtat e firmave kontrollojnë më pak se 5% të tregut për vijën e tyre kryesore të prodhimit. Në fund, dy të tretat e të gjitha ndërmarrjeve tregojnë se po qe se rrisin çmimet për 10%, klientët e tyre do të blenin me një sasi shumë më të vogël ose s' do të blenin fare prej tyre. Ky presion i çmimeve tregon se ndërmarrjet operojnë në mjedis mjaft konkurrent. Sidoqoftë, diferencimi i produkteve ndërmjet firmave në disa nga sektorët që u morën si mostra, nuk ndryshon shumë (në veçanti, ky është rasti i firmave tregtare me shumicë e pakicë), dhe në këto raste, nuk pritet një shkallë e lartë e konkurrencës në çmim.

---

<sup>36</sup> Te dhenat për vendet tjera janë marrë nga rezultatet e hulumtimit AABPN 2002. Duhet të kihet kujdes gjatë krahasimit të mjedisit të biznesit nëpër vendet e regjionit. E para, të intervistuarit nuk krahasojnë kushtet e tyre me shtetet e tjera kur zgjedhin renditjen, por i rendisin ato sipas prioriteteve të kushteve të brendshme të tyre. E dyta, në hulumtimet jashtë Kosovës është përfshirë vetëm një kategori e rangimit të ngarkesave/pengesave mbi atë «mesatare» (kategoria më e rëndë), ndërsa të intervistuarit kosovarë mund të zgjidhnin ndërmjet dy rangimeve mbi atë «mesataren» - «kategoria e madhe» dhe «shumë e rëndë»

**Figura 3.2: Vlerësimi i Pengesave të Përgjithshme për Veprimtari (përqindja e firmave që e rendisin pengesën si "të madhe" apo "tepër të rëndë")**

Burimi: Vlerësimi i Klimës së Investimeve, Banka Botërore 2003.



### Pengesat në Ambientin e Biznesit

**3.22 Reduktimet e shpeshta të rrymës janë vështirësi themelore për të gjitha ndërmarrjet, duke shkaktuar harxhime më të mëdha të operimit, humbje në produktivitet, si dhe zvoglim të konkurrencës** (shikoni Figurën 3.2). Mesatarisht firmat kanë raportuar për 90 ditë pa rrymë me një zgjatje prej 6 orëve në ditë, gjatë vitit 2002. Kushtet më të rënda janë raportuar të jenë në Prizren dhe Gjilan ku reduktimet kanë arritur shkallën prej 112 ditëve në vit. Prizreni poashtu raporton për kohëzgjatjen më të madhe të reduktimit prej 10 orëve në ditë. (Për të bërë një krahasim, Shqipëria përjeton rreth gjysmën e ditëve me ndërprerje rryme të Kosovës me një mesatare prej 47 ditë në vit). Firmat në Serbi dhe Mal të Zi, Maqedoni dhe Kroaci përjetojnë respektivisht 10, 6 dhe 3 ditë pa rrymë në vit. Nevojiten mesatarisht 28 ditë të mirret lidhje e re elektrike në Kosovë, ndërsa në vendet tjera fqinje nevojiten vetëm tri ditë për një lidhje të re.<sup>37</sup> Reduktimet e rrymës rezultojnë në mesataren e prodhimit dhe humbjet në shitje që firmave u shkaktojnë një humbje prej rreth 5% të shitjes vjetore. Përveç këtyre humbjeve nevoja për burime alternative të rrymës rrit edhe më shumë kostot operative të firmave. Tre të katërtat e ndërmarrjeve është dashur të blejnë gjeneratorë. Kostoja e blerjes dhe operimit të gjeneratorëve paraqet një tjetër 2% të kostos së operimit; 3,5% te firmat që

<sup>37</sup> Hulumtimet AABPN 2002

merren me prodhimitari. Kostoja përfundimtare që firmat paguajnë për shkak të mosfurnizimit adekuat me rrymë elektrike është rreth 8-9 % të shitjes vjetore, që ose redukton fitimin, kalohet tek konsumatorët nëpërmjet çmimeve më të larta të produktit, apo të dyja.

**3.23 Dyzet e katër përqind nga firmat kanë cituar konkurrencën jo fer dhe joformale si pengesë kryesore.**<sup>38</sup> Shumë të intervistuar citojnë mungesën e trajtimit reciprok të eksportit kosovar nën marrëveshjet e tregtisë në region (posaçërisht Maqedonia dhe Serbia e Mali i Zi) që u jep konkurrentëve të tyre rajonalë një avantazh jo fer dhe një pengesë për hyrjen e tyre në tregje. Eksporti i Kosovës nuk është i trajtuar si i lirë, pikësepari për shkak të barrierave jotarifore dhe së paku deri kohët e fundit kishte evidencë që nuk bëhej trajtimi reciproc në kufirin me Maqedoninë.<sup>39</sup>

3.24 Nuk ka ndonjë të dhënë për joformalitetin në Kosovë në saktësinë e të cilës të dhënë do të mund të mbështetemi por besohet që kjo dukuri të jetë mjaft e përhapur.<sup>40</sup> Ekziston një numër faktorësh që kontribuojnë në këtë. E para, Kosova është ende një ekonomi e bazuar në mjete të gatshme (vetëm 43% të firmave shfrytëzojnë bankat për të bërë biznes, ndërsa vetëm 12% të shitjeve bëhen me kredit), dhe në këtë mjedis është shumë lehtë të fshihen transakcionet e padokumentuara. E dyta, barra e cila bie në ndërmarrje, për t'i kënaqur kërkesat administrative dhe rregulloret (si dhe inspektimet e shpeshta nga ana e autoriteteve) e kombinuar me korrupsion, mund të krijojë një mjedis i cili shpie kah paraqitja edhe më e madhe e joformalitetit. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se nëpër komunat ku një proporcion më i lartë i firmave e rendisin administratën e tatimeve, organet për zbatimin e rregulloreve dhe korrupsionin si probleme të “mëdha” ose “të rënda” (posaçërisht Prizreni dhe Gjakova), proporcioni më i lartë i firmave nëpër këto komuna, poashtu dallojnë konkurrencën joformale si problem të rëndë.

3.25 Për më tepër, firmat mund të mbesin apo të kthehen në sektorin joformal kur barra e përgjithshme tatimore dhe kostoja totale e punës rritet, siç është rasti i Kosovës me futjen në 2002 dhe 2003 të tatimit në fitim, tatimit në pagë, tatimit në pronë, dhe kontributeve për pension. Megjithëse kanë lëvizur nga zero në një bazë të vogël, ky ekspansion i shpejtë i regjimit tatimor mund t'i ketë motivuar firmat dhe të punësuarit të kalojnë në status joformal. Meqënëse shumë nga këto taksa kanë ekzistuar për vetëm një apo dy vjet, duhet të ndërmerret një vlerësim i barrës dhe ndikimit mbi informalitetin, por sidoqoftë, për momentin nuk rekomandohen ndryshime në regjimin tatimor. Ndryshime të mundshme nga një barrë direkte (taksa në paga dhe fitime) në një barrë indirekte (me

---

<sup>38</sup> Joformaliteti mund të marrë forma të ndryshme: në njërin fund të spektrit janë firmat që kërkojnë të jenë krejtësisht të “padukshme” për autoritetet, dhe shmangin regjistrimin zyrtar dhe licensimin dhe u shmangen pagesave të taksave. Në anën tjetër të spektrit janë firmat që janë gjysëm-formale, të cilat mund të jenë të regjistruara, dhe të cilat mund të paguajnë taksat, por që nuk raportojnë të gjitha të ardhurat apo mund t'u shmangen pagesave të beneficioneve që kanë lidhje me punëmarrësin.

<sup>39</sup> Duhet vërejtur se anketimi i ambientit të biznesit u krye para diskutimeve të fundit me Maqedoninë që – sipas provave të fundit për eksport – e kanë zgjidhur këtë çështje.

<sup>40</sup> Një indikator për shtrirjen e joformalitetit mund të shihet prej prodhimit të brendshëm bruto (PBB). PBB për vitin 2002 është zmadhuar për 3.9 %, edhe pse rezultatet e hulumtimit tregojnë se 57% të firmave raportuan se paten një rritje mesatare të shitjes për 26% në krahasim me vitin e kaluar ; vetëm 12% të firmave paraqesin rënie të shitjes. Të intervistuarit poashtu u shprehën se një firmë mesatare në fushën e aktivitetit të tyre, i raporton autoriteteve tatimore vetëm 69% të shitjes aktuale.

anë të rritjes së bindjes për pagesën e TVSH-së apo normës së TVSH-së) të taksave mund të konsiderohet më vonë.

3.26 Niveli i tarifave dhe tatimeve i zbatuar në importin kosovar të mallrave kapitale dhe lëndëve të para, gjithashtu citohet si një factor që ndikon për keq në konkurrencën e firmave kosovare që mirren me prodhimtari, e të cilat kërkojnë të garojnë në tregjet rajonale.<sup>41</sup> Për shkak se tatimi dhe TVSH-ja për importet e Maqedonisë është vetëm 16%, prodhuesit kosovarë ndjejnë se me këte politikë të tregut u jepet përparësi e padrejtë firmave maqedonase. Reduktimi i propozuar i tarifës duhet ta adresojë këtë pengesë për komunitetin e biznesit duke ulur koston e inputeve. TVSH-ja e paguar për inpute kreditohet dhe prandaj ndryshe nga ç'mund të përceptohet, kjo nuk është një "tarifë shtesë për inputet e importuara" që paguhet nga prodhuesit kosovarë, por është një kosto që paguhet në fillim, e cila shkakton një pengesë duke pasë parasysh vështirësitë e qasjes në financimet afatgjata dhe tregtare.

3.27 **Në lidhje me administratën doganore dhe tatimore, shumë firma shprehën pakënaqësinë e tyre me vonesat e tepërta të procesimit të kompensimit të TVSH-së, dhe çmimet e referencë të papërshtatshme.** Kompensimet e TVSH-së shpesh kërkojnë tre apo më shumë muaj për t'u procesuar. Këso vonesash nuk do të ishin edhe aq të rëndësishme po qe se shumica e transaksioneve do të ishin të bazuara në kredit, por me një shkallë të lartë të transaksioneve me para në dorë këto vonesa paraqesin një hua pa kamatë dhënë qeverisë dhe pengojnë derdhje të parave të gatshme nga ndërmarrjet tipike kosovare. Përveç këtyre problemeve të lidhura me TVSH-në, shumica e importuesve pohojnë se pengesa kryesore administrative e lidhur me tregtinë është aplikimi jo i drejtë i çmimit referencë. Shumë firma ankohen se janë duke paguar tatime që kalojnë vlerën mbi 26.5% e asaj që duhet paguar për shkak të evaluimit jo të drejtë të importit, edhe pse ata i prezantojnë para autoriteteve doganore të gjitha dokumentacionet e nevojshme të cilat vërtetojnë çmimin aktual të importit. Shumë prej firmave të intervistuar raportuan se nuk është e pazakonshme për ta të paguajnë tatime efektive nga 50 e ndonjëherë edhe 100 për qind; efekti i kësaj dukurie në pozitat e firmave konkuresse në Kosovë është i dukshëm. Ndërkohë që ka edhe përpjekje të firmave që të paraqesin fatura me çmim më të vogël se ai real, me qëllim që t'u ikin pagesave të plota të tarifave dhe TVSH-së, duhet konsideruar një hetim i lirisë që është lejuar në aplikimin e çmimit referencë.

3.28 **Anketimi tregon se pasiguria e politikave rregullative dhe ekonomike është një shqetësim për NVM-të vendore.** Kjo ndikon vendimet e ardhshme për investime dhe punësim, meqë investuesit nuk mund të vlerësojnë me saktësi rreziqet dhe rezultatet kosto-përfitim të investimeve të ardhshme 37% nga numri i përgjithshëm i firmave cituan pasigurinë në fushën e rregullit dhe politikës ekonomike si ngarkesë të rëndësishme; 51% prej firmave me veprimtari prodhuese. Evaluimi i kësaj ngarkeseje nga ana e të intervistuarve pjesërisht reflekton evoluimin konstant të një mjedisi legjislativ, që deri në një farë mase, është i pashmangshëm në kohën e tranzicionit. Poashtu reflekton ndërrimet e vazhdueshme të autoriteteve prej UNMIK-ut tek IPVQ dhe zhvillimin e një rregulloreje si rezultat i transferimit të funksioneve të rezervuara, dhe debateve të pranishme për disa çështje kyçe si psh regjimi i tregtisë dhe politika e privatizimit. Për më tepër, ka ndryshime të konsiderueshme sipas rajonit, ku komunat e Gjilanit, Prizrenit dhe Gjakovës kanë pengesat më të mëdha administrative dhe rregullative.

---

<sup>41</sup> Tarifat janë uniforme në 10%, TVSH-ja në 15%, dhe për ate arsye efekti kumulativ është 26.5%

3.29 Dëshmitë nga hulumtimi në lidhje me prezencën e korrupsionit zyrtar është vështirë të shpjegohen. Më se një e treta e të intervistuarve kanë identifikuar korrupsionin si pengesë të madhe dhe shumë të rëndë për të zhvilluar biznes në Kosovë. Ky numër që mendon kështu është më i madh te ndërmarrjet me veprimtari prodhuese (48%) dhe në komunat e Prizrenit (58%) dhe Gjakovës (48%). Megjithatë, vetëm një pjesë e vogël e firmave pranoi se ka bërë pagesa joformale për çfarëdo shërbimi publik. Kjo do të thotë se të përgjegjurit paraqesin shërbimet publike më të korruptuara se sa që ato janë në fakt.<sup>42</sup> Për ata që bëjnë pagesat, kostoja totale është mesatarisht një përqind e të ardhurave vjetore. Pagesat më të larta mesatare kanë të bëjnë me inspektionet tatimore (668 €), regjistrimin e të drejtave për patundshmëri (168 €), dhe lejet për shfrytëzimin e tokës (100 €).

3.30 **Në lidhje me marrëdhëniet biznes-qeveri, shumica e firmave e konsideronin dhënien e shërbimeve qeveritare si efikase (81 përqind), dhe tre të katërtat mendonin se ekziston një parashikueshmëri në lidhje me ndryshimet e ligjeve dhe rregullave që materialisht ndikojnë bizneset e tyre.** Sidoqoftë, nga të gjitha grupet që kërkojnë të ndikojnë ligjet apo rregulloret që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në biznesin e të intervistuarit, krimi i organizuar renditej më i larti (20 përqind mendonin se krimi i organizuar ka një ndikim “mesatar” apo “shumë të madh”). Më tej, 7 përqind e firmave e pranuan që i kanë bërë krimin të organizuar pagesa mbrojtëse të barabarta me 2 përqind të shitjeve të tyre vjetore.

### **Investimet e Huaja Direkte, Ristrukturimi dhe Privatizimi**

3.31 **Ndërkohë që rreziku politik mund të mos jetë një shqetësim i madh për investitorët vendorë, në mënyrë të qartë është një pengesë domethënëse me të cilën përballen investitorët e huaj potencialë, përfshirë edhe ato nga diaspora.** Ky fakt komplikohet më tej nga faktorë të tjerë, si p.sh. mungesa e mbrojtjes së plotë së të drejtave të pronës së patundshme: ekzistojnë pretendime të pazgjydhura mbi pronën nga kosovarë që mungojnë dhe janë të zhvendosur; dhe regjistri i pronës së patundshme nuk po funksionin akoma. Deri tani, investimet e huaja direkte (IHD) kanë qënë të kufizuara, ku investimet e vetme të mëdha në sektorin bankar. Ka pasur një shkallë interesi dhe pjesëmarrjeje nga investitorët brenda rajonit gjatë tre raundet e para programit të privatizimit. Madhësia e këtyre investimeve potenciale tregon që investitorë të tillë janë të përgatitur për të marrë përsipër rreziqe të kufizuara financiare në këtë fazë, ndoshta për të pasur prani në tregun e Kosovës, në rast se kushtet e përmirësuara politike më vonë mund të hapnin dyert për mundësi të mëtejshme dhe të arsyetojnë një profil më të lartë të investimeve.

3.32 **Roli që mund të luajë sigurimi i rrezikut politik për zbutjen e rreziqeve me të cilat përballen investitorët privatë, duhet konsideruar më tej, duke përfshirë dispozitat e Agjensisë Shumëpalëshe të Garancisë së Investimeve (MIGA).** Korporata Amerikane e Investimeve Private Jashtë Shtetit (OPIC) ka dhënë sigurim të rrezikut politik për investitorët e huaj në Kosovë, megjithëse mbulimi garantohej vetëm nën marrëveshjet aktuale të përkohshme derisa një qeveri që njihet në arenën ndërkombëtare në të ardhshmen mund të ratifikojë marrëveshjen që OPIC-u ka përfunduar me UNMIK-un

<sup>42</sup> Mund të jetë rasti se firmat ishin në dymendje të pranojnë se kishin paguar pagesa joformale zyrtarëve publik

3.33 Ekzistojnë më shumë se 500 ndërmarrje shoqërore (NPSH) të caktuara për privatizim në Kosovë. Transferimi i NPSH-ve në sektorin privat do të sjellë përdorim më efikas të këtyre aseteve dhe në fund të fundit do të ndihmojë në stimulimin e rritjes ekonomike. Prandaj, implementimi i programit të privatizimit duhet të jetë një prioritet i lartë për autoritetet. Nga më shumë se 500 NPSH, vetëm rreth 75 deri në 100 do të tenderohen si biznese të suksesshme sipas modeling të “spin-off”; pjesa tjetër do të likuidohet dhe asetet e tyre do të shiten pak nga pak. Për shumë nga rastet e likuidimit, asetit më me vlerë do të jetë toka, privatizimi i së cilës do të mundësonte zgjerimin e firmave ekzistuese si dhe firma të reja. Por, deri tani qeveria është marrë me çështjen e të drejtave të përdorimit të tokës (dhënie me qera afatgjatë dhe lirisht të transferueshme) vetëm për ato ndërmarrje të privatizuara nëpërmjet spin-off. Nuk është aprovuar asnjë rregullore që merret me të drejtat e përdorimit të tokës për rastet e likuidimit, dhe kjo po pengon implementimin e një pjese të programit që mund të jepte kontribut të konsiderueshëm në mundësitë afatmesme për rritje të Kosovës.

### 3.34 Policy Recommendations

- Të vazhdohet me privatizimin dhe ristrukturimin e NPP-ve dhe NPSH-ve.
- Duke vepruar sipas prioriteteve, të aprovohet legjislacioni që mundëson privatizimin e të drejtave për përdorimin e tokës të ndërmarrjeve shoqërore të caktuara për likuidim.
- Të shqyrtohen mundësitë për sigurimin e rrezikut politik duke përfshirë edhe përdorimin e mundshëm të produkteve të MIGA-s.
- Të rishqyrtohen procedurat për kompensimin e TVSH-së për të siguruar procesimin në kohë të kompensimit.
- Të rishqyrtohen aktet administrative që ushtrohen në lidhje me çmimin e referencës të importeve (dokumentacionet e kërkuara të importuesit, freskimi i rregullt i çmimeve të referencës etj.) për të siguruar trajtim fer dhe të standardizuar për importet.
- Të rishqyrtohen rregulloret dhe aktet administrative lokale (liçencimi, lejet për operim, inspektionet) sidomos në komunat e Prizrenit dhe Gjakovës që të zvogëlohet barra e panevojshme që u bëhet ndërmarrjeve.

## D. ZHVILLIMI I SEKTORIT FINANCIAR

3.35 Ky seksion vlerëson gjendjen e sektorit financiar dhe identifikon problemet që pengojnë zhvillimin e tij bazuar në një anketim joformal të sektorit kredidhënës. Megjithëse krediti për sektorin privat është rritur në mënyrë të konsiderueshme, baza e depozitave është kryesisht afatshkurtër, e në këtë mënyrë e pengon aktivitetin afatgjatë kredidhënës. Pasiguria politike rezulton të ketë njëfarë ndikimi në kufizimin e maturitetit të bazës së depozitave; kursyesit kanë frikë se kursimet e tyre mund të mos jenë të sigurta. Rezultatet e anketimit bazohen në intervistat me përfaqësuesit e gjashtë bankave komerciale dhe katër IMF-ve<sup>43</sup> dhe krijojnë bazën për konkluzionet dhe rekomandimet që

<sup>43</sup> Mostra përfaqëson 86 përqind të aseteve totale të sektorit bankar dhe 77 përqind të tregut total të huadhënies, apo 80 përqind të tregut bankë-kredi.

kanë për qëllim përmirësimin e ndërmjetësisë bankare në Kosovë në fund të këtij seksioni.

### Ndërmjetësia Financiare

3.36 Sektori financiar në Kosovë është ndërtuar nga fillimi gjatë katër viteve të fundit, dhe përbëhet nga shtatë banka të regjistruara, dhjetë shoqata të kursimeve dhe kredive, dymbëdhjetë institucione mikrofinanciare (IMF), katër institucioneve financiare të tjera jobankare, dhe tetë kompani sigurimesh. Autoriteti Banka dhe i Pagesave i Kosovës (BPK), themeluar në vitin 1999, është autoriteti rregullator dhe mbikqyrës për sektorin bankar dhe të sigurimeve. Korniza ligjore, rregullatore, dhe mbikqyrëse për sektorin bankar dhe të sigurimeve është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të njohura në rajon. Me mbështetjen e donatorëve, BPK ka bërë përparim të konsiderueshëm drejt forcimit të kapacitetit të vet për të rregulluar dhe mbikqyrur në mënyrë efektive sektorin financiar.

3.37 Thellësia e sektorit bankar, e matur me anë të huave totale që i jepen sektorit privat dhe depozitave totale si përqindje e PBB-së është rritur në mënyrë të shpejtë. Në fund të 2002, huatë për sektorin privat përfaqësonin 6.5 përqind të PBB-së, të cilat u rritën në mbi 17 përqind deri në fund të vitit 2003. Në mënyrë të ngjashme, depozitat u rritën nga 33 në 39 përqind të PBB-së nga viti 2002 në 2003. Rritje të tilla vijnë nga një bazë e ulët, dhe Kosova vazhdon të ketë një nivel të ulët të ndërmjetësisë financiare, krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Kjo reflekton sektorin bankar dhe infrastrukturën financiare të rikrijuar nga fillimi më pak se para katër vitesh pas një mungese 10-vjeçare të çfarëdolloj huadhënie ndaj sektorit të ndërmarrjeve dhe shkatërrimit gradual të elementeve kryesorë të çdo infrastrukture financiare.

3.38 **Kosova është një ekonomi që bazohet shumë në mjetet e gatshme.** Në fund të konfliktit, sistemi financiar i Kosovës ishte në kaos. Të gjitha bankat jugosllave ishin larguar, duke marrë me vete depozitat e klientëve; sistemi i centralizuar i pagesave kishte pushuar së ekzistuari; numri i njerëzve me eksperiencë bankare ishte i kufizuar; dhe ambienti ligjor ishte i dobët. Ndryshe nga shumica e vendeve të rajonit, Kosova jo vetëm që pothuajse nuk përparoi aspak në tranzicionin drejt një ekonomie tregu gjatë viteve 1990, por gjithashtu vuajti pasojat e shkatërrimit të besimit publik në sistemin bankar për një periudhë të zgjatur kohore. Megjithëse llogaritë bankare janë relativisht të përhapura në Kosovë, pagesat vazhdojnë të bëhen kryesisht me mjete të gatshme, dhe sasia e parasë që qarkullon jashtë sistemi bankar është e konsiderueshme kur matet me anë të raportit depozita/paraja e gjërë, që u rrit nga 47 përqind në dhjetor 2002 në 70 përqind në dhjetor 2003.

**Tabela 3.3: Treguesit e Ndërmjetësisë Financiare për Rajonin (2002)**

	Kosova	Shqipëri a	Bosnia- Hercegovina	Kroacia	Maqedonia	Slllovenia	Turqia	Greqia
<b>Depozita/PBB</b>	33.4	40.1	39.6	70.6	24.3	59.6	50.8	90.7
<b>Huatë për sektorin privat /PBB</b>	6.6	5.9	25.9	51.1	20.4	41.3	15.4	109.3
<b>Diferenca e interesave</b>	12.0	7.9	9.8	9.6	8.8	5.2	N/A	5.3

**3.39 Në vend që të përdorin sektorin bankar, ndërmarrjet kanë prirje të mbështeten në fondet e veta si dhe familjen e shoqërinë për nevojat e tyre të kapitalit punues dhe financimit të investimeve.** Duke qënë se ndikohen shume nga remitancat, këto përfaqësojnë burimet kryesore të financimit për ndërmarrjet në Kosovë. Sipas anketës, huatë nga bankat komerciale apo IMF-të mbulojnë vetëm rreth 40 përqind të nevojave financiare të huamarrësve.

3.40 Rrjetet e degëve dhe nëndegëve janë të përhapura në Kosovë dhe shtrihen edhe në zona relativisht të largëta. Bankat janë prezente në të gjitha komunat, duke përfshirë gjashtë qytetet në mostrën e përdorur për vlerësimin e klimës së investimeve.<sup>44</sup> Sidoqoftë, shumica e produkteve dhe shërbimeve bankare ekzistuese vazhdon të jetë e ngushtë dhe përbëhet nga instrumentë bazikë. Këto përbëhen nga huatë për kapital punues dhe investime, mbitërheqje dhe letra krediti (LK). Megjithëse LK-të përfaqësojnë më pak se 4 përqind të biznesit bankar të çdo banke dhe janë rreth €50,000 mesatarisht. Disa banka planifikojnë të zhvillojnë produkte të reja si p.sh. dhënia me qera dhe zbritje të parave që pritet të marrin gjatë 12 muajve të ardhshëm. Jo të gjitha bankat ofrojnë çeqe dhe karta plastike, dhe edhe kur ekzistojnë, përdoren kryesisht për pagesa doganore nga një pjesë e klientëve. Vetëm dy bankat më të mëdha ofrojnë instrumentë të pagesës kreditore elektronike dhe janë aprovuar për anëtarësim në sistemin SWIFT të pagesave ndërkombëtare. Ata gjithashtu kanë krijuar një rrjet prej rreth 40 ATMsh dhe planifikojnë ta dyfishojnë rrjetin e tyre gjatë 12 muajve të ardhshëm. Këto banka prodhojnë karta debiti të vetat dhe numra PIN për klientët e tyre, megjithëse vetëm një numër i vogël i klientëve të tyre i përdorin ato. Të dyja këto banka po planifikojnë të nxjerrin karta debiti të njohura ndërkombëtarisht (Visa, MasterCard), e më pas edhe karta krediti.

**3.41 Pjesa më e madhe e depozitave është afatshkurtër dhe potencialisht e paqëndrueshme, dhe ka tendencë ta kufizojë sektorin bankar në dhënieën e huave afatgjatë.** Depozitat pa afat përbëjnë 59 përqind të aseteve totale, nga të cilat gjysma janë depozita individuale. Katër nga gjashtë bankat e rendisin afatin e bazës së depozitave si një pengesë e madhe apo shumë e rëndë për zhvillimin e sektorit bankar. Gjithashtu, gjysma e bankave e konsideronin konkurrencën nga huadhënësit e tjerë që ofrojnë hua më afatgjatë si një pengesë e madhe për zhvillimin e tyre. Kjo duhet të sjellë një reduktim gradual të normave të interesit për huatë afatshkurtra. Sidoqoftë, me qëllim të rritjes së afateve të depozitave të tyre, bankat me depozita më afatshkurtra mund të vendosin të ofrojnë norma më të larta interesi për depozitat dhe të aplikojnë norma më të larta interesi për huatë, të cilat vetëm huamarrësit që rrezikojnë apo që s'kanë ndër mend të paguajnë janë të gatshëm t'i marrin. Depozitat janë kryesisht të përqendruara në dy bankat me pronë të huaj. Në fund të vitit 2002, depozitat në këto dy banka përbënin 74 përqind të depozitave totale të sistemit. Konkurrenca në tregun për depozita është jashtëzakonisht agresive mes bankave lokale. Konkurrenca më e madhe në sektorin bankar po sjell uljen e diferencës mes normave të interesit, megjithëse diferenca aktuale vazhdon të jetë mjaft më e lartë sesa ajo që vërehet në vendet e tjera të rajonit.

<sup>44</sup> Duke përfshirë Zvecan, të gjitha bankat e kanë të paktën një nëndegë në secilën komunë.

3.42 **Pasiguria politike duket se do të ndikojë negativisht në rritjen e një baze të depozitave stabile dhe më afatgjatë.** Sipas anketës, pasiguria e marrëveshjeve politike dhe ligjore, ndikon vetëm në mënyrë indirekte mbi biznesin bankar/huadhënës duke kufizuar afatet e bazës së depozitave. Megjithëse raporti në rritje depozita/para tregon një rritje të vogël po të vazhdueshme të besimit publik në sistemin bankar, pasiguria e situatës aktuale rezulton në shqetësime rreth sigurisë së pronave (pasurisë) dhe kursimeve.

3.43 **Megjithë pasigurinë politike, huadhënie është në rritje, dhe huatë totale për sektorin privat janë rritur me 177 përqind dhe arritën në €163 milionë në qershor 2003, që përfaqëson pothuajse një dyfishim të stokut të huave totale të regjistruara në fund të vitit 2002.** Norma mesatare e interesit si për huatë e kapitalit punues ashtu edhe për huatë për investime është 14 përqind. Huadhënia në sektori bujqësor vazhdon të jetë në nivele minimale: përbënte vetëm 2 përqind të portofolit në qershor 2003.<sup>45</sup> Aktiviteti i huadhënies vazhdon të jetë i siguar kundrejt kolateralit që luhetet mes 100 dhe 300 përqind në rastin e huave bankare, dhe 100 dhe 200 përqind në rastin e huave të dhëna nga IMF-të. Burimet më të rëndësishme të kolateralit janë toka, prona komerciale, asete dhe makineri personale. Vlerësimi i kolateralit konsiderohej nga sistemi bankar si një pengesë e vogël, dhe mungesa e qartësisë së të drejtave mbi tokën nuk duket se pengon zhvillimin e huadhënies. Sidoqoftë, gjysma e bankave e konsideronin infomacionin e pasigurtë financiar si një pengesë të madhe për huadhënien e shëndoshë.

3.44 **Cilësia e portofolit të huave të sistemit bankar është e mirë, por pritjet të përkeqësohet.** Megjithëse pjesa e huave që nuk po kthehen vazhdon të jetë në një nivel të arsyeshëm, ajo pritjet të rritet me kalimin e kohës ndërkohë që portofoleve të huave u vjen afati dhe zgjerimi i kreditimit vazhdon. Dispozitat kundrejt humbjeve të huave ishin, respektivisht, rreth 3 përqind, dhe 3.5 përqind të portofolit të huave të vonuara në dhjetor 2002 dhe qershor 2003

**Tabela 3.4: Cilësia e Portofolit të Huave**

	31 dhjetor, 2002	30 qershor, 2003
Huatë totale (€)	86,498,000	162,444,000
Totali i huave të kaluara për t'u paguar (mbi 30 ditë) në €	3,139,000	5,873,000
Totali i huave që nuk janë kthyer (mbi 90 ditë) në €	836,000	2,288,000
Totali i huave me humbje	1,588,000	1,415,000
Huatë e kaluara për t'u paguar/huatë totale (%)	3.6	3.6
Huatë e pakthyera/huatë totale (%)	0.96	1.40
Huatë me humbje/huatë totale (%)	1.80	0.87

*Burimi:* BPK.

3.45 **Zbatimi i të drejtave të kreditorëve dhe i kontratave është një pengesë kyç.** Nga 10 huadhënës, shtatë e renditën zbatimin e të drejtave të kreditorëve si një pengesë shumë e rëndë apo e madhe. Mungesat në procedurat gjyqësore lejojnë abuzime me procesin. Performanca e gjykatave komunale është e dobët, dhe apelimi dhe shtyrja

<sup>45</sup> Shumica e huadhënies në bujqësi jepet nëpërmjet linjave të kreditit të specializuara për bujqësi nga institucionet financiare jobankare dhe IMF-të. Deri me 30 qershor 2003, portofoli I huave të IMF-ve arrinte në rreth 35.2 milionë euro për rreth 18000 hua.

(azhurnimi) janë tepër të lehta për t'u siguruar, gjë që mund të nxisë një kulturë të jopagesës, duke pasqyruar mungesën e sanksioneve efektive për rastet e refuzimit. Paparashikueshmëria gjykimit, gjatësia e procesit, kompleksiteti i ligjit procedural që e udhëheq procesin, mungesa e qartësisë së procedurave, dhe ekzekutimi i gjykimit konsideroheshin si pengesat e mëdha për zbatimin e të drejtave të kreditorëve. Vetëm dy banka asnjëherë nuk kanë ndërmarrë ndonjë padi ligjore kundër një huamarrësi që s'pagan në kohë; pjesa tjetër kanë ndërmarrë një total prej 300 padish penale. Sidoqoftë, për gjysmën e huadhënësve, përqindja e çështjeve ligjore të përfunduara është më pak se 1 përqind dhe koha e nevojshme për të përfunduar një çështje ishte rreth 18 muaj.

**3.46 Një regjim efektiv dhe efikas kundër pastrimit të parave vazhdon të jetë larg implementimit.** Një ekonomi e bazuar në mjetet e gatshme (cash) e bën Kosovën të ndjeshme ndaj aktiviteteve të pastrimit të parave dhe financimit të terroristëve. Rezultatet e anketimit arrijnë në përfundimin se pastrimi i parave nuk është i dukshëm, dhe ekzistojnë rregulla që ua ndalojnë bankave dhe institucioneve financiare të përfshihen në aktivitete të pastrimit të parave. Sidoqoftë, ka tregues se Kosova mund të tërheqë aktivitete të tilla. Pozicioni gjeografik i Kosovës është në mes të një rruge të njohur për trafikimin e drogës, armëve dhe njerëzve. Për më tepër, shumë sektorë përfaqësojnë mjete potenciale për pastrimin e parave si p.sh. sektorët e sigurimeve dhe ndërtimtarisë. Një rregullore për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terroristëve, u bë efektive me 1 mars, 2004. Meqë Kosova nuk është akoma anëtare e Këshillit të Europës, nuk mund të zgjidhet, pranohet për asistencën teknike që Këshilli i Europës i ka dhënë vendeve fqinje.

### **Rekomandimet e Politikave**

3.47 Rezultatet e anketimit dhe faza akoma fillestare e sektorit bankar tregojnë nevojën për vazhdimin e fuqizimit të rolit të sektorit bankar në mobilizimin e kursimeve dhe zgjerimin e kreditit për aktivitetet prodhuese si vijon:

- Të forcohet kapaciteti i gjykatave komunale për implementimin dhe zbatimin e të drejtave të kreditorëve dhe kontratave. Kjo do të sillte dhe forconte një kulturë të fuqishme të pajtimit me praktika të shëndosha të huadhënies.
- Të përmirësohet zhvillimi i një tregu kredie funksional duke forcuar raportimin kontabilist dhe financiar si për njësitë financiare ashtu edhe për ato jo-financiare. Kjo do të (i) u jepte huadhënësve një vlerësim më të saktë të kushteve financiare të sektorit të ndërmarrjeve; (ii) do të nxiste transparencën dhe cilësinë e raportimit rregullator nga bankat, dhe (iii) do t'i jepte BPK-së një vlerësim më të saktë e të pavarur rreth kushteve financiare të huadhënësve, gjë që është veçanërisht e rëndësishme në një situatë ku funksionet mbikqyrëse vazhdojnë të jenë në një fazë zhvillimore.
- Të ndërtohet kapaciteti institucional i nevojshëm për implementimin e suksesshëm të një strategjie efektive për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terroristëve.

## **4. POTENCIALET DHE PENGESAT PËR RITJEN NË NIVELIN SEKTORIAL**

### **A. HYRJA**

4.1 Ky kapitull analizon perspektivën afatmesme dhe pengesat për rritjen në tre sektorë ekonomikë, në të cilët Kosova ka një begati të konsiderueshme dhe një avantazh potencial relativ, të cilat janë: energjia, minierat dhe bujqësia. Çështjet kyçe që ndikojnë mbi rritjen në nivelin sektorial përfshijnë (i) ato që pengojnë sektorin e NVM-ve në përgjithësi siç janë mungesa e furnizimit të rregullt me energji elektrike dhe konkurenca e padrejtë ose joformale, dhe (ii) ato që ndikojnë në klimën e investimeve për investitorët e huaj duke përfshirë vonesat e privatizimit dhe vështirësitë për të tërhequr IHD-të pa masa që mund të zbusin rrezikun politik.

4.2 Në fund të çdo seksioni janë bërë rekomandime të veçanta për çdo sektor. Në sektorin energjistik, kryesore është rehabilitimi i gjenerimit të energjisë dhe minierave të linjtit përpara se të shihen mundësitë e eksportimit në tregun rajonal të energjisë. Si hap të parë të nevojshëm autoritetet duhet të përgatisin një strategji gjithpërmblëdhëse, si dhe IHD të rëndësishme në mënyrë që të rinisin dhe/ose të zgjerojnë operacionet. Në sektorin bujqësor, agro-përpunuesit tregëtar përfaqësojnë burimin më të mirë të rritjes potenciale. Lehtësimi i lidhjeve me investitorët e huaj për të përmirësuar njohuritë teknike dhe prodhueshmërinë do të përmirësonte konkurrencën e biznesit Kosovar.

4.3 Seksioni i parë merr në konsideratë sektorin energjistik. Pas tij do të shohim sektorin e minierave, duke përfshirë çështjet që kanë të bëjnë me minierat/nxjerrjen e linjtit. Si përfundim, në seksionin tre do të merren në konsideratë perspektivat e rritjes në sektorin bujqësor.

### **B. SEKTORI ENERJITIK**

#### **E shkuara dhe zhvillimet e fundit**

4.4 Kosova është shumë e varur te furnizimi me energji që sigurohet nga përdorimi i linjtit. Burimi kryesor i energjisë në Kosovë janë rezervat e saj të mëdha të depozitave të linjtit me vlerë të lartë kalorifike, rezervat e të cilit janë vlerësuar të jenë mbi 10 miliardë tonë. Kosova nuk ka burime të tjera të lëndëve djegëse fosile, import gazi natyror dhe infrastrukturë furnizimi, as rafineri naftë, dhe potencial modest hidroelektrik.

**4.5 Në momentin e tanishëm, sektori energjitik nuk është në gjendje të bëjë një furnizim 24-orësh dhe bizneset e konsumatorët shtëpiakë ngarkohen me shpezime shtesë duke përdorur gjeneratorët e tyre rezervë.** Rrjeti elektrik mbulon gati 100% të shtëpive dhe është i organizuar si një shërbim publik i integruar vertikalisht: Korporata Energjitike e Kosovës (KEK) - një ndërmarrje në pronësi publike (NPP). Sistemi energjitik është në të vërtetë një pjesë e cinguar e sistemit të mëparshëm jugosllav. Mundet të përmbushë nevojat e brendshme për energji vetëm në sajë të eksportimit të energjisë së tepërt të prodhuar gjatë orëve me kërkesë të ulët energjie, dhe importimit nga sistemet energjitike të vendeve fqinje gjatë orëve me kërkesë të lartë energjie.<sup>46</sup> Në këtë moment, kapaciteti i saj i instaluar nominal i prodhimit të energjisë që është rreth 1,513 MW është në gjendje të prodhojë vetëm rreth 640 MW për shkak të moshës së vjetër të blloqeve të prodhimit, dekadave të mirëmbajtjes jo të duhur, dëmtimit fizik të shkaktuar gjatë konfliktit dhe së fundmi rënia e një rrufeje.<sup>47</sup> Si rrjedhojë teprica e ngarkesës bazë të prodhimit të energjisë elektrike u tkurr, dhe tani është kthyer në një rrjet importues të energjisë elektrike. Kjo ka çuar në ndërprerje serioze të energjisë elektrike, dhe nisjen e praktikës së katër orëve të furnizimit të ndjekur nga 2 orë pa energji, duke i detyruar shtëpitë dhe bizneset të përdorin gjeneratorë të vegjël rezervë që përdorin karburante të lëngshme të importuara. Me financim të BE po bëhet rehabilitimi i një prej linjave të gjenerimit termik, Kosova B, dy blloqe të vegjël të Kosova A mund të jenë të pa vlerë për t'u reabilituar, dhe për rehabilitimin e tre blloqeve më të mëdhenj të Kosova A, nuk ka akoma ndonjë financim në dispozicion.

**4.6 Sektori energjetik është bërë një barrë serioze mbi burimevet publike me gjithë tarifën mesatare të arsyeshme të energjisë elektrike prej €0.06 for kWh në nivelin e shitjes.** Në kohën e tanishme humbet rreth 18 përqind të energjisë së përgjithshme bruto<sup>48</sup> për shkak të humbjeve teknike dhe 23 përqind më shumë për shkak të vjedhjes së energjisë. KEK-u faturon 59 përqind që mbeten, dhe inkasimet në vitin 2002 ishin vetëm 59 përqind të shumës së faturuar. Konsumatorët rezidencialë ishin shpërdoruesit më të këqinj me 75 përqind të shitjeve të përgjithshme. Për këtë arsye në vitin 2002 u kthyen në të ardhura vetëm rreth 34 përqind e energjisë bruto në dispozicion.<sup>49</sup> Ky raport duhet të ishte rreth 90 përqind në një ndërmarrje publike të kësaj madhësie të vogël e të drejtuar mirë. Të ardhurat e humbura nga sektori energjitik në vitin 2002 vlerësohen në rreth €109 milionë ose rreth 8.5 përqind të PBB-së së atij viti.<sup>50</sup> Llogaritë për t'u vjelur nga ndërmarrja publike prej €144 milionë (në fund të shtatorit 2003) e kanë kaluar tepër vlerën e shitjeve të saj vjetore. KEK-u është teknikisht i paaftë të paguajë dhe varet nga të ardhurat publike dhe asistenca e donatorëve jo vetëm për rehabilitimin e asetëve por edhe për nevojat e mirëmbajtjes dhe për të paguar importet e energjisë elektrike nga rrjeti.

---

<sup>46</sup> Është e ndërlidhur me fqinjët e saj me linja transmetimi prej 400 kV dhe 220 kV. Sistemi i saj energjetik është pjesë e Zonës së Dytë të Sinkronizuar të UCTE që përbëhet nga sistemet energjetike të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë, Kosovës, IRJ e Maqedonisë dhe Serbi Mali i Zi .

<sup>47</sup> Kapaciteti i rrjetit në dispozicion është 1340 MW. KEK-u ka dy impiante energjie termike Kosova A (5 blloqe për një total prej 800 MW, shumica ndërmjet 30 dhe 40 vjet të vjetër) dhe Kosova B (2 impiante për një total prej 678 MW) dhe një impiant hidrik prej 35 MW.

<sup>48</sup> Energjia e përgjithshme bruto përbëhet nga prodhimi i brendshëm plus importin neto.

<sup>49</sup> Ky raport u përmirësua në 41.3 përqind në 9 muajt e parë të 2003.

<sup>50</sup> Rreth 10 përqind e defiçitit është i shpjegueshëm në kushtet e nivelit mesatar të tarifave në vitin 2002 që ishte rreth 90 përqind e tarifës normative. Pjesa tjetër e defiçitit i detyrohet plotësisht humbjeve të mëdha dhe faturimit e inkasimit të dobët.

## Perspektiva Afatmesme

4.7 **Rezervat e bollshme të linjtit përbëjnë potencial për sektorin e energjisë që të bëhet një motor i rritjes në vend të të qënit një sforcim dhe ndrydhje e fondeve publike.** Depozitat e linjtit kanë në përberje sasi të ulëta të sulfurit dhe hirit, koncentrim të mjaftueshëm gëlqereje për të thithur squfurin gjatë djegies, dhe një mbishtresim tërheqës të raportit të linjtit, që e bën shumë ekonomike nxjerrjen e materialit. Me futjen e praktikave moderne të nxjerrjes së mineralit, energjia e prodhuar nga përdorimi i linjtit me kosto të ulët do të ishte shumë konkurruese në rajon.

4.8 **Perspektivat për sektorin energjitik janë të mira nëse Kosova mund të bëhet një eksportues-final në tregun rajonal.** UNMIK-u është nënshkruar i Memorandumit të Athinës 2002 që themeloi Tregun Jug-Europian Rajonal të Energjisë (TJERE)<sup>51</sup> për t'i dhënë një shtytje tregëtimit rajonal të energjisë mbi bazat e konkurrencës në treg. Kërkesa në vendet e TJERE pritet të rritet me 2% në vit gjë që kërkon rritjen e kapacitetit me rreth 4.5 GW deri në vitin 2012, duke i siguruar Kosovës në këtë mënyrë një treg të shkëlqyer për eksporte. Një njësi në Kosovë prej 1000 MW e orientuar për eksport mund të gjeneronte të ardhura prej eksportit në rreth 225 milionë euro ose 17 përqind të PBB-së (PBB).

4.9 Për të mundur pjesëmarrjen në tregun rajonal, Kosova ka formuar një njësi qëndrore rregullatore, e cila përfshin një Regullator të Energjisë Elektrike. Për formulimin e politikës së energjisë dhe mbikqyrjen e sektorit është formuar gjithashtu një Zyrë për Energjinë. Po përgatiten plane për ta ndarë sektorin dhe për të krijuar një kompani të pavarur të transmetimit dhe shpërndarjes. Janë në hartim ligje të reja për energjinë, minierat, ngrohjen zonale, dhe rregullore nën këto ligje për të bërë të mundur zbatimin e reformave të parashikuara në Memorandumin e Athinës dhe direktivave të BE në lidhje me këtë.

4.10 Qeveria gjithashtu ka përgatitur një Letër të Bardhë që nënvizon strategjinë e saj për sektorin, që përfshin: (i) sigurimin e fondeve në dispozicion për importin e energjisë elektrike; (ii) parandalimin e vjedhjes së energjisë dhe përmirësimin e inkasimeve; (iii) përmirësimin e drejtimit të ndërmarrjes energjitike nga ana e korporatës ndërmjet përdorimit të një kontrate menaxhimi; (iv) ndërtimin e një linje 400 kV me Shqipërinë për të mundur një shkëmbim më të lehtë të energjisë hidroelektrike nga Shqipëria dhe energjisë termike nga Kosova; (v) integrimin e sektorit energjitik të Kosovës me TJERE për ta ekspozuar atë ndaj konkurrencës rajonale; dhe (vi) duke u mbështetur në investime private për nxjerrjen e linjtit dhe për të krijuar një kapacitet të ri të gjenerimit të energjisë që nevojitet brenda vitin 2008 për të zëvendësuar kapacitetet që do të dalin nga prodhimi, për të përmbushur kërkesën në rritje dhe për të rritur në mënyrë substanciale eksportet e energjisë elektrike. Po bëhet progres për të respektuar zbatimin e kësaj strategjie: Për të ndryshuar menaxhimin e ndërmarrjes publike të energjisë KEK po rekrutohen Kontraktorë menaxhues dhe me mbështetjen e Bankës Botërore po zhvillohen diskutime për të ndërtuar linjën e re me Shqipërinë. **Sidoqoftë, pa një progress të shpejtë, sektori energjitik do të vazhdojë të jetë një pengues i hapësirës së biznesit, një rrezik fiskal dhe një rast i humbur për rritjen e eksportit në të ardhmen.**

<sup>51</sup> Nëshkruarit e Memorandumit të Athinës përfshijnë përveç atyre të Zonës së Dytë të Sinkronizuar UCTE, edhe Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, Italinë dhe Turqinë.

## **Pengesat për Rritjen**

**4.11 Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike kërkon (i) një përmirësim të performancës operacionale dhe financiare të KEK-ut dhe (ii) përmirësim të marrëveshjeve për të kontraktuar dhe financuar importet e energjisë elektrike.** Pengesa e tanishme në hapësirën e biznesit kërkon një veprim të menjëhershëm në këto dy fronte. Me një përmirësim të niveleve të faturimit dhe të inkasimit, dhe progresit me reformat e menaxhimit dhe ristrukturimit të fuqisë punëtore, KEK-u mund të përmirësojë pozitën e tij operuese. Në të njëjtën kohë planifikimi i hershëm dhe angazhimet financiare për importet e energjisë elektrike do t'i japin menaxhmentit të KEK-ut më shumë fleksibilitet për të siguruar zgjidhjen me kosto më të ulët kur të kontraktotë me furnizuesit rajonalë të energjisë elektrike

**4.12 Menaxhimi i dobët i KEK-ut dhe marrëveshjet e udhëheqjes së korporatës e komplikojnë zgjidhjen e një furnizimi më të besueshëm me energji elektrike.** KEK-ut i mungojnë nëpunës të lartë dhe të mesëm me eksperiencë të duhur profesionale. Ndërmarrja mbështetet në ekspertiza teknike dhe menaxhimi të stafit nderkombëtar nëpërmjet marrëveshjeve të financuara nga BE. Drejtimi në shkallë korporate është i dobët meqë shumica e vendeve në bordin mbikqyrës të saj janë bosh për afate të konsiderueshme kohore. Në kontekstin e përgjegjësive të ndara ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-së (IPVQ), bordit mbikqyrës gjithashtu i mungon kohezioni. Si një NPP, KEK – u është nën përgjegjësinë e Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit, si rrjedhim dhe nën UNMIK-un sipas kornizës kushtetuese. Megjithatë, nevoja për mbështetje të gjërë nga IPVQ-ja dhe përdorimi i fondeve publike e bën KEK-un një çështje të veçantë shqetësimi për IPVQ-në dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në veçanti. Kjo ngre nevojën për bashkëpunim të ngushtë midis dy elementëve administrativë në Kosovë, dhe e bën edhe më të rëndësishme nevojën për një drejtim të korporatës dhe për marrëveshje menaxhimi të mira.

**4.13 Sistemi policor dhe gjyqësor duhet të mbështetin fushatat e shkyqjeve të KEK-ut për të përmirësuar shkallët e inkasimit.** Sistemi policor dhe gjyqësor nuk janë në gjëndje të mbrojnë të drejtat e pronësisë së KEK-ut dhe t'i sigurojnë mbështetjen e nevojshme për të kontrolluar vjedhjen, të ndjekë penalisht dhe të dënojnë ata që vjedhin energjinë elektrike. Një fushatë e kohëve të fundit e KEK-ut për të zbuluar vjedhjet e energjisë elektrike dhe për të shkyçur lidhjet e konsumatorëve ilegalë, rezultoi vetëm 10,000 raste që janë lënë pezull në gjykata, ndërkohë që thyerësit e ligjit vazhduan të rilidhen në mënyrë ilegale me rrjetin shpërndarës.

**4.14 Zgjidhja standarte e privatizimit të ndërmarrjeve shpërndarëse për të përmirësuar performancën nuk është praktike.** Pronësia e aseteve të sektorit të energjisë nuk është e qartë. UNMIK-u si kujdestar e krijoi KEK-un thjesht për të operuar ndërmarrjet dhe themeloi AKM-në që të vepronte si administrator.

**4.15 Rehabilitimi i aseteve është bërë pjesë-pjesë dhe ende nuk është përfunduar.** Nevojiten fonde publike dhe mbështetje e vazhdueshme nga donatorët për të përfunduar rehabilitimin dhe rikonstruktimin e infrastrukturës energjitike. Tabela 4.1 më poshtë na jep vlerësime të arsyeshme të kërkesave për investime gjatë 5 viteve të ardhshëm. Në mungesë të një plani financimi të kënaqshëm dhe të sigurtë, KEK-u nuk është në gjëndje të vërë proritete dhe të përgatisë një plan racional zbatimi për këto investime.

4.16 Në periudhën afatmesme, rehabilitimi i sukseshëm i infrastrukturës do të hiqte pengesat nga kapaciteti i gjenerimit të energjisë dhe shpërndarjes. Furnizimi me linjit sidoqoftë mund të bëhet një pengesë e rendësishme. Pas përfundimit të rehabilitimit në vazhdim të blloqeve gjenerues që pritet të përfundojë në vitin 2004, kapaciteti në dispozicion do të arrijë në rreth 800 deri në 900 MW. Dy minierat që operohen nga KEK-u kanë një punë të prapambetur të heqjes së mbishtresimeve dhe pajisjeve të shkatërruara. Operacionet e tanishme për nxjerrjen e mineralit janë duke u zhvilluar nën rreziqe të krijuara nga metodat e pasigurta dhe afat-shkurta të përdorura për nxjerrjen e mineralit gjatë viteve 1990 dhe nga një rrëshqitje toke në vitin 2002. Për më tepër këto dy miniera pritet të varfërohen deri në 2008 dhe do të duhet të hapet një minierë e re për t'iu përgjigjur nevojave të së ardhmes. Seksioni tjetër përmban një vlerësim më të gjërë të sektorit të minierave, duke përfshirë minierat e linjtit.

**Tabela 4.1: Programi i Propozuar i Investimeve në Sektorin Energjistik nga PIP (në milion €)**

Nr.	Zëri	2004-2005	2006-2008	Totali
1.	Gjenerimi i energjisë: Rehabilitimi	67	-	67
2.	Transmetimi i energjisë	25	39	64
3.	Transporti	13	6	19
4.	Shpërndarja e Energjisë	125	90	215
5.	Nxjerrja e Mineralit të Linjtit	57	100	157
6.	Ngrohja zonale	19	20	39
7.	Karburante të lëngshëm	19	4	23
8.	Gazi natyror	-	-	-
9.	Efektshmëria & ripërtëritja e Energjisë	2	4	6
10	Plani i Veprimit ndaj Mjedisit	4	14	18
11	Zëra të tjerë të ndryshëm	4	3	7
	<b>Totali</b>	<b>335</b>	<b>280</b>	<b>615</b>

*Burimi:* Versioni i Letrës së Bardhë Shtator 2003 .

## Rekomandimi i Politikave

4.17 Në mënyrë që sektori të bëhet një motor rritjeje, duhet të ndërmerren një sërë reformash të sektorit për një zbatim të qëndrueshëm. Këto përfshijnë stabilizimin e furnizimit me energji; futjen e një Kontrate Menaxhimi të re të bazuar në performancë dhe të lidhur me stimuj për të përtërirë drejtimin e korporatës; kontrollin e korrupsionit dhe parandalimin e vjedhjes së energjisë; dhe përmirësimin e faturimit dhe inkasimit deri në normat e industrisë; ristrukturimin e KEK-ut; mbrojtja e kornizës ligjore dhe rregullatore dhe duke e vënë rregullatorin e energjisë plotësisht në funksion; integrimin e Kosovës në tregun rajonal të energjisë; dhe fuqizimin e kapacitetin institucional për të përmirësuar tregtimin e energjisë me ndërmarrjet në rajon.

4.18 Në afatin e menjëhershëm duhet të zgjidhen shpejt çështjet e mëposhtme:

- Të vazhdohet të shkyçen ata që nuk paguajnë faturat e tyre, shoqëruar me një përpjekje e përbashkët për tu siguruar që nuk do të ketë rikyçje ilegale. Të lehtësohet mbledhja e shpejtë e borxheve të papaguara ndaj ndërmarrjes elektrike, duke fuqizuar kapacitetin e policisë dhe gjykatave që të zbatojnë detyrimet e kontratave dhe të ndjekin penalisht vjedhjen e energjisë dhe korrupsionin.
- Të ndërmerret një rishikim të masës limit të konsumit mujor të konsumatorëve rezidencialë në bllokun më të ulët të tarifave, të zvogëlojë në mënyrë substanciale nga niveli i lartë i tanishëm që është 800 kWh, dhe të vendosin një shkallë minimale jetese për këtë bllok me të ulët tarifor.
- Të përfundojë rehabilitimin e blloqeve të gjenerimit të energjisë, paisjeve të minierave dhe rrjetin e transmetimit e shpërndarjes, në përputhje me një program investimi të miratuar nga UNMIK-u dhe IPVQ-ja. Prioritet duhet të jenë rehabilitimi i kapacitetit prodhues dhe sigurimi i fondeve të duhura për shpenzimet e mirëmbajtjes për blloqet e rehabilituara, shkurtimi i humbjeve jo-teknike, dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientit. Reformat e nevojshme në minierat e linjitet janë më të detajuara në seksionin në vijim
- Të përmirësohet parashikimi i kërkesave të Kosovës për të importuar energji dhe të sigurohet që masat buxhetore adequate janë (i) në dispozicion dhe (ii) transparente në financimin e importeve të tilla.
- Të krijojë marreveshje drejtimi në mënyrë që ato të jenë linja të qarta raportimi të menaxhmentit të KEK-ut para Bordit, dhe nga Bordi te autoritetet. Të sigurohet se menaxhmentit nën Kontratën e re të Menaxhimit i jepet autonomi e duhur për të operuar dhe të mbajnë përgjegjësi për performancën.

4.19 Në periudhën afat-mesme autoritetet duhet të zbatojnë masa të ristrukturimit të sektorit dhe të tregut për t'iu përshtatur detyrimeve të Memorandumit të Athinës për pjesmarrjen në TJERE; masa për të inkurajuar konsumatorët që të kalojnë nga energjia elektrike në karburante me kosto më të ulët por që të jenë të pastër nga ana mjedisore për ngrohjen e hapësirave dhe gatim; përmirësim të prodhueshmërisë nëpërmjet racionalizimit të stafit dhe përtëritjes së aftësive; liberazim të tregut me faza; dhe krijim i një kornize për të thithur investimet e sektorit privat në sektorin e energjisë. Këto masa janë përpunuar më poshtë:

- Të plotësohet me staf zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe të bëhet plotësisht funksional;
- Të vendoset një Operator i Pavarur i Sistemit të Transmisionit;
- Të ndahen tarifat e përbëra në tarifa të ndara për gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin, siç të vendoset nga rregullatori i energjisë;
- Të përcaktohen dhe të jepen kodet e rrjetit elektrik, kodet komerciale, rregullat e tregut dhe rregullat e hyrjes së palëve të treta në sistemin e transmetimit.
- Të kërkohen lëndë djegëse alternative të pastra nga ana mjedisore, dhe të hetohet më tej mundësia për të ulur taksat për karburantet e lëngshëm, për qëllime ngrohje të hapësirave dhe për gatim. Kjo jo vetëm do të

përmirësojë pagesat e faturave të energjisë elektrike nga konsumatorët por gjithashtu do të zvogëlojë kërkesën e madhe gjatë muajve të dimrit.

- Duhet të zbatohet zvogëlimi i madhësisë së ndërmarrjeve për të shkurtuar numrin e tepërt të fuqisë punëtore të KEK-ut, dhe në të njëjtën kohë, të përtërihen aftësitë e stafit të mbetur, dhe të sigurohen stimuj për përmirësimet e prodhueshmërisë.

4.20 Në periudhën afatgjatë, do të kërkohej edhe reforma shitesë për të:

- *Ristrukturuar sektorin e energjisë.* Së pari, KEK-u duhet të korporizohet si një kompani me aksione të përbashkëta me pesë njësi biznesi të vetqëndrueshme brenda KEK-ut për minierat, gjenerimin, transmisionin, shpërndarjen dhe funizimin; me ndarje të qartë të aseteve, llogarive dhe stafit ndërmjet tyre. Tregtia e brendshme ndërmjet tyre duhet të bazohet në kontrata që përdorin tarifatat e ndara (të vendosura nga rregullatori) si çmime transferimi.
- *Liberalizuar tregun.* Pasi të jenë ribalancuar tarifatat, nis liberalizimi i tregut duke lejuar konsumatorët jo-shtëpiakë (p.sh., në fillim konsumatorët 110 kV) të blejnë energji elektrike nga prodhues vendas ose të huaj me çmimet e tregut. Në mënyrë graduale do të zvogëlohej pragu i konsumit për konsumatorët e përzgjedhur për të mbuluar në këtë mënyrë të gjithë konsumatorët jo-rezidencialë. Prodhuesit me detyrë të furnizimit të publikut do të furnizojnë konsumatorët e zënë nëpërmjet furnizuesve me detyrë të furnizimit të publikut me çmimet e paracaktuara.
- *Përgatiten për hyrjen e operatorëve nga sektori privat.* Për të thithur investimet private do të duhet të ndërmerret reforma e sektorit, së bashku me një rol të përcaktuar mirë për një investitor të ri në energjinë elektrike. Duhet të merret në konsideratë një strukturë sektori ku një investitor privat ka gjithashtu kontroll mbi një minierë linjiti (në vend që të kemi një investitor që të merret me të tërë minierat e qymyrit në Kosovë). Gjithashtu meqë një pjesë e mirë e kapacitetit prodhues të KEK-ut do të dalë në pension deri në vitin 2008, duhet të merret në konsideratë përfshirja e detyrimit për furnizimin e publikut për çdo operator të ri privat të energjisë elektrike. Këto çështje duhet të zgjidhen dhe të qartësohen në Kërkesat për Propozime që do të shpërndahen për një impiant të ri prodhimi.

4.21 **Në mungesë të interesit nga ana e investitorëve privatë, dhe/ose vonësive në reformimin e sektorit ekziston një nevojë për një strategji të tërheqjes për të zëvendësuar kapacitetin që do të dalë nga prodhimi në 2008-2010.** Investimet private në sektorin e energjisë elektrike të tregjeve që po shfaqen janë zvogëluar me hapa të shpejtë në vitet e fundit dhe aktualisht shumë prej tyre nuk i kanë investuar përsëri asetet e fitura në kohët e fundit. Në rastin e Kosovës, ekziston pasiguria shitesë për investitorët dhe huadhënësit. Një strategji tërheqjeje do të përfshinte: hapjen e një miniere të re linjiti dhe ndërtimin e kapacitetit minimal ndihmës si shitesë, të financuar pjesërisht nga paratë e thata të gjeneruara brenda KEK-ut, pjesërisht nga buxheti i qeverisë dhe huatë e mundëshme nga huadhënësit bilateral dhe multilateral.

## C. SEKTORI MINERAR

### E Shkuara dhe Zhvillimet e Fundit

4.22 **Industria minerare në Kosovë përpara vitit 1991 dhe historikisht ka qënë e rëndësishme si burim i fuqishëm aktiviteti ekonomik dhe fitime nga eksporti; dhe nje punëdhënës me më shumë se 17 000 minatorë në atë kohë.** Sidoqoftë, nga viti 1991 deri në 1999 industria vuajti nga moskujdesi kronik me ri-investime të vogla në operacionet e nxjerrjes së mineralit dhe objektet e procesimit të lidhura me të. Në shumë operacione, ra prodhimi dhe u rriten më tepër trashëgimitë negative mjedisore dhe sociale. Konflikti i vitit 1999 shërbeu vetëm si përshpejtues i rënies së sektorit, duke shkatërruar asete kryesore të prodhimit në shumë operacione. Nje herë e një kohë motor i rritjes ekonomike, industria ka vuajtur një zvogëlim domethënës të vlerës së asetëve. Ky seksion analizon prospektivat për ta rivitalizuar nxjerrjen e mineraleve<sup>52</sup> të mëposhtëm: linjiti, plumb dhe zink, hekurnikel, dyoksid magnezi dhe gur të thërmuar të cilët në këtë kohë, tregojnë potencialin më të mirë. Rëndësia e depozitave dhe gjëndja aktuale e operacioneve janë përmbledhur në pjesën tjetër të këtij seksioni. Në seksionet pasardhëse merren në konsideratë pengesat dhe perspektivat për të rifilluar operacionet përpara se të përfundohet me disa rekomandime të politikave.

4.23 *Linjiti.* Siç është diskutuar në seksionin paraardhës, Kosova ka depozita të rëndësishme linjiti, të cilat po të kthehen në energji elektrike do të të kishin një vlerë të konsiderueshme kur të shiteshin në tregun rajonal. Dy miniera (Mirash dhe Bardh), që operohen nga KEK-u janë momentalisht operacionale. Ato ndodhen pranë impiateve të prodhimit të energjisë. Kushtet fizike të minierave janë kritike dhe kanë vuajtur rrjedhojat e një rrëshqitjeje të madhe toke në vitin 2002, që mbuloi degët e prodhimit me 30 milion m<sup>3</sup> ngarkesë të tepërt. Për më tepër, minierat nuk janë në pozita të forta komerciale, meqë janë pjesë e sistemit energjetik të integruar vertikalisht<sup>53</sup>

4.24 *Plumb dhe Zink.* Kosova është gjithashtu e pasur me depozita plumb/zink të madhësive dhe shkallës modeste, të shpërndara përgjatë një brezi gjeologjik që zgjatet përgjatë anës Lindore të Kosovës, dhe të lidhura mirë me rrjetet e transportit. Tregu i zinkut mbetet i fuqishëm dhe Kosova e ka potencialin të bëhet ose një eksportues rajonal i materialit natyror dhe/ose produkte me vlerë të shtuar. Aktualisht depozitat janë në pronësi të Trepçes, ndërmarrje e gjërë në pronësi publike, e cila deri në vitin 1999 merrej me nxjerrjen në mënyrë të integruar të mineraleve plumb dhe zink dhe operacionet përpunuese që i shoqërojnë.<sup>54</sup> Trepça përbënte bërthamën e kompleksit industrial të ish-Jugosllavisë, dhe vazhdon të ketë mbi 10,000 minatorë në regjistra. Operacionet u ndërpre në vitin 2000 kur KFOR-i mbylli operimin për arsye mjedisore. Mes viteve 2000 dhe 2003 ka pasur mëshjetje të fuqishme nga donatorët për të rehabilituar minierat

---

<sup>52</sup> Nënsektorë të raportuar se kanë perspektivë në Kosovë por që nuk janë vlerësuar në këtë raport, përfshijnë boksitin, çimenton, dhe metalet e çmuar.

<sup>53</sup> Operacionet Perëndimore me plan prodhimi të ngjashëm me përdorim më të gjërë të teknologjisë operojnë me përafërsisht 500-1000 punëtorë.

<sup>54</sup> Në mesin e viteve 1990 një kompani greke e metaleve (Mytileneos Holdings S.A.) nënshkroi disa kontrata me Agjensinë Serbe të Tregëtisë së Jashtme për t'i rikapitalizuar operacionet në Trepçë me besimin se do të merrte një pjesë nga vlera e mbetur gjatë privatizimit të mundshëm të kompleksit dhe kjo është një çështje për t'u përcaktuar brenda kontekstit të çështjeve më të gjëra ligjore.

me qëllimin për të rifilluar operacionet për nxjerrjen e mineralit brenda këtij viti dhe për eksportimin e koncentratit të plumbit/zinkut.

4.25 *Hekurnikel.* Kosova ka dy depozita nikeli të përdorura në prodhimin e hekurnikelit brenda një brezi gjeologjik që shtrihet përtej kufinjve të saj në Shqipëri. Ferronikeli është një NPSH dhe një ish eksportues i hekurnikelit me vlerë të lartë për përdorim në industrinë e çelikut dhe të fabrikimit në Europën Qendrore dhe Perëndimore. Përpara vitit 1998, ndikimi ekonomik i Feronikelit ishte i gjerë dhe kishte punësuar 2000 punëtorë, sidoqoftë operacionet zhvilloheshin dobët dhe prodhimi nisi të bjerë në mes të viteve 1990 për shkak të problemeve teknike dhe më tej prodhimi u ndal përfundimisht në vitin 1999 kur bombardimet e NATO shkaktuan dëme në ndërtesa megjithëse objektet e prodhimit mbeten gjërësisht të paprekura. Kerkesat financiare për të rifilluar punën në ndërmarrje nuk dihen dhe nuk ka patur asnjë vlerësim të pavarur të procedurave të mbylljes së ndërmarrjes dhe madhësisë së dëmit nga bombat.

4.26 *Dyoksid Magnezi.* Stolec dhe Golash janë dy NPSH që operojnë në rajon dhe punësojnë afërsisht 400 punëtorë. Burimet gjeologjike kanë treguar se janë të përshtatshme për prodhimin e të dyja dyoksid magnesi kaustik dhe skorjeve/kore silico-gëlqerore, të cilat janë një burim potencial fitimesh nga eksporti. Nuk dihet gjëndja fizike e furrave prodhuese, por duke patur parasysh moshën e furrave dhe vjetërsinë e teknologjisë së përdorur, ka shumë mundësi të kërkohet një kapacitet i ri prodhues sesa rehabilitimi i atij ekzistues. Prodhimi nuk ka rinisur që në vitin 1999. Megjithatë, në këto momente, një menaxhment vullnetar i vetë caktuar që rrjedh nga operimi i mëparshëm po punon që të rifillojë operacionet dhe të fillojnë nxjerrjen e gurëve të thërmuar nga minierat e dyoksidit të magnezit.

4.27 *Gurët e thërmuar dhe materialet e ndërtimit.* Ky është një sektor privat industrial NVM që aktualisht përbëhet nga operatorë të licencuar dhe të palicencuar. Punësimi i plotë në këtë fushë nuk dihet por të ardhurat vlerësohen të jenë mes €5 dhe 10 milionë euro në vit.<sup>55</sup> Ky është një sektor që nuk varet nga thithja e investimeve të huaja direkte për tu rritur, meqë kapitali i nevojshëm është shumë më i vogël. Është përdorur tashmë kapital sipërmarrjeje private për të bërë një operacion në masë të gjërë.

### **Perspektiva në periudhën afatmesme**

4.28 **Edhe pse depozitat e Kosovës janë modeste sipas standarteve globale, ato kanë avantazh konkurrues meqë janë pranë tregjeve të Europës Perëndimore me kosto relativisht të ulta transporti në këto tregje.** Historikisht, çmimi i mallrave minerale në termat reale ka shkuar në rënie gjatë shumë dekadave. Sidoqoftë, përmirësimet teknologjike kanë rritur fitimet e prodhueshmërisë për të kompensuar çmimet në rënie. Dihet se çmimet e mineraleve ndjekin një strukturë të njëjtë dhe në këtë moment janë të larta.

4.29 **Me dëshirë politike dhe fuqizim të kapacitetit administrativ, shumë nënsektorë mund të bëhen raste tërheqëse investimi për investitorët privatë, dhe me kalimin e kohës do të pritej të krijonin mundësi punësimi dhe prespektivë eksporti.** Megjithatë, në sektorin e materialeve të ndërtimit, gurët e thërmuar ofrojnë perspektiva

---

<sup>55</sup> Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore

rritjeje me investime minimale dhe pengesa të vogla. Ferronikeli ofron mundësi privatizimi ndërkohë që çështjet kryesore që kanë të bëjnë me Trepçën dhe KEK-un duhet të zgjidhen së pari me strategji të përkohshme. Për shkak të mungesës së informacionit rreth operacioneve të Dyoksidit të Magnezit nevojiten të bëhen kërkime të mëtejshme rreth potencialit të tyre.

4.30 *Gurët e Thërmuar dhe Matrialet e Ndërtimit.* Nënsektori i gurëve të thërmuar është një burim rural punësimi, që mbështetet në burimet vendase të kapitaleve të investimit dhe të stafit profesional. Megjithëse operatorët individual janë punëdhënës modest për momentin, ka patur një kërkesë të madhe për këtë sektor si rezultat i rindërtimit/ndërtimit pas vitit 1999. Operatorët informalë duhet të liçensohen dhe të paguajnë taksa shfrytëzimi dhe në këtë mënyrë të sigurohen burime të të ardhurave publike. Nëse merret për bazë pesha në tonë, pagesat e taksave të përdorimit nga shitja e materialeve të ndërtimit janë zakonisht më të larta në baza njësie e lidhur kjo me çmimin e shitjes së mallit. Materialet cilësore nga operatorë të liçensuar mund të kontribuojnë drejt një infrastrukture më të qëndrueshme.

4.31 *Ferronikeli.* Kërkesa për hekurnikel në momentet e tanishme është e madhe dhe fabrika ndodhet në mënyrë konkurruese pranë tregut European. Në veçanti, kompleksi gjendet në një sistem hekurudhor që e lehtëson importimin e koncentratëve të mineralit lokal shqiptar ose koncentratëve ndërkombëtare nëpërmjet portit të thellë të Selanikut Privatizimi i suksesshëm i Ferronikelit do të injektonte investime private të rëndësishme dhe do të riniste operimin. Operimi i Ferronikelit ofron prespektiva fitimesh të mëdha nga eksporti, punësim që ia vlen (1,200 në kapacitet të plotë), dhe fitime të mëdha nga taksa e përdorimit.

4.32 *Trepça.* Nëse shihet tregu global dhe çmimet botërore vështirimi në periudhën afatmesme për eksportet e plumbit dhe zinkut është i mirë. Menaxhmenti i përkohshëm i Trepçës ka përcaktuar një strategji modeste dhe të drejtë, për rifillimin e operacioneve të nxjerrjes së mineralit. Kjo do të sillte fillimin e eksportit të koncentrateve të mineralit pa u mbështetur në IHD të rëndësishme. Përpunimi dhe procesimi i mëtejshëm mund të merret në konsideratë pasi minierat të jenë në punë dhe mjedisi të përmirësohet për privatizim dhe/ose sjelljen e një investitori. Kjo është gjithashtu një zgjidhje pragmatike që do të ndante problemet mjedisore që kanë të bëjnë në shkallë të gjërë me shkrirjen dhe përpunimin e produkteve të plumb/zink-ut. Në periudhën e ndërmjetme do të kishte rritje të përfitimeve nga punësimi (operacionet e nxjerrjes së mineralit mund të punësojnë 2,000 vetë) dhe kontribute modeste për sa i përket taksave të përdorimit. Me thithjen e investimeve private për të nisur operimin e impiantit ajo do të ishte më e rëndësishme me kalimin e kohës. Për më tepër operimi i minierave krijon një reaksion katalitik që tërheq investimet eksploruese, dhe mund të çojë në një shtim të prodhimit në të ardhmen.

4.33 *Linjiti.* Me zbatimin e suksesshëm të një strategjie reformash për ta vënë operimin e minierave në një rrugë komerciale, ka një mundësi të madhe që operimi i minierave të bëhet një aspekt i suksesshëm dhe kryesor në strategjinë e eksportit të energjisë elektrike. Një program reformash do të kërkonte investime shtesë dhe ndarje të njësive të biznesit të KEK-ut, si dhe shikimin e nevojës për rikonstruktimin e fuqisë punëtore.

4.34 Ndërkohë që struktura e biznesit të KEK-ut nuk lejon një strukturë transparente të çmimeve të brendshme mes operacioneve të nxjerrjes së mineralit dhe biznesit të prodhimit të energjisë elektrike, një vlerësim konservativ i çmimit të transferimit për operacionet e tanishme do të ishte afërsisht €5 euro për ton, ose €35 milionë euro të ardhura vjetore. Një strategji eksporti në të cilën 30 përqind e prodhimit të linjitit do të shitej për prodhimin e energjisë elektrike në tregun e brendshëm dhe 70 përqind për energjinë e drejtuar ndaj tregut të eksportit do të rezultonte në shitje të 5-7 milion tonë shtesë, ose 30 – 42 milion euro në vit, nëse minierat do të mund të rehabilitohen me sukses në kohën e duhur dhe me një impiant shtesë diku rreth vitit 2008.

4.35 *Dyoksidi i Magnezit.* Tregu kryesor për operimet e meparshme ishte Serbia, dhe në një shkallë më të ulët Rusia, Polonia, dhe Italia. Gjithashtu mund të ekzistojnë tregje në Slloveni dhe Bosnje. Mbyllja në vitin 1999 koinçidoi me një ndryshim të rëndësishëm struktural në tregjet e dyoksidit të magnezit që u shkaktua nga produkti me cilësi të lartë dhe çmim të ulët nga Kina i cili i nxorri nga loja prodhuesit tradicionalë të dyoksidit magnesi kaustik dhe skorjeve/kore silico-gëlqerore. Si e tillë një fabrikë magnezi në Kosovë do të përballlej me konkurrencë të konsiderueshme nga Kina. Perspektivat më të mundshme që ky operacion të dalë me sukses do të ishte afrimi ndaj tregjeve rajonale në Mesdhe dhe Gjermani, pasi të jenë vendosur operacione konkurruese. Blerësit në rajon kanë treguar tashmë interes, megjithatë kushtet operuese të dy frabrikave mbeten të panjohura.

### **Pengesat për Rritjen**

4.36 **Përtëritja e sektorit të minierave pengohet nga katër faktorë të lidhur ndërmjet tyre.** (i) nevoja për të thithur investime të rëndësishme për të rifilluar operacionet; (ii) situata e pasigurtë politike dhe institucionale e Kosovës që po e zhbind investimin nga ana e sektorit privat; (iii) shqetësimet sociale, mjedisore dhe ligjore që duhet të zgjidhen në mënyrë që të thithen investitorë me cilësi dhe (iv) marrëveshje të qeverisjes të cilat do të shpinin në mospërputhje opinionesh mbi strategjitë e përtëritjes brenda agjensive kryesore.

4.37 **Pengesa qendrore për rritjen në këtë sektor është se operacionet nuk mund të fillojnë pa injektim të mëdha kapitali dhe përmirësime teknike.** Tabela 4.2 më poshtë vlerëson magnitudën e kapitaleve hyrëse që do të nevojiten. Në mënyrë që të thithen IHD-të, shqetësimi kryesor me të cilin përballen investitorët privatë do të jetë rreziku dhe ekspozimi financiar. Duke përjashtuar depozitat e mëdha të linjitit, burimet e tjera minerare të Kosovës janë në përgjithësi të një interesi rajonal, dhe ofrojnë nivele të moderuara përfitimesh ekonomike dhe për këtë arsye meritojnë nivele të ulta risku investimesh. Faktorët në vijim do të kenë një ndikim të madh në mendjet e investitorëve të huaj që vlerësojnë perspektivat për të bërë biznes në Kosovë (i) të drejta dhe tituj të qartë për nxjerrjen e mineralit (legjislacioni për minierat), (ii) kushte fiskale tërheqëse dhe konkurruese (taksa të përgjegjshme), (iii) pronësia dhe kontrolli i operacioneve (legjislacioni për minierat), (iv) stabilitet politik dhe transparencë e qeverisjes (institucionet qeveritare), dhe (v) infrastruktura në dispozicion.

**Tabela 4.2: Vlerësim i Kerkesave të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Sektorin e Minerave.**  
(në miliona USD\$)

Nr.	Zëri	Vlerësimi i IHD m USD\$
<b>1.</b>	<b>Linjiti</b>	<b>50-175</b>
	Rivënia në punë e minierave në Mirash dhe Bardh	50-75
	Zhvillimi i një fushe të re linjiti	100
<b>2.</b>	<b>Ferronikeli</b>	<b>23-250</b>
	Nëse impianti do të ishte fikur në mënyrën e duhur	23
	Nëse fikja e impiantit ishte papritur duke i shkaktuar dëmtime rrugeve të procesimit	100-250
<b>3.</b>	<b>Depozitat minerare të Plumbit dhe Zinkut (Trepça)</b>	<b>30</b>
<b>4.</b>	<b>Dyoksid Magnezi</b>	<b>N/A</b>

*Burimi:* Vlerësime të përafërta të Bankës Botërore.

4.38 **Nuk është zhvilluar ende nje qasje koherente për ripërtëritjen e sektorit dhe nuk janë vendosur ende politikat kyçe dhe legjislacioni për zhvillimin e tij.** Marrëveshjet e drejtimit për operacionet e minierave janë të ndara ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-së. Kjo po sjell strategji zhvillimi që janë në konflikt me njëra-tjetrën, duplikim të përpjekjeve, dhe paralizë vendimesh në çështje të rëndësishme sociale dhe mjedisore që kërcënojnë të ndalojnë përpjekjet për ripërtëritjen dhe privatizimin. Për sa i përket Njësisë Qëndrore Rregullatore (NjQR) – drejtoria e minierave po ndërmerr hapa për të hapur zyra të reja për (i) administrimin e titujve minerarë, (ii) monitorimin dhe raportimin e prodhimit të mineraleve, dhe (iii) mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit gjeologjik; Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë po duplikon disa detyra. Megjithëse Zyra e Energjisë ndodhet ndërmjet NjQR-së dhe KEK-ut ajo gjithashtu po has vështirësi në programe kryesore që kanë të bëjnë me sigurinë publike në zhvendosjen e rezidentëve që kërcënohen nga rrëshqitjet e tokës si pasojë e operacioneve për nxjerrjen e linjtit. Kundër këtij sfondi, në këtë vakum politik përpjekjet që kanë të bëjnë me privatizimin nuk mund të ndihmojnë por vihen në konflikt me një ose më shumë agjenci. Deri tani, progresi më i madh është arritur në programe që janë realizuar pjesë-pjesë dhe në disa raste pa miratimin e plotë dhe angazhimin buxhetor të autoriteteve. Në këto kohë po hartohet një ligj i ri për minierat dhe politikën e zhvillimit minerar, i cili do të sigurojë hapësirën e duhur për investitorët që të vazhdojnë nxjerrjen e mineraleve në Kosovë, por reforma administrative është tepër e nevojshme.

4.39 **Meqënëse shumica e sektorit përbëhet nga ish NPSH, asetet mbahen në administrim nga AKM, dhe janë paracaktuar për privatizim, por që është shtyrë deri më sot.** (Lexoni kapitullin 3). Vazhdimi i programit të privatizimit në këtë fazë, sidomos pa zgjidhur çështjet e ngritura më sipër rrezikon të joshë spekulatorët të cilët

mund të mos kenë si synim të futin asetet përsëri në prodhim. Nje process i tillë shkakton risqe të rëndësishme dhe pasoja afatgjata ndaj ripërtëritjes së sektorit.

**4.40 Nëse e zëmë se korniza do te vendoset, ka gjithashtu faktorë socialë dhe mjedisore që nuk nxisin një ambjent mundësues nëse nuk zgjidhen dhe gjithashtu do të dekurajojnë investitorë privatë cilësorë.** Së pari autoritetet kanë nevojë të adresojnë ristrukturimin e punës në një numër operacionesh, sidomos Trepça dhe KEK. Çështjet e ristrukturimi të fuqisë punëtore janë më akute në Trepçë ku është gjithashtu i madh rreziku i trazirave sociale dhe mos-harmonisë etnike. Në kohën e tashme në Trepçë janë rreth 9500 persona të regjistruar si punonjes aktualë ose të mëparshëm. Ekziston një program i brendshëm për t'i siguruar paga dhe rroga të pjesëshme rreth 4000 prej tyre. Të gjitha pagesat janë vetëm një masë e përkohshme e futur nga Korriku 2003 deri në Qershor 2004. Operacionet e nxjerrjes së mineralit vlerësohet se janë të mbingarkuara me staf të tepërt, të paktën 50 përqind të 4,000 minatorëve të punësuar. Pas kësaj do të nevojitet një ristrukturim i mëtejshëm në linjë me përmirësimet teknologjike. Ekzistojnë komplikacione shtesë që kanë të bëjnë me nevojën për të zhvendosur një fshat pranë, i cili pengon rrugën e zhvillimit të mëtejshëm.<sup>56</sup>

**4.41 Janë disa çështje mjedisore të trashëguara, sidomos në Trepçë dhe minierat e linjtit.** Çështjet mjedisore në Trepçë kanë të bëjnë me (i) operacionet e nxjerrjes së mineralit dhe (ii) procesimin. Në anën e minierave ka depozita të mbetjeve të braktitura dhe ujra acide që rrjedhin prej tyre dhe vetë minierave. Në anën e procesimit impiantet u mbyllën për shkak të shqetësimeve mjedisore që kishin të bënin me ndotjen e tokës dhe ujit nga metalet e rënda. Në rastin e linjtit, ka rrjedhje atmosferike nga djegia e pakontrolluar e sasive të mëdha linjti në puse si dhe nga një grumbull flyash (mbetje nga djegia e linjtit) që nuk është trajtuar ashtu si duhet. Si përfundim, fundosja e tokës rreth puseve aktuale po shkaton rëshqitje të tokës dhe ndryshim të rrjedhës së ujrave nëntoksore. Propozimet e tanishme që investitorët e rinj të marrin përgjegjësi të plotë për çështjet mjedisore të trashëguara ka mundësi të shkurajojnë edhe më shumë investimet brenda tyre.

**4.42** Në rastin e gurëve të thërmuar dhe industrinë e materialeve të ndërtimit pengesat janë të njëjta me ato me të cilat përballen të gjitha NPSH-të. Në veçanti operatorët e licencuar përballen me konkurrencë të padrejtë të shkaktuar nga prodhimi joformal/paligjshëm i materialeve të ndërtimit.<sup>57</sup> Operimet kosovare të paliçencuara, të cilave u referohemi si operatorë “ilegalë”, janë të njëjta me nxjerrjen e mineraleve në mënyrë artizane në pjesë të tjera të botës.

---

<sup>56</sup> Miniera ka arritur kufinj të saj fizik të funksionimit nëse nuk zgjidhen problemet e mirëmbajtjes së prapambetur dhe heqjes së materialeve që e kanë mbingarkuar. Megjithatë heqja e materialeve që e kanë mbingarkuar kërkon zhvendosjen e fshatit pranë saj. Për më tepër pjerrësia e tanishme e puseve shkarkuese është shumë më e lartë se standartet e sigurisë në BE. Që të dy, fshati dhe minierat përballen me rrezikun e rrëshqitjeve të tjera të tokës të cilat mund të ndërpresin furnizimin me linjit dhe/ose të rrezikojnë jetën e banorëve. Deri sa të përfundojë zhvendosja minierat janë nën rrezikun e rrëshqitjeve të vazhdueshme të tokës që mund ta ndërpresin përkohësisht furnizimin me linjit. Termocentrali grumbullon linjit të mjaftueshëm për dy javë.

<sup>57</sup> Ky rezultat u nxorr nga intervistat me përfaqësuesit e industrisë, dhe mbështetet gjithashtu nga konkluzionet e Vlerësimit të Klimës Investuese të diskutuara në Kapitullin 2.

**4.43 Si përfundim, si një industri që përdor në mënyrë intensive energjinë, ripërtëritja e sektorit të minierave varet nga sigurimi i një furnizimi të besueshëm me energji elektirke.** Siç e kemi parë sektori tjetër nuk është në gjendje ta bëjë këtë. Mbeten për tu zhvilluar alternativat si ajo e lidhjes direkte me furnizues në shtetet fqinje që janë të lidhur me rrjetën e TJERE.

### **Rekomandimi i Politikave**

4.44 Si përfundim, Kosova ka depozita minerare ekonomike që edhe në periudhën afatshkurte i kanë mundësitë të zhvillojnë prespektivat e punësimit rajonal nëpërmjet zbatimit të strategjive të përkohëshme të rehabilitimit. Në periudhën afatmesme sektori mund të bëhet një motor i rritjes, subjekti i zbatimit të suksesshëm të strategjive të industrisë që kanë si synim të tërheqin investimet private për ta ripërtërirë sektorin.

4.45 Periudha e ndërmjetme siguron një dritare mundësie gjatë së cilës autoritetet duhet të:

- Të përmirësojnë koordinimin mes UNMIK-ut, IPVQ -së, dhe donatorëve dhe të përcaktojnë një vision të përbashkët për zhvillimin e sektorit mineral, ku politika duhet të integrohet me energjinë, mjedisin dhe strategjitë sociale.
- Të zhvillojnë rregulla dhe ligje të duhura për zhvillimin e mineraleve të cilat: japin siguri dhe një sistem licensimi për eksplorimin, zhvillimin dhe përdorimin e mineraleve. Ligjet duhet të theksojnë parësinë e sektorit privat si operator i minierave dhe rolin e shtetit si rregullator.
- Të themelojnë një zyrë kadastrale moderne, që të shërbejë për dhënien dhe regjistrimin e titujve mineralë.
- Të forcojë kapacitetin institucional dhe teknik për të menaxhuar zbatimin e kornizës rregullatore. Në veçanti të zgjidhë shqetësimet kritike sociale, mjedisore dhe të sigurisë siç janë çështjet e ristrukturimit të fuqisë punëtore në Trepçë dhe KEK dhe zhvendosja e fshatit pranë minierave të linjtit si dhe zbatimi i strategjive të rehabilitimit për të ripërtërirë operacionet e nxjerrjes së mineralit në Trepçë dhe KEK.
- Të vazhdohet me një strategji privatizimi të menaxhuar mirë dhe të kujdesshme duke i kushtuar kujdes të madh nevojës për të thithur në këtë sektor investitorë të rëndësishëm. Ferronikeli të konsiderohet si kandidat me prioritet.
- Nevojitet një përpjekje e përbashkët për të futur stimuj në mënyrë që operatorët joformalë që thërmojnë gurët të licencojnë aktivitetet e tyre, të paguajnë tatimet e përdorimit, dhe të jenë në përputhje me standartet mjedisore dhe standartet e tjera rregullatore.
- Do të duhet një analizë gjithëpërfshirëse e sektorit të materialeve të ndërtimit e cila do të mbushte boshllëqet në bazën e informacionit gjeologjik me krijimin e një harte të re gjeologjike të burimeve të materialeve të ndërtimit; dhe të zhvillohet sipas vendndodhjes, një inventar i cilësisë dhe të sasisë së prodhimit të materialeve të ndërtimit.

## D. SEKTORI BUJQËSOR

### E shkuara dhe Zhvillimet e Fundit


4.46 **Kosova është e begatë me tokë pjellore dhe klimë të butë që është e përshtatshme për prodhimin e kulturave bujqësore.** Megjithëse vuan nga madhësia e vogël e fermave, prodhueshmëria e ulët dhe mungesa e shërbimeve të këshillimit, përsëri bujqësia kontribuon me përafërsisht një të tretën e PBB-së (PBB) të Kosovës, punëson dy të tretat e popullsisë dhe siguron rreth 18 përqind të vlerës së eksporteve të përgjithshme. Shoku që iu shkaktua prodhimit të brendshëm nga konflikti rezultoi në mbështetjen mbi importet e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore, të cilët vazhdojnë t'i shkaktojnë konkurrencë të madhe prodhimeve vendase. Sektori bujqësor mund të jetë një burim potencial i rritjes për arsye të begatisë me tokë pjellore, dhe të numrit të madh të punëtorëve që punojnë në të. Megjithatë, prodhueshmëria, prodhimet, cilësia dhe besueshmëria e furnizimit janë vetëm disa nga çështjet që duhet të adresohen përpara se sektori të mund të konkurrojë me prodhimet që prodhohen në vendet fqinje. Këto janë shtjelluar tek seksioni pengesave ndaj rritjes. Më tej merren në konsideratë perspektivat që sektori të zhvillohet në periudhën afatmesme dhe kjo para se të jepen një seri rekomandimesh politike.

4.47 **Sektori vuajti shumë gjatë konfliktit sepse iu shkatërruan shumica e kapitalit, makinerive dhe gjësë së gjallë.** Rivitalizimi ka ndodhur si pasojë e hyrjes së remitançave dhe ndërhyrjeve urgjente të financuara nga donatorët për të ripërtërë inventarin e gjësë së gjallë, riparimin dhe sigurimin e makinerive të reja, dhe rindërtimin e kapacitetit të institucioneve bujqësore. Që atëhere, prodhimi bujqësor është rritur dhe sektori ka treguar shenja të ripërtëritjes dhe zgjerimit. Sidoqoftë, totali i tokës së mbjellë ka rënë me 7 përqind mes viteve 1998 dhe 2001, dhe numri i përgjithshëm i deleve dhe gjedhëve ka rënë me përafërsisht 53 dhe 65 përqind gjatë kësaj periudhe.

4.48 **Agrokombinatet që dominonin sektorin bujqësor para vitit 1999, janë shkatërruar.** Ato aplikonin teknika kapitali intensiv dhe prodhonin të mira materiale për tregun e IRF të Jugosllavisë. Ato gjithashtu ishin furnizuesit kryesorë me inpute bujqësore. Tani shumica e NPSH-ve janë shkatërruar dhe në shumë raste toka ka mbetur e pa punuar. Rreth 12 përqind e të gjithë tokës bujqësore (prej së cilës 75 përqind janë kullota ose tokë djerrë) është në pronësi të 23 agrokombinateve. Ato të cilat operojnë akoma, kanë pak punëtorë, u mungojnë fondet dhe pajisjet dhe po prodhojnë pa efektshmëri e me kapacitet të vogël. Asetet e një numri NPSH-s i janë dhënë me qera sektorit privat për një periudhë të caktuar, duke pritur një zgjidhje përfundimtare të privatizimit dhe ristrukturimit.

4.49 Pjesa më e madhe e tokës bujqësore dhe e bagëtive janë në pronësi të sektorit privat, përafërsisht 88 dhe 95 përqind respektivisht. Prodhimin bujqësor e dominojnë ferma të vogla me teknologji rudimentare prodhimi, të cilat prodhojnë kryesisht për konsum shtëpiak. Shtatëdhjetë përqind e familjeve kanë afërsisht nga 3.5 hektarë. Një pjesë tjetër prej 15 deri në 20 përqind janë ferma gjysëm-të komercializuara me rreth 5 hektarë; dhe rreth 10 përqind janë prodhues komercialë plotësisht të specializuar. Në Figurën 4.1 më poshtë tregohet modeli i tanishëm i prodhimeve bujqësore në Kosovë.

**Figura 4.1: Modeli i prodhimeve bujqësore në Kosovë, 2001**



Burimi: Statistikat rreth Bujqësisë në Kosovë, Enti Statistikor i Kosovës, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, MBPZHR, 2001

### Perspektiva në periudhën afatmesme

4.50 **Është e vështirë që Kosova të ketë ndonjëherë një avantazh krahasues në prodhimin e volumeve të mëdha dhe me vlerë të vogël të prodhimeve si puna e drithrave. Është më e mundur që duke patur parasysh sipërfaqet e vogla në pronësi, të jenë perimet, mishi dhe pularia ato që do të sigurojnë perspektivë rritjeje.** Megjithatë drithërat (gruri dhe misri) mbeten produktet bujqësore dominuese në Kosovë, prodhimi i përgjithshëm i tyre ka rënë që nga vitet 1990 (gruri u zvogëlua me 25 përqind mes vitit 1989 dhe 2001 dhe misri me 19 përqind nga mesi i viteve 1990 deri në vitin 2001), pjesërisht për shkak të humbjes së makinerive që i bënë jo ekonomike operacionet e tipit të fermave të gjëra. Aty ku kemi parë rritje në prodhimin e brendshëm si dhe eksporte në vendet e BE dhe tregjet rajonale, janë frutat, perimet, produktet shtazore dhe vera. Eksportet e perimeve kanë zënë afërsisht 64 përqind të eksporteve bujqësore dhe ushqimore dhe rreth 10.5 përqind të eksporteve të përgjithshme dhe ndër partnerët më të mëdhenj tregtarë përfshihen Shqipëria, Italia dhe Gjermania.

4.51 **Nxitja e sektorit agro-ushqimor është qasja më e mirë dhe më premtuese për zhvillimin e sektorit bujqësor privat, dhe kjo do të mbështetet së pari në përmirësimin e kushteve për fermerët gjysëm-komercialë dhe komercialë që merren me procese ekstraktuese apo prodhuese.** Gjatë dy viteve të fundit ka pasur një rritje në sektorin privat të aktivitetit të agro-përpunimit, kryesisht në: lëngun e frutave, pulari, mullinj dhe furra buke; thertore dhe punishte të vogla qumështi.<sup>58</sup> Perspektivat e sektorit bujqësor varen nga rritja në operacionet komerciale dhe gjysëm-komerciale dhe në agro-përpunimin apo sektorit agroushqimor.

<sup>58</sup>Janë afërsisht 1,350 biznese të regjistruara në sektorët e ushqimit, pijeve dhe duhanit.

4.52 Rritja e proceseve prodhuese mund të krijojë më shumë vende pune për fermerët në zinxhirin e furnizimit. Për t'u siguruar se fermerët do të përfshihen në zinxhirin e furnizimit duhet të sigurohet mundësitë e nevojshme për arsimim dhe shërbimet mbështetëse në mënyrë që të përmirësohet prodhueshmëria lokale. Shoqatat lokale gjithashtu do të nevojitet të jenë më të organizuara nëse duhet t'i përgjigjen këtyre rasteve. Një prodhues bujqësor me kohë të plotë mund të krijojë në mënyrë indirekte 3 - 4 vende punë të tjera, të cilat mund të rezultojnë në një shtesë prej 100,000 deri në 150,000 vende pune në total nëse do të ketë një përgjigje nga ana e ofertës së brendshme. Disa nënsektorë që tashmë tregojnë shënja rritjeje dhe avantazh potencial krahasues janë:

- Prodhimi i perimeve në veçanti i patateve,
- Prodhimi i mishit, dhe
- Sektori i pularisë dhe prodhimit të vezëve.

4.53 Megjithëse të pa provuar ende kërkimet e marketingut në prodhimin e frutave, vreshtari, bulmete/prodhime blektorale dhe prodhimet për tregjet e specializuara: mjalt, lule, kërpurdha, bimët mjeksore dhe aromatike/të kuzhinës, dhe djathi i deleve, tregojnë se mund të ketë gjithashtu potencial për eksport në këto nënsektorë.

### **Pengesat për Rritjen**

4.54 **Për momentin prodhueshmëria bujqësore është e ulët për shkak të fermave me madhësi të vogël, mungesës së ekspertizës teknike dhe përdorimit të keq të inputeve/fondeve.** Duke u përballur me nevojën për të patur fonde për të rifurnizuar fermat e tyre, shumë fermerë reduktuan përdorimin e inputeve. Në rastin e fermave blektorale, ushqimi me cilësi të ulët rezulton me prodhimtari të ulët gjatë muajve të dimrit. Ka pasur një farë përtëritjeje në prodhimin e drithrave dhe prodhimtaria megjithëse e ulët është përmirësuar me 3 ton/ha. Madhësia e vogël e fermave do të thotë se fermerët nuk mund të përfitojnë nga ekonomitë në shkallë të gjërë psh., në përdorimin e mekanizimit. Kjo sidomos në rastin e drithërave me vlerë të shtuar të ulët, por është gjithashtu një pengesë në rritjen e shkallës së prodhimit të drithrave dhe frutave. Në shumë raste janë të kufizuara edhe njohuritë bazë të prodhimit, dhe një pengesë kryesore në prodhimet bujqësore është qasja te ekspertiza teknike dhe aftësitë e marketingut që nevojiten për të prodhuar prodhime me cilësi të lartë të cilat mund të konkurrojnë në tregje eksporti. Për shembull, u zbulua se prodhuesit blektoralë kishin njohuri të pakta të kërkesave të ushqimit me kosto të pakët dhe nevojat veterinarë që rezultojnë në një prodhueshmëri prej 1500 litra për lopë në vit.

4.55 **NPSH-të nuk po luajnë më një rol kryesor në sigurimin e pikave të grumbullimit, informacione mbi çmimet, standartet e kontrollit të cilësisë, dhe inputet bujqësore, vakum i cili po mbushet vetëm gradualisht nga sektori privat.** Kohët e fundit janë formuar shoqata të prodhuesve, përpunuesve dhe shitësve, shumë prej të cilave me ndihmën financiare të donatorëve dhe pak prej tyre nga nevojat e tregut brenda një aktiviteti të veçantë. Shumë pak shoqata kanë qënë të suksesshme në sigurimin e asistencës në formën e prokurimit të inputeve, asistencës në prodhim, qasja te kreditë, marketingu i prodhimeve, trainingu dhe aktivitete të tjera. Një anketim i kohëve të fundit tregoi se gati gjysma e fermerëve nuk kishin marrë ndonjëherë shërbime këshillimi të ndonjë forme. Me një organizim më të madh në sektor, prodhuesit ndajnë

mes tyre kostot fikse të marrjes së informacioneve teknike dhe të çmimit më të mirë. Me informacione të pamjaftueshme se si të përmirësohet vazhdueshmëria e furnizimit dhe cilësia e prodhimeve, shumica e fermerëve mbeten në bujqësinë si mjet jetese.

**4.56 Importet bujqësore që përfitojnë subvencione në prodhim dhe eksport i vënë fermerët Kosovarë në një fushë loje të pabarabartë.** Tabela 4.3 më poshtë tregon vlerën e importeve bujqësore nga rajoni. Në shumë prej vendeve prej nga është origjina e mallit jepen subvencione prodhimi dhe subvencione eksporti. Për shembull në rastin e qumështit në Mal të Zi, Slloveni dhe Serbi jepen respektivisht subvencione prej 8.5, 6.6 dhe 6.0 cent për litër. Subvencionet bujqësore në vendet fqinje bëjnë të mundur që në Kosovë të futen prodhime me cilësi më të lartë e me çmim të ulët.

**Tabela 4.3: Importet e Kosovës sipas Llojit dhe Vendit të Origjinës (në milion €)**

Importet	2002	2003 <sup>3</sup>	Burimi
<b>Bujqësia &amp; Prodhimet ushqimore</b>	<b>97.76</b>	<b>86.58</b>	
Kafshët e gjalla; Prodhimet me origjinë shtazore	20.06	16.39	Austri, Bullgaria, IRJM (IRJOM), Gjermani, Greqi, Hungari, Poloni, Slloveni, Serbi, USA
Produktet bimore	11.51	13.25	Ekuador, IRJM, Greqi, Itali, Serbi, Sri Lanka, Turqi
Yndyrat dhe vajrat Shtazore ose Bimore dhe produktet e dala prej tyre; Yndyrat e ngrënshme të përgatitura; Parafinat Shtazore ose Bimore	2.85	2.92	Bullgari, IJRM, Greqi, Serbi
Artikuj ushqimorë të përgatitur, Pije joalkolike, Pije alkolike dhe Uthull, Duhan dhe Zëvendësues të Duhanit të Përpunuar	63.34	54.02	Austri, Kroaci, IJRM, Greqi, Serbi, Slloveni, Turqi
<b>Importet Jo bujqësore dhe Jo ushqimore</b>	<b>234.96</b>	<b>182.43</b>	
<b>Totali</b>	<b>332.72</b>	<b>269.01</b>	

*Shënim 1/ Të dhëna deri në çerekun e tretë të vitit 2003.*

*Burimi: : Databaza e Statistikave Bujqësore, MBPZHR, Administrata Doganore e UNMIK-ut*

**4.57 Kosova nuk është në gjëndje të përmbushë kërkesat e sigurimit, shëndetësore, fotosanitare e të tjera për prodhimet ushqimore.** Kërkesat bazë janë vendosur por rëndësi në rritje kanë kërkesat e blerësve privatë të cilat zakonisht janë më të mëdha se standardet e sigurimit publik, dhe përfshijnë specifikime shtesë që kanë të bëjnë me cilësinë, paketimin, sasinë dhe besueshmërinë e dorëzimit. Standartet e sektorit privat janë pjesë e strategjisë konkurruese të pjesëmarrësve kryesorë në treg, gjë që e rrit diferencimin e produkteve. Arritja e këtyre standarteve mbetet një sfidë.

**4.58 Megjithese kreditimi është rritur në mënyrë të konsiderueshme, ai për sektorin bujqësor ishte vetëm 2 përqind e kredive të përgjithshme të dhëna nga bankat komerciale në vitin 2002.** Problemi kryesor ishte mungesa e cilësisë së projekteve të investimeve dhe rreziqet që kishin të bënin me huadhënien në sektorin bujqësor. Për më tepër ofrohet vetëm një sasi e kufizuar produktesh financiare dhe pak

prej tyre janë të hartuar për nevojat e kreditim të ndërmarrjeve bujqësore. Kreditimi është i shtrirë ose në formën e kredive të mëdha për prodhuesit e mëdhenj ose në kredi shumë të vogla afatshkurta mikro-financiare me interes të lartë për aktivitetet stinore. Pjesa më e lartë e tregut ka më shumë mundësi të marrë kredi për firma më të mëdha agro-përpunuese.

4.59 Si përfundim, sektori bujqësor vuan edhe të gjithë problemet e referuara në pjesë të tjera të raportit, siç janë vështirësitë në thithjen e IHD-ve, stastusi i paqartë i NPSH-ve dhe pengesat që ndihen nga sektori i NVM-ve. Në veçanti, kostoja e prodhimit rritet, nga rehabilitimi i papërfunduar i rrugëve rurale, rrjetit të kullimit dhe sektori elektrik në rastin e agro-përpunuesve. Për më tepër çështjet e pazgjidhura të administrimit të tokave dhe pronësisë pengojnë vendimet e fermerëve për investime, kufizojnë tregun e tokave, dhe krijojnë probleme në marrjen e kredive.

### **Rekomandimi i Politikave**

- Nevojitet transferimi i njohurive teknologjike për të përmirësuar prodhueshmërinë, kapacitetin e prodhimit dhe për të rritur aftësinë konkurruese të prodhuesve vendas dhe firmave agro-përpunuese. Sektori publik duhet të shmanget nga fillimi i një shërbimi universal të mundësive për arsimim për të gjithë fermerët. Në vend të saj, fokusi duhet të përqëndrohet në lehtësimin e futjes së agro-përpunuesve të huaj të cilët në mënyrë tipike japin informacione me vlerë, në përgjigje të nevojave për informacion që kërkohen nga sektori komercial i fermave.
- Të përmirësohet kapaciteti për të adresuar sigurinë e ushqimeve dhe shqetësimet për standartet duke siguruar se janë vendosur dhe po zbatohen rregullat e duhura, duke përfshirë Ligjin Veterinar, Ligjin për Farat, dhe Ligjin për Mbrojtjen e Bimëve.
- Të përfshihen masa speciale për ruajtjen e kulturave bujqësore në marrëveshjet tregtare dhe Kodin e Doganave për të adresuar rastet e konkurrencës së paligjshme nga importet bujqësore. Këto duhet të jenë masa disiplinuese të kufizuara në kohë, e të njëjta më ato që janë nënvizuar në Marrëveshjen për Bujqësinë të OBT-së (WTO).
- Rehabilitimi i plotë dhe zgjatja e mundshme e infrastrukturës rurale që përfshin rrugët rurale, kullimin dhe sektorin energjitik.
- Nevojitet zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të administrimit të tokave duke mbështetur krijimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë, programet e titullimit dhe regjistrimit, mekanizmat për transferimin e të drejtave të pronësisë, zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe mbledhjen e të ardhurave.

### **E. PËRFUNDIMET PËR SEKTORËT**

4.60 Si përfundim ka një numër pengesash me të cilat përballen që të tre sektorët ekonomikë. Megjithëse ka perspektiva për ripërtëritje dhe rritje të drejtuar nga eksportet do të nevojitet një proces thelbësor rehabilitimi, reforma si dhe një klimë e jashtme e favorshme. Në sektorin e energjisë dhe minierave mund të parashikohen me kalimin e kohës fitime substanciale nga eksporti, megjithatë duke patur parasysh investimet e

konsiderueshme që nevojiten, ka shumë mundësi që më parë të kërkohet siguria e aseteve dhe stabiliteti politik. Në sektorin bujqësor ka tashmë shenja ripërtëritjeje me një rritje të prodhimit dhe të aktivitetit agro-përpunues. Formimi i ndërmarrjeve të përbashkëta dhe lidhjeve me firma të huaja do t'i maksimalizojë mundësitë për përtëritje teknike që janë të nevojshme për t'i bërë prodhuesit Kosovarë më produktivë dhe konkurrues në rajon.

## 5. NDIKIMI I TREGUT TË PUNËS

### A. HYRJA

5.1 **Me gjithë mjedisin relativisht të favorshëm të tregtisë dhe biznesit, anketimet zyrtare tregojnë nivele insistuese të larta papunësie në Kosovë.** Anketimet e Fuqisë Punëtore (AFP) të viteve 2001 dhe 2002 tregojnë se gjatë këtyre viteve afërsisht pesëdhjetë përqind e fuqisë punëtore ishte e papunë.<sup>59</sup> Këto nivele të larta nuk janë një fenomen i ri: niveli i papunësisë është vlerësuar të ketë qënë 36 përqind në 1990 dhe 68 përqind në fund të dhjetëvjeçarit. Përsëri, nivelet janë të larta në krahasim me vendet e tjera të Europës Juglindore, pavarësisht një niveli relativisht të ulët taksash mbi pagat dhe një tregu fleksibël të fuqisë punëtore. Punësimi sezonal në sektorin e bujqësisë dhe tregu informal e zbut ndikimin e papunësisë formale, dhe për shumë familje dërgimi i parave (remitancat) nga anëtarë të familjes e lehtëson ndikimin mbi të ardhurat.

5.2 Analiza e mëposhtme zbulon se po të merret në konsideratë puna sezonale dhe joformale zbulojmë se nivelet zyrtare do të uleshin në një papunësi të vlerësuar sezonale ndërmjet 23 dhe 33 përqind.<sup>60</sup> Mbizotëron papunësia afatgjatë, dhe të papunët janë kryesisht femra, të rinj dhe njerëz më pak të shkolluar. Papunësia nuk është ende për shkak të ristrukturimit të fuqisë punëtore por për arsye të kërkesës së pamjaftueshme në sektorin formal. Në pjesën e dytë të këtij kapitulli ne analizojmë institucionet e tregut të fuqisë punëtore dhe të kornizës ligjore për të vlerësuar fleksibilitetin e tregut të fuqisë punëtore, përpara se të shohim më të detajuar çështjen e papunësisë së të rinjëve dhe nxjerrjen në seksionin final të disa përfundimeve dhe rekomandimeve të politikave.<sup>61</sup> Mesazhi kryesor është se tregu i punës konsiderohet të jetë relativisht fleksibël dhe politikat duhet të përqëndrohen në gjenerimin e rritjes dhe krijimin e vendeve të punës sesa në politikat e tregut aktiv të punës që ka pak mundësi të kenë një efekt pozitiv nëse nuk ka rritje të prodhimit.

---

<sup>59</sup> Mungesa e të dhënave të përhapura në kohë kufizon qartësisht analizën, e veçantërisht mungesa e të dhënave administrative e të anketimeve mbi punësimin dhe pagat gjatë viteve 1990-1999. Anketimet e Fuqisë Punëtore të viteve 2001 dhe 2002 përfaqësojnë vëzhgimin më të mirë në funksionimin e tregut të punës dhe dimensionet e papunësisë. Ato janë burimi kryesor i përdorur në këtë kapitull.

<sup>60</sup> Bazuar në krahasimin e të dhënave, Anketimi për Matjen e Standardeve të Jetesës (SMSJ), Anketimi i RIINVEST për vitin 2000, dhe Studimi i Bankës Botërore për Tregun Informal i vitit 2003, i zhvilluar nga Prism Research.

<sup>61</sup> Për një analizë shtesë të tregut të punës në Kosovë shiko Banka Botërore (2003b).

## B. REZULATATET E TREGUT TË PUNËS

### **Papunësia e Lartë, Aftgjatë Vazhdon Pavarësisht se ka Rritje të Mundësive të Punësimit.**

5.3 **Ka patur një rritje të punësimit formal që nga fundi i konfliktit përtej niveleve në fund të viteve 1980.** Punësimi jo-sezonal i matur nga AFP-ja e vitit 2002 ishte rreth 255,000 punëtorë krahasuar me 243,000 në vitin 1989. Afërsisht 50 përqind e këtyre punëve janë në sektorin publik. Shumica e atyre të punësuar në sektorin privat janë të punësuar në ndërmarrje të vogla dhe të mesme: 91 përqind punojnë në firma me nëntë ose më pak punëtorë, dhe 64 përqind janë në sektorin bujqësor.

5.4 **Në të njëjtën kohë papunësia ka mbetur e lartë edhe sipas standarteve rajonale.** Të papunët e regjistruar janë 258,000. Nga AFP-të niveli i papunësisë duke përdorur përkufizimin standard të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) ishte 47 përqind në 2002, gati pesëdhjetë përqind më i lartë se niveli i Maqedonisë dhe shumë më i lartë se ai i vendeve të tjera të Ballkanit.<sup>62</sup>


5.5 Në Kosovë është veçantërisht e vështirë të matet papunësia. Një anketim i aktiviteteve të sektorit joformal në Kosovë tregoi se Kosovarët mendojnë për punën si një punësim esencialisht formal (p.sh., me një pagë të qëndrueshme dhe të sigurtë). Si rezultat, shumë prej tyre nuk e konsiderojnë veten “në punë” megjithëse ata do të ishin llogaritur si të punësuar sipas analizave standarte të tregut të punës. Afërsisht gjysma e atyre që morën pjesë në anketim punonin në sektorin jo-formal sipas dy kritereve të informalitetit, (i) nëse kishin një kontratë të nënshkruar dhe (ii) nëse ndërmarrja ishte e regjistruar. Ata merreshin me një sërë aktiviteteve joformale ku më e zakonshme ishte mbjellja e drithrave në kopshte ose ngastra private dhe rreth një e treta e punëve joformale ishin në një ndërmarrje të vogël të pa regjistruar. Kjo mund edhe të tregojë që afërsisht një numër i njëjtë punojnë në punë jo formale, ndërkohë që janë të punësuar formalisht.

5.6 Siç mund të pritet papunësia është tepër sezonale në Kosovë, duke patur parasysh mbizotërimin e sektorit bujqësor në punësim. Diagrami 5.1 krahason rezultatet e Anketimit për Matjen e Standartit të Jetesës (SMSJ) të qershorit të vitit 2000 me të dhënat e AFP-së të dimrit të viteve 2001 dhe 2002. Një krahasim i niveleve të papunësisë rurale gjatë qershorit dhe dhjetorit tregon se në muajt e verës papunësia mund të zbrësë deri në 10 përqind, ndërkohë që në dimër rritet mes 40 dhe 50 përqind. Një pjesë e kësaj difference mund të jetë për shkak të metodave të ndryshme që janë përdorur për anketimin, por në zonat urbane ka një diferencë shumë më të vogël ndërmjet niveleve të papunësisë të matura nga tre anketimet. (Megjithatë papunësia në vitet 2001 dhe 2002 është përsëri më e lartë)

---

<sup>62</sup> Nivelet e papunësisë së AFP-së u korrigjuan për të mos llogaritur si të papunë ata persona për të cilët mënyra e vetme për të kërkuar punë konsistonte në “të qenit i regjistruar në zyrat e punësimit”. Përkufizimi i të papunit që është përdorur është: ai/ajo është në moshë për punë, i /e papunë, duke kërkuar punë gjatë katër javëve të fundit dhe i gatshëm për punë.

**Grafiku 5.1: Nivelet e Papunësisë Rurale dhe Urbane, 2000 - 2002**



Burimi: SMSJ Qershor 2000, SPF Nëntor/Dhjetor 2001 dhe 2002.


**5.7 Vlerësimet e Bankës Botërore të korrigjuara me sezonalitetin dhe masën e informalitetit rezultojnë në nivele alternative papunësie mes 23 dhe 33 përqind në vitin 2002.** U nxorën vlerësime alternative të korrigjuara për faktin se të dhënat e SPF-së raportojnë papunësinë në kulmin sezonal, dhe së dyti duke përdorur rezultate nga studimi joformal që tregon përgjigje të korrigjuara për ata që punojnë në sektorin joformal e që (i) mund të mos jenë përfshirë si pjesmarrës në fuqinë punëtore dhe (ii) nëse janë përfshirë në fuqinë punëtore janë klasifikuar si të papunë.

### Popullsia me Moshë të Re dhe Pjesëmarrja e Ulët ne Fuqinë Punëtore

**5.8** Popullsia e Kosovës është një nga më të rejtat në Europë: një e treta është nën 15 vjeç, dhe rreth gjysma është nën 24 vjeç. Vetëm rreth 6 përqind e popullsisë janë më të vjetër se 65 vjeç. Shtimi i madh i popullsisë pas Luftës së Parë Botërore u ndal në vitet 1990. Tensionet etnike dhe politike në rajon sollën një rënie të pjellshmërisë, vdekshmëri në rritje dhe detyruan shumë individë të emigronin. Megjithatë niveli natyror i rritjes besohet të jetë një nga më të lartët në Europë dhe për këtë arsye shtimi i ulët i popullsisë në vitet 1990s mund të ketë qënë nje fenomen i përkohshëm.

**5.9** Nivelet e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore janë tepër të ulta, edhe sipas standarteve rajonale. Në vitin 2002, niveli vlerësohet të ketë qënë 41 përqind, dhe vetëm 27 përqind për femrat. Duke u bazuar në të dhënat e AFP-së nivelet e pjesëmarrjes janë gjithashtu më të vogla në hapësirat urbane.

**Kutia 5.1: Statusi i fuqisë punëtore të rregjistruar si e papunë, 2002**



Edukimi është një tregues i rëndësishëm i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, s'është për t'u habitur, mundësitë e pjesëmarrjes rriten me të gjitha nivelet e edukimit.

5.10 Analiza e rezultateve të AFP-së lejon një zbërthim të papunësisë së regjistruar dukë nxjerrë në pah se në vitin 2002 vetëm rreth 29 përqind e atyre të regjistruar si të papunë ishin në të vërtetë të papunë sipas përkufizimit të ONP-së. Ka stimuj që shtyjnë drejt regjistrimit edhe nëse punon jo formalisht, meqë hyrja në asistencën shoqërore kërkon që përfituesit të jenë të regjistruar në një zyrë punësimi. Anasjelltas, rreth 154,000 vetë do të konsideroheshin të papunë sipas përkufizimit të ONP-së, por që u zbulua se nuk i ishin drejtuar zyrave të punësimit për t'u regjistruar si të papunë. Shikoni Kutinë 5.1.

5.11 Ne zbuluam se numri i punëtorëve të dekurajuar është më shumë se përgjysmuar nga 18,000 në vitin 2001 në 7,000 në vitin 2002. Punëtorët e dekurajuar janë ata që (i) nuk janë të punësuar, (ii) janë në dispozicion (të aftë dhe gati) për punë, (iii) donin të punonin, por (iv) nuk po kërkonin punë sepse besonin se nuk kishte punë të përshtatshme për ta. Fakti që gjatë kësaj periudhe numri i të papunëve u rrit nga 159,000 në 228,000, tregon se punëtorët e dekurajuar janë kthyer thjesht në të papunë.

**Tabela 5.1: Karakteristikat e Tregut të Punës, 2002**

	2002
Niveli i papunësisë (në %)	47.2
Meshkuj	36.9
Femra	68.9
Të moshës 15-19 vjeç	79.4
Të moshës 20-24 vjeç	69.0
Papunësia ndër të Rinjtë (si pjesë e totalit të papunëve)	40.6
Papunësia afatgjatë (si pjesë e totalit të papunëve)	73.1
Niveli i pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (në %)	41.3
Meshkuj	55.5
Femra	26.9

*Shënime:* Papunësia afatgjatë është për më shumë se 1 vit.

Burimi: Vlerësimet e Bankës Botërore bazuar në AFP-në, 2002 .

### **Papunësia Afatgjatë, Femrat Dhe Të Rinjtë Janë Në Mënyrë Disproporcionale Lart Në Mes Të Papunëve**

5.12 Siç tregon Tabela 5.1 papunësia afatgjatë përbën shumicën e papunësisë: të dhënat e AFP-së tregojnë se 73 përqind kanë më shumë se një vit pa punë. Prej të papunëve 47 përqind kanë mes dy dhe katër vjet pa punë dhe 25 përqind të tjerë kanë më shumë se katër vjet pa punë. Të dhënat nga viti 2001, tregojnë se prej atyre që kanë histori të mëparshme pune, 36 përqind kanë qënë të punësuar për herë të fundit para vitit 1999. Meqe pespektivat për të gjetur punë në përgjithësi duket se zvoglohen me zgjatjen

e kohëzgjatjes së papunësisë, nxjerrja e kësaj kategorie me lëvizshmëri të ulët nga papunësia është një objekt shqetësimi për politikën qeveritare.

5.13 Ka një nivel tepër të lartë papunësie mes femrave: gati 70 përqind e femrave ishin të papuna në vitin 2002. Niveli është edhe më keq për femrat e reja: mes grupmoshës 15 deri 24 vjeç është gati 95 përqind në zonat urbane. Në përgjithsi papunësia e të rinjve është një karakteristikë e veçantë e tregut të punës. Gati 41 përqind e të papunëve në Kosovë janë mes moshës 15 and 24 (meshkuj dhe femra) dhe 88 përqind janë kërkues pune për herë të parë. Niveli i papunësisë së të rinjve është afërsisht sa dyfishi i nivelit të papunësisë së të rriturve.<sup>63</sup>

5.14 Sa më i lartë të jetë niveli i shkollimit të punëtorëve aq më i lartë është niveli i punësimit të tyre dhe aq më i vogël është niveli i papunësisë. Nivelet e papunësisë janë respektivisht 66 dhe 64 përqind për ata me shkollim të përfunduar ose fillor. Pas çdo niveli shkollimi të përfunduar, bien mesatarisht edhe nivelet e papunësisë. Mes atyre me shkollim të mesëm ose universitar nivelet e papunësisë janë shumë të ulta, respektivisht 33 përqind dhe 10 përqind. Megjithëse në qendrat urbane ka një nivel më të ulët punësimi mes atyre me shkollë të pa përfunduar (50 përqind) në krahasim me ta që kanë shkollim fillor (62 përqind).

5.15 Sidoqoftë mundësia e papunësisë është në një farë mënyre më e lartë me 6 pikë përqindjeje për minoritetet jo-Serbe në zonat urbane dhe me 8 pikë përqindjeje për Serbët, në zonat rurale. **Statistikisht nuk ka ndryshime të rëndësishme të mundësisë së punësimit ndërmjet grupeve etnike.**

### **Ristrukturimi i tregut të punës**

5.16 **Pushimet nga puna përbëjnë vetëm dy përqind të të papunëve, kështu që kjo papunësi nuk është për shkak të ristrukturimit të NPSH-ve.** Në Kosovë ku sektori i ndërmarrjeve publike ka qënë në rënie të paktën gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, problemet e ristrukturimit të fuqisë punëtore nuk janë të së njëjtës magnitudë si eksperiencat në vende të tjera të Europës Lindore dhe ish Bashkimit Sovietik. Megjithatë, vonesat e ristrukturimit të NPSH-ve dhe NPP-ve do të thotë se mbesin për tu adresuar çështjet e punëtorëve të tepërt në shumë prej tyre. Siç do të shohim në kapitullin e ardhshëm stafi i tepërt në KEK dhe nevoja për të adresuar punëtorët e tepërt që janë ende në regjistrat e minierës së plumb/zinkut janë shqetësuese për rivitalizimin e sektorëve energjitik dhe të minierave.

### **C. INSTITUCIONET E TREGUT TË PUNËS**


5.17 Një treg pune që funksionon mirë mund të ndihmojë në qënien të sigurtë se rritja hap vende të reja pune, se punëtorët janë vendosur në punë ku aftësitë e tyre do të mund të përdoren në mënyrë më produktive dhe se janë dhënë shenja të sakta për investime në kapitale njerëzore. Institucione tregut të punës kanë për të luajtur një rol në lehtësimin e lëvizshmërisë së punës duke siguruar informacione të tregut të punës për t'iu adresuar friksioneve në treg dhe për të siguruar informacione për ofruesit e trajnimeve rreth mospërputhjes së aftësive.

<sup>63</sup> Të dhënat janë nga AFP-ja e vitit 2001, lexoni Kolev and Sagent (2003)

5.18 Që në vitin 1999, legjislacioni i mëparshëm i tregut të punës u hoq nga përdorimi dhe tregu i punës ka funksionuar në një mënyrë virtualisht pa rregulla, me pak marrëveshje formale që rregullonin marrëdhëniet e punësimit dhe përcaktimin e pagave. Mbi të gjitha, Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe marrëveshjet kolektive nuk kanë më fuqi. Politikat e tregut të punës në Kosovë janë në përgjithësi në rrugë të mbarë që të sigurojnë fleksibilitetin që karakterizon tregjet e punës që funksionojnë mirë në ekonomitë e tregut. Në veçanti niveli i ulët i taksave mbi pagat është shumë i rëndësishëm për ta mbajtur të ulët koston e punës.

5.19 Meqenëse Kosova ka operuar me rregulla tepër të pakta të tregut të punës, dhe në mungesë të një kornize kolektive diskutimi, pagat varen së tepërmi nga tregu. Paga mesatare mujore arrinte në rreth €197 euro. Në 2002-shin, pagat e sektorit privat i kaluan ato të sektorit publik me mesatarisht 16 përqind, si dhe treguan një shkallë më të lartë dispersioni. Vini re se të dhënat janë marrë përpara rritjes prej 20 përqind të pagave që iu dha disa punonjësve të sektorit publik në mes të vitit 2003 dhe rritjes me 5 përqind të buxhetura në 2004. Skema 5.2 tregon shpërndarjen e pagave mujore neto.

Grafiku 5.2: Shpërndarja e Pagave Mujore Neto Sipas Sektorit Publik and Privat, 2002



Burimi: Banka Botërore (2003b)

5.20 Pagat e meshkujve ishin mesatarisht rreth 10 përqind më të larta se ato të femrave dhe ndryshimi është më i madh në sektorin privat. Megjithatë po të mbahen konstante karakteristikat individuale, diferenca në përgjithësi është shumë më e vogël, dhe statistikisht e parëndësishme në sektorin publik. Në mënyrë të ngjashme, ndryshimi i të ardhurave mes shqiptarëve dhe serbëve është i parëndësishme në sektorin publik, ndonëse në sektorin privat serbët fitojnë 36 përqind më pak se Shqiptarët. Kjo mund të jetë si rezultat i vështirësive në gjetjen e punëve dhe rasteve të përshtatshme, gjë që rezulton me pranimin e pagave më të ulta. Ka përfitime pozitive nga shkollimi në të dy sektorët, atë publik dhe atë privat. Megjithatë këto përfitime janë të vogla sipas standarteve ndërkombëtare dhe është i nevojshëm hetimi i mëtejshëm për arsyet.

5.21 **Ndërkohë që standartet duhet të rriten bashkë me zhvillimin, “më tepër se ç’duhet dhe më herët se ç’duhet” mund të minojë avantazhin krahasues të Kosovës si një ekonomi me fuqi punëtore të bollshme e me kosto relativisht të ulët.** Me të vërtetë, rreziku i varfërisë së të ardhurave është shumë më i vogël për ata që janë të punësuar dhe më i lartë për ata që janë të papunë në krahasim me rrezikun mesatar të popullsisë. Rreziku i varfërisë së të ardhurave rritet tepër tek ata që janë të papunë prej më shumë se 2 vjetësh, dhe për familjet ku nuk punon asnjëri prej anëtarëve. Prandaj shqetësimi kryesor duhet të jetë krijimi i vendeve të reja të punës.

5.22 Për të siguruar të drejtat e punëtorëve u vendos një Kod Pune bazë (“Ligji Thelbësor i Punës në Kosovë”, Rregullorja Nr.2001/27) në vitin 2001. Kodi i punës siguron një regjim rregullator fleksibël. Është i duhur për momentin e tanishëm kur ekziston një sektor i gjërë informal dhe NVM. Eksperienca tregon se ekziston një kompromis i qenësishëm ndërmjet rritjes së standarteve dhe sigurisë dhe mbajtjes poshtë të kostove të punës në mënyrë që të favorizohet shpërthimi intensiv i punësimit. Me zhvillimin e tregut do të nevojitet një kod disi më i përpunuar, duke patur parasysh në veçanti kushtet e punësimit dhe të punës, duke përfshirë punën e përkohshme dhe me orar të shkurtuar, kërkesat për paralajmërim dhe dispozitat e pushimit të padrejtë nga puna. Dispozitat për punën e përkohshme dhe me orar të shkurtuar janë elemente të rëndësishme në rritjen e fleksibilitetit të tregut të punës dhe mundësitë e punësimit të cilat shkojnë bashkë me rritjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore.

5.23 Nën Ministrinë e Punës dhe Mirëqënies Sociale, janë hapur zyra punësimi rajonale dhe komunale në të tëra rajonet. Gjithashtu nën përgjegjësinë e Ministrisë janë edhe tetë Qendra të Aftësimi/Trajnimit Profesional, të cilat identifikojnë nevojat e trajnimit dhe sigurojnë trajnim për të papunët e regjistruar.

5.24 Janë futur dy programe të mbështetjes së të ardhurave që kanë një peshë të madhe në tregun e punës: një skemë e re pensionesh dhe një program asistence sociale që drejtohet ndaj të varfërve. Këto janë programet kryesore që janë vendosur për transferimin e të ardhurave. Ndërkohë që ato përfaqësojnë një rrjetë mbrojtëse për të varfërit, nuk ka skema që të drejtohen vecantërisht ndaj punëtorëve të papunë. Është venë një taksë modeste mbi pagat për të financuar një skemë të themeluar pensionesh.<sup>64</sup> Bërësit e politikave duhet të jenë të kujdesshëm në rritjen më tepër seç duhet, të taksave mbi pagën si mënyrë për të financuar programe të tjera mbrojtëse: taksat e ulëta mbi pagat janë një karakteristikë pozitive për tregun e punës në Kosovë që i mban të ulëta kostot e punës, veçanërisht në krahasim me fqinjët. Përsëri një rol të rëndësishëm në rritjen e efektshmërisë së tregut të punës dhe hartimin e një skeme të mirë të mirëqënies së punëtorit do të luanin, programe mbrojtëse të shtrira në kohë që fokusohen në tregun e punës, që do të thjeshtonin procesin e kërkimit të punës dhe tranzicionin nga një punë në tjetrën, duke shërbyer si përcjellës për një alokim më të mirë të resurseve, fitime të shtuara dhe punësim më të madh.

---

<sup>64</sup> Në mënyrë treguese, nëse supozojmë se kemi një elasticitet të pagës së kërkesës për punë prej - 0.5, që është në shkallën më të ulët për vendet e OBZHE, një rritje prej 10 përqindësh e tatimit mbi pagat do t'i rriste pagat bruto me rreth 4 përqind dhe do sillte një ulje prej së paku 2 përqind të punësimit formal. Ulja e tatimit mbi pagat do të kishte edhe një ndikim financiar prej -0.5, atëherë rritja prej 10 përqind e tatimit në paga do të sillte një rritje prej 8 përqind të të ardhurave.

## D. TË RINJTË, AFTËSITË, DHE MUNDËSITË E PUNËSIMIT

5.25 **Ashtu si në vendet e tjera të Evropës Juglindore edhe Kosova përballet me nivel të lartë papunësie mes të rinjve.** Në fakt raporti i niveleve të papunësisë së të rinjve ndaj të rriturve në shumë vende fqinje është edhe më i lartë se në Kosovë, duke levizur nga 2.2 (IRJ e Maqedonisë) në 3.9 (Rumania). Qartësisht një nga kushtet e nevojshme për të përmirësuar mundësitë e punësimit për të rinjtë është një rritje e prodhimit dhe kërkesës totale. Megjithatë, duke patur parasysh që nivelet e papunësisë të të rinjtë janë shumë më të larta se ato të të rriturve, ne analizojmë në këtë seksion nëse ata kanë përpara ndonjë pengesë tjetër nga ana e ofertës ose barrierë ndaj gjetjes me sukses të vendeve të punës.

5.26 Në analizimin nëse të rinjtë përballen me pengesa të veçanta, ne marrim në konsideratë mundësitë e mëposhtme: (i) aftësitë e tyre nuk janë ato të duhurat për tregun e punës dhe (ii) të rinjtë përballen me barrierë të veçanta për t'u futur në sektorin e NVM-ve ku janë krijuar më shumë vende pune.

5.27 Në vitet 1991-92 shumica e Shqiptarëve etnikë u larguan nga sistemi formal i arsimit për arsye të politikave të vendosura nga Beogradi dhe u futën në atë që njihet si sistemi paralel. Në vitin 1999 konflikti solli zhvendosje edhe të mëtejshme, mbyllje të shumta dhe dëmtime të përhapura të objekteve shkollore. Që atëherë, nën administrimin e UNMIK-ut dhe IPVQ-së, shkollat janë riparuar dhe fëmijët janë inkurajuar të kthehen përsëri në sistemin formal. Sidoqoftë, grupet që u prekën më tepër nga këto çrregullime e po ndeshen tani me vështirësitë e sotme në tregun e punës: janë ato të moshave 19 – 24 vjeçare. Megjithëse duke parë se adoleshentët (mosha 15 deri 19) po ndeshen me nivele edhe më të larta papunësie do të thotë se edhe nën sistemin e ri të edukimit të diplomuarit hasin vështirësi në gjetjen e një pune.

5.28 Ka patur një progres të konsiderueshëm në zgjidhjen e problemeve të rehabilitimit dhe përtëritjes së objekteve shkollore, teksteve shkollore dhe trajnimit të mësuesve. Në vitin 2003, 16 përqind e shpenzimeve qeveritare u përdorën për shkollimin dhe kjo është një shifër e lartë po të krahasohet me rajonin. Për më tepër, nuk ka asnjë provë përfundimtare se financimi i pakët i programeve shkollore lidhet me papunësinë e lartë të të rinjve. Megjithatë do të nevojitej shqyrtim i mëtejshëm për të nxjerrë ndonjë përfundim, mund të thuhet se efektshmëria dhe barazia e shpenzimit në punësimin e të rinjve janë shumë më të rëndësishme sesa niveli i përgjithshëm i shpenzimeve.<sup>65</sup>

5.29 Një hipotezë alternative është se kërkuesve të punës që nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune u vishet një rrezik më i madh nga ana e punëdhënësve, si rezultat i një dështimi në sinjalizimin e shkollimit të shkaktuar nga mungesa e një sistemi çertifikimi të daljes nga shkollimi të provuar dhe të testuar. Megjithatë anketimet e biznesit tregojnë se shumica e punëdhënësve kanë vlerësim më të madh për punëtorët sa më i lartë të jetë niveli i shkollimit të tyre. Shumica e konsideron si shumë të mirë performancën e punëtorëve me arsim universitar, dhe shumë të mirë ose mesatar shkollimin e mesëm, që tregon se sistemi i edukimit ende siguron një efekt sinjalizues të besueshëm. Megjithatë mungesa e njohurive praktike konsiderohej si problemi kryesor së bashku me rekrutimin

---

<sup>65</sup> Shikoni Kolev dhe Sagent (2003)

e të diplomuarve të rinj. Mungesa e eksperiencës së punës sidomos kur kombinohet me aftësi të pakta, do të paraqiste një barrierë për t'u punësuar për ata që dalin nga shkolla.

**Tabela 5.2: Vlerësimi i Punëtorëve sipas Kualifikimit në Shkollimin Formal**

<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Universitet (%)</b>	<b>Shkollim i mesëm (%)</b>
Shumë mirë	72.5	32.1
Mesatar	26.2	60.9
I pakënaqur	1.3	7.0
N.A.	---	---
Totali	100	100

*Burimi:* Promovimi i Zhvillimit Ekonomik Nëpërmjet Shoqërisë Civile: Faza e dytë: Rezultatet e Anketimit të Ndërmarrjeve Private të Vogla e të Mesme (NVM) në Kosovë, RIINVEST, Dhjetor 2002;

**5.30 Në përgjithësi ne mendojmë se vëzhgimet e sektorit të NVM-ve nuk tregojnë që aftësitë e fuqisë punëtore janë një pengesë kryesore e biznesit të tyre.** Kjo nuk është befasuese meqenëse shumica e ndërmarrjeve merren me operacione me aftësi të ulta, dhe mbetet të shihet nëse fuqia punëtore do të konsiderohet njësoj, sidomos për të rinjtë, a i kanë aftësitë e duhura në ndërmarrje të reja që bazohen në shërbime si p.sh., në sektorët e financave dhe IT (kompjuterë & informatikë).

5.31 Mbizotërimi i sektorit të NVM-ve në krijimin e vendeve të reja të punës ngre pyetjen nëse të rinjtë ndeshen me ndonjë pengesë të veçantë ndaj vetëpunësimit siç janë, (i) mungesa e aftësive të biznesit, (ii) vështirësi në sigurimin e fondeve fillestare dhe (iii) rrjete dhe kapital social më të kufizuar. Ndonëse kjo mund të jetë e vërtetë për vendet e rajonit nuk u mbështet nga faktet në Kosovë. Pjesa e vetëpunësimit në punësimin total është aktualisht më e lartë për të rinjtë sesa është edhe për të rriturit.<sup>66</sup>

5.32 Si përfundim, mund të jetë arsyeja se të rinjtë janë të gatshëm të shpenzojnë më shumë kohë të papunë ndërkohë që kërkojnë për ndonjë punë. Ndërkohë që në Kosovë nuk ekziston asnjë skemë ndihme papunësie, prezenca e remitancave nga familjarët në të ardhurat e familjeve mund ta ngrejë pagën e rezervuar për të papunët duke përfshirë të rinjtë. Për më tepër të ardhurat nga puna sezonale ose puna në sektorin jo formal mund të krahasohet në mënyrë të favorshme me pagën e punëtorëve fillesatarë në sektorin joformal. Këto të gjitha janë çështje që do të mund të përfitonin nga një shqyrtim i mëtejshëm, por që shkojnë përtej synimit të këtij raporti.

## **E. REKOMANDIMI I POLITIKAVE**

5.33 Propozohen rekomandimet e politikave të mëposhtme:

<sup>66</sup> Lexoni Kolev dhe Sagent (2003).

- T'i rezistohet futjes së sigurimit ndaj papunësisë ose asistencës. Pasiguria që rrethon riskun fiskal në të ardhmen, dhe nevoja për të qënë të kujdesshëm me shpenzimet e tashme publike bëjnë që këto premtime financiare të mëdha bazuar në fonde publike, të jenë zgjidhje politike jo tërheqës në këtë moment kohor. Për më tepër, duke patur parasysh nivelet e larta të papunësisë dhe nevojës për të siguruar një fuqi punëtore konkurruese në rajon, nuk është koha e duhur që të bëhen shtesa të tatimit mbi paga dhe kostos së punës.
- Fuqizimi i përfitimeve të asistencës sociale për t'i ndihmuar më shumë të varfërit duke përfshirë të papunët që janë gjithashtu të varfër.
- Të përmirësohet lëvizshmëria e punës duke përmirësuar Sistemin e Informimit të Tregut të Punës dhe lidhjeve me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Arsimit. Të dhënat duhet të përdoren bashkë me informacionet nga vëzhgimi i ndërmarrjeve për të përmirësuar shënjestrën e trajnimit profesional në qendrat e punësimit dhe në këtë mënyrë të thjeshtohet kërkimi i punës.
- Meqënëse punësimi i të rinjëve dhe grave është shqetësim, të ndiqen ndërhyrjet më kosto sa më efektive për të përmirësuar nivelin e punësimit duke përmirësuar qasjen dhe cilësinë e edukimit të përgjithshëm parësor dhe dytësor.
- Të adresohet stafi i tepërt në NPP dhe NPSH dhe institucione të tjera publike në mënyrë gjithëpërfshirëse që e thjeshton transferimin e punëtorëve në aktivitete më produktive dhe brenda një zarfi të qëndrueshëm fiskal.

## **STANDARDET për KOSOVËN**

"Një Kosovë ku të gjithë – pavarësisht nga prejardhja etnike, raca ose feja – janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, kërcënim ose rrezik dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë."

# Standardet për Kosovën

## I. Institucionet Demokratike Funktionale

Institucionet e Përkohëshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ) janë të lira, të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të drejtë. IPVQ, qeveris në mënyrë transparente dhe të duhur, në përputhje me RKSKB 1244 (UNSCR 1244) dhe me Kornizën Kushtetuese. Interesat dhe nevojat e komuniteteve të Kosovës përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të plotë në të gjitha degët dhe institucionet e qeverisë. Këto komunitete marrin pjesë të plotë në qeveri. Ligjet dhe funksionet e IPVQ u afrohen standardeve Europiane. IPVQ ofron shërbime për të gjithë njerëzit në Kosovë anembanë territorit të Kosovës; strukturat paralele janë shpërbërë.

### Zgjedhjet

- Zgjedhjet janë të rregullta, transparente, të lira dhe të drejta, konform standardeve ndërkombëtare, duke lejuar pjesëmarrjen e plotë dhe të qetë të të gjitha komuniteteve dhe grupeve etnike.
- Personat e zhvendosur brenda Kosovës dhe refugjatët vazhdojnë që të jenë plotësisht të përfshirë në procesin zgjedhor në Kosovë dhe u jepen mundësi të lehtësuara për të votuar.
- Një Komision Qendror Zgjedhjesh i pavarur, me përfaqësues shumë etnikë administron zgjedhjet.
- Një sërë partish politike demokratike marrin pjesë në zgjedhje.
- Një kornizë ligjore e përshtatshme mbulon veprimet e partive politike dhe financimet.

### Institucionet e Përkohëshme të Vet-Qeverisjes (IPVQ)

- Të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në mënyrë proporcionale në të gjitha nivelet e IPVQ, në përputhje me legjislacionin e aplikuar. IPVQ-ja dhe qeveritë lokale komunale vendosin dhe miratojnë legjislacionin në mënyrë të hapur dhe demokratike.
- Të gjitha gjuhët zyrtare respektohen në të gjitha institucionet qeverisëse.
- IPVQ dhe komunat sigurojnë sigurimin e shërbimeve publike bazë, të tilla si kujdesi shëndetësor, shërbimet publike dhe edukimi, pa diskriminim për të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Shërbimi civil është profesional, i paanshëm dhe i përgjegjshëm, përfaqëson të gjitha komunitetet në Kosovë dhe përshin një numër të konsiderueshëm femrash.
- Të gjitha komunitetet kanë mundësi të barabarta punësimi në institucionet publike.
- Kodet e etikës dhe procedurat zbatuese egzistojnë për të siguruar një qeverisje të duhur dhe transparente; rekomandimeve të Avokatit të Popullit u kushtohet vëmendja e duhur.
- Kontrollat të pavaruara dhe të rregullta të BKK, kuvendit, institucioneve qeveritare dhe komunave.

- Akuzat për sjellje jo etike hetohen plotësisht, zyrtarët e zgjedhur dhe nëpunësit publikë përgjegjës për sjellje jo etike, mashtrim ose korrupsion ndëshkohen si duhet.
- Legjislacioni i propozuar nga Kuvendit rishihet dhe miratohet nga Komisioni i Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve përpara se të miratohet nga Kuvendi.
- Femrat marrin pjesë në institucionet e IPVQ në nivele të barabarta ose më të larta se sa në vendet e rajonit dhe interesat e femrave pasqyrohen plotësisht në politikat dhe legjislacionet e IPVQ.
- Propozimet e Këshillit të Europës mbi decentralizimin janë shqyrtuar dhe marrë në konsideratë me qëllimin për të krijuar struktura funksionale të qeverisë lokale.
- Strukturat paralele që ofronin shërbime të ndryshme janë shpërbërë ose janë integruar në strukturat e IPVQ.

#### Media dhe Shoqëria Civile

- Ekziston një numër mediash të pavaruara, të shkruara dhe të transmetuara, të cilat sigurojnë informacion për të gjitha komunitetet në të gjithë Kosoën.
- Ka një autoritet rregullator efektiv dhe të pavarur të mediave, që synon standartet Europiane, i krijuar pa diskriminim dhe në përputhje me meritat.
- Fjalimet që shprehin urrejtje, ose çdo lloj nxitjeje, dënohet nga liderët politikë, autoriteti rregullator i mediave dhe nga vetë gazetarët.
- Mediat e financuara nga publiku u ndajnë të gjitha komuniteteve etnike një pjesë të plotë dhe proporcionale të burimet dhe të prodhimeve.
- Organizatat jo-qeveritare, veçanërisht ato që përfaqësojnë minoritetet, kanë mundësi që të veprojnë lirisht brenda ligjit dhe individë të ndryshëm kanë mundësi që t'u bashkangjiten atyre pa diskriminim.

## II. Sundimi i ligjit

Ekziston një kornizë ligjore e shëndetshme dhe zbatim i efektshëm i ligjit, në përputhje me standartet Europiane. Sistemet e policisë, ato gjyqësore dhe penale veprojnë paanshmërisht dhe respektojnë plotësisht të drejtat e njeriut. Ka akses të barabartë të drejtësia dhe askush nuk është sipër ligjit: nuk ka mosndëshkim për thyerësit e ligjit. Janë vendosur masa të forta për të luftuar krimin e motivuar-etnikisht, si dhe krimin ekonomik e financiar.

Akses i barabartë të drejtësia

- Të gjitha krimet hetohen plotësisht, pavarësisht nga prejardhja etnike e viktimës ose autorit të krimit.
- Vënia para drejtësisë dhe dënimi i autorëve të krimit është i qëndueshëm dhe efektiv, pavarësisht nga prejardhja etnike e viktimës ose autorit të krimit.
- Është bërë progres substancial në zgjidhjen e vrasjeve më serioze dhe sulmeve ndaj anëtarëve të minoriteteve etnike.
- Dëshmitarët të mbrohen në mënyrë të efektshme nga kërcënimet dhe ndëshkimet.
- Nivelet e qartësimi të krimeve për krimet e dhunës ndaj personave të të gjitha komuniteteve janë gati të barabarta.
- Sjellja e keqe nga ana e gjykatësve, prokurorëve, policëve dhe punonjësve të sistemit penal hetohen sistematikisht dhe dënohen në mënyrën e duhur.
- Ka kode profesionale të sjelljes për gjykatësit, prokurorët, avokatët dhe anëtarë të tjerë të policisë dhe sistemit penal, duke përfshirë një Shoqatë Avokatore përfaqësuese e të tërë komuniteteve në Kosovë.
- Aktet e ndërkohësve ndaj individëve të përfshirë në procesin disiplinor janë të rralla dhe individë të tillë mbrohen në mënyrën e duhur.
- Të gjitha komunitetet prezantohen plotësisht dhe në mënyrë të drejtë mes gjykatësve, prokurorëve dhe në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK)
- Funkcionojnë institucionet për trajnimin dhe edukimin e policëve, gjykatësve, avokatëve, dhe menaxherëve të sistemit penal.
- Një system i efektshëm dhe i paanshëm i drejtësisë në sektorin ligjor civil është i hapur për të tërë anëtarët e komuniteteve në Kosovë.
- Numri i çështjeve civile të prapambetura në gjykata po ulet në mënyrë të vazhdueshme.
- Po zbatohen vendimet në çështjet civile, po funksionojnë oficerët gjyqësorë zbatues, dhe gjobat e dhëna nga gjykatata po paguhen sistematikisht
- Legjislacioni që ka të bëjë me çështjet civile po rishikohet dhe plotësohet për të siguruar pajtueshmërinë me standartet Europiane.
- Alternativat ndaj daljes në gjyq për zgjidhjen e konflikteve po zhvillohen shpejt dhe po përdoren me efikasitet.

- Ndërmerren veprime të efektshme për eliminimin e dhunës ndaj femrave dhe femijëve, trafikimin dhe format e tjera të shfrytëzimit, duke përfshirë edukimin preventiv dhe sigurimin e shërbimeve ligjore dhe sociale për viktimat.

#### Askush nuk del mbi ligjin

- Të gjitha krimet, veçanërisht ato të dhunës që nxisin urrejtjen ndër-etnike dhe frikën hetohen dhe zgjidhen plotësisht, dhe shkaktarët vihen para drejtësisë dhe dënohen.
- Incidentet e krimit të organizuar, trafikimit, krimit që ka për rrënjë ekstremizmin, terrorizmin dhe krimin ekonomik hetohen plotësisht dhe gjykatësit e prokurorët lokalë në mënyrë efektive i gjykojnë dhe dënojnë shkaktarët. Përqindja e rasteve të pazgjidhura të rrënjëve të krimit në ekstremizëm ose terrorizëm po bie në mënyrë të qëndrueshme.
- Shkaktarët e sulmeve ndaj gjykatësve, prokurorëve, oficerëve të SHPK-së dhe dëshmitarëve gjykohen drejtë në gjykatat lokale dhe u jepet dënimi i merituar.
- Mekanizmat e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtare funksionojnë për policinë dhe për autoritetet gjyqësore, përfshirë transferimin e të dyshuarve dhe të personave të dënuar, dhe asistencën ligjore të dyanshme.
- Ka bashkëpunim të plotë me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish Jugosllavinë (GjNKJ), përfshirë arrestimin e të akuzuarve dhe dorëzimin e dëshmitarëve.
- Ata krime lufte të cilët nuk i adresohen GjNKJ-së gjykohen në mënyrë të drejtë në Kosovë.

#### Krimi Ekonomik dhe Financiar

- Konform me standartet e BE janë vendosur mekanizmat efektivë ligjorë, financiarë dhe administrativë për të kapur krimin ekonomik qoftë në sektorët privatë dhe ata publikë, përfshirë konfiskimin e asetëve të përfituara në mënyrë ilegale.
- Egziston një mirëkuptim midis masës më të madhe të nëpunësve të sektorit publik përsa i përket kërkesave të sjelljes etike, veçanërisht ato të cilat kanë të bëjnë me konfliktin e interesit.
- Mekanizma hetimi të posaçëm janë krijuar dhe po funksionojnë më së miri.
- Legjislacioni i pastrimit të parave po zbatohet në mënyrë efektive dhe ka hyrë në përdorim sistemi i raportimit të transaksioneve financiare të dyshimta.

### III. Liria e Lëvizjes

Të gjithë njerëzit në Kosovë mund të udhëtojnë, punojnë dhe jetojnë në siguri dhe pa ndonjë kërcënim ose frikë për sulm, ngacmim ose frikësim, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Ata mund ta përdorin gjuhën e tyre lirisht kudo në Kosovë, përfshirë vendet publike, dhe gëzojnë të drejtën e hyrjes pa pengesë në vendet e punës, tregjet, shërbimet publike dhe sociale dhe shërbime të tjera.

#### Liria e Lëvizjes

- Të gjitha komunitetet janë të lira të ushtrojnë të drejtat në shprehjet sociale, kulturore dhe fetare, përfshirë ndjekjen e ceremonive me pjesëmarrjen në vendet përkatëse.
- Eskortat policore dhe ushtarake nuk janë më te nevojshme; pjesëtarët e të gjitha komuniteteve etnike mund të përdorin në mënyrë të sigurtë transportin publik.
- Nënpunësit publikë nga komunitetet minoritare mund të punojnë pa vështirësi në zonat ku banon shumica e popullsisë.
- Numri i krimeve veçanërisht i atyre që lidhen me lëvizjet e minoriteteve (p.sh. incidentet me gurë) janë ulur në mënyrë të ndjeshme dhe nuk janë të shpeshta.
- Liderët politikë, pa vonesë, dënojnë dhe ndërmarrin veprime kundër akteve të dhunshme kundër komuniteteve etnike dhe pjesëtarëve të tyre.

#### Përdorimi i lire i gjuhës

- Seancat e Kuvendit dhe komisioneve të tij mbahen në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Dokumentet komunalë dhe dokumentet ministrore janë përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Dokumentat personalë lëshohen në gjuhën e vetë marrësit.
- Shenjat zyrtare brenda dhe jashtë godinave komunale dhe ministrore janë të shprehura në të gjitha gjuhët zyrtare.
- Emrat e rrugëve, qyteteve, fshatrave, rrugëve dhe vendeve publike janë në shqip, serbisht dhe në çdo gjuhë tjetër të komunitetit që jeton atje në një numër të konsiderueshëm.
- Komunitetet dhe ministritë sigurojnë shërbime përkthimi të shkruar dhe me gojë për të gjitha komunitetet, përfshirë përkthimin e të gjithë dokumenteve zyrtare dhe përkthimin për të gjitha takimet zyrtare në gjuhët përkatëse.

#### **IV. Kthimet e Vazhdueshme dhe Të drejtat e Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre**

Pjesëtarët e të gjitha komuniteteve duhet jenë në gjendje të marrin pjesë aktive në jetën sociale, politike dhe ekonomike të Kosovës, dhe nuk duhet të përballen me kërcënime për sigurinë dhe mirëqënien e tyre bazuar në përkatësinë etnike. Të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur të cilët dëshirojnë të kthehen në Kosovë duhet t'u krijohen kushtet në siguri dhe me dinjitet.

#### Të drejtat

- Ligjet e Kosovës sigurojnë mbrojtje të plotë për të drejtat njerëzore dhe të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, në përputhje me standartet Europiane.
- Në përbërje të IPVQ-së është një strukturë gjithëpërfshirëse dhe efektive për të monitoruar në përputhje me të drejtat njerëzore dhe të komunitetit dhe për t'ju përgjigjur shkeljeve.
- Mekanizmat egzistues brenda komunave përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të komunitetit (Zyrat Komunale të Komunitetit, Komisionet e

Komuniteteve dhe Ndërmjetësuese të Asamblesë Komunale) kanë burime dhe staf të duhur dhe funksionojnë më së miri.

- Kosova bën pjesë ne procesin e implementimit të Këshillit të Evropës për Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe zbaton plotësisht rekomandimet e dala nga ky proces.
- Ka një shpërndarje të drejtë të burimeve komunale dhe ministrore për të gjitha komunitetet
- Tekstet shkollore inkurajojnë tolerancën dhe respektin për kontributin e të gjitha komuniteteve në historinë e Kosovës.

#### Kthimet

- Numri i komunave me kthime të vazhdueshme është në rritje, përfshirë një rritje të kthimit në zonat urbane, ritmi i kthimeve në përgjithësi rritet, dhe niveli i mosrealizimit të kërkesave për kthim është kryesisht në rënie.
- Të kthyerit në Kosovë mund të marrin pjesë në ekonominë dhe në tregun e punës pa diskriminim dhe kufizim të lirisë së lëvizjes. Kujdesi shëndetësor, shërbimet sociale, shërbimet publike dhe të edukimit u ofrohen të kthyerve në nivel të barabartë me pjesën tjetër të popullatës.
- Të kthyerit nuk përballen me një rrezik më të madh dhune sesa popullata në tërësi, dhe policia dhe sistemi gjyqësor reagojnë pa vonesë dhe pa diskriminim kundrejt krimeve, pa pasur parasysh përkatësinë etnike të viktimës.
- Komunat dhe departamentet janë në gjëndje të marrin përgjegjësi për kthimet brenda të gjitha komuniteteve në përputhje me standartet Europiane.
- Është krijuar një fond nga BKK për të mbështetur projektet e kthimit dhe komunitetet më të vogla.
- Mbështetja e hapur për procesin e kthimit nga liderët e komuniteteve dhe përpjekjet për informim publik të mbështetura nga IPVQ krijojnë një klimë tolerance dhe mbështetje për të drejtën për tu kthyer.
- Mbështetja e IPVQ për kthimet, duke përfshirë ndihmën financiare, shpërndahet në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet.

#### V. Ekonomia

Korniza ligjore për një ekonomi tregu të qëndrueshme dhe konkurruese është gati dhe po zbatohet. Kushtet themelore minimale janë një bazë ligjore dhe institucionale e cila të veprojë pa diskriminim kundër çdo individ ose kompanie; një ndihmës sistemi rregullator për biznesin që është në gjëndje të mbajë përgjegjës si zyrtarët qeveritarë ashtu edhe sektorin privat; një regjim taksash që ruan funksionet themelore të qeverisë dhe një infrastrukturë e cila siguron shërbimet bazë dhe lehtëson investimin. Qëllimi është për ta çuar Kosovën drejt arritjes të standarteve Europiane.

- Legjislacioni ekonomik bazë është gati dhe po përdoret.
- Janë duke funksionuar institucionet qeveritare dhe shërbimet kryesore.
- Procesi buxhetor po funksionon në përputhje me kërkesat ligjore.
- Statistikat ekonomike janë transparente dhe publikohen rregullisht, duke përfshirë PBB-në, inflacionin, tregtinë dhe papunësinë.

- Privatizimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve në Pronësi Shoqërore janë në rrugë të mbarë; Autoritetet Komunale dhe strukturat e njëjta qeveritare mbështesin një kalim gradual dhe të besueshëm të drejtave të pronësisë.
- Ristrukturimi i Ndërmarrjeve me Pronësi Publike, bazuar në një auditim të pavarur, po shënon progress dhe mbështetet plotësisht nga IPVQ.
- Mbikqyrja mbi biznesin bankar, sigurimet dhe skemën e pensioneve është i besueshëm dhe efektiv.
- Faturimet e përgjithshme në Kosovë i afrojnë te 100% të shërbimeve të siguruar nga KEK, PTK dhe ndërmarrjet publike të ujësjellësit, dhe mbledhja e faturave është të paktën në nivelin e fqinjëve.
- Të ardhurat nga taksat e financojnë plotësisht buxhetin aktual, dhe një pjesë të madhe të investimeve publike.
- Treguesit e pajtueshmërisë me taksat janë duke u përmirësuar dukshëm.
- Rritja e të ardhurave nuk ndikohet nga influenca politike.

## VI. Të drejtat mbi Pronën

Ushtrimi i të drejtës së pronës është themelor për të inkurajuar kthimet dhe trajtimin e barabartë të të gjitha komuniteteve etnike. Kjo kërkon që të ketë legjislacionin e duhur, që të ketë mekanizma të efektshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi pronën; që pronarët e ligjshëm të tokave për banim, të tokave komerciale dhe të tokave bujqësore të kenë mundësi që t'i marrin ato dhe të ketë një sistem të saktë për transferimin hipotekimin dhe regjistrimin e pronës po ashtu edhe parandalimin e shitjes së pasurisë me forcë.

Të drejtat e pronës.

- Legjislacioni në përdorim është në përputhje me standartet europiane.
- Zaptuesit ilegalë janë zburuar nga pronat dhe ato u janë kthyer pronarëve të ligjshëm.
- Gjyqet komunale i zgjidhin çështjet e pronësisë pa diskriminim kundrejt komuniteteve minoritare dhe këtë e bëjnë këtë në një nivel të krahasueshëm me sistemet gjyqësore europiane.
- Policia i zbaton këto vendime vazhdimisht dhe pa ndonjë diskriminim.
- Drejtoria e Pronave dhe Shtëpive dhe Komisioni i Ankesave për Pronat dhe Shtëpitë në mënyrë efektive i kanë zgjidhur të gjitha rastet e prapambetura.
- Ka një sistem efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tokave bujqësore dhe atyre komerciale.
- Ekziston një regjistër i të drejtës së pronës i cili funksionon dhe ka përfunduar ekzaminimi i kadastrave komunale.
- Autoritetet komunale kanë ndaluar përpjekjet e paligjshme ose të pajustificuara për të zhvilluar toka publike të cilat janë prej një kohë të gjatë vendbanime joformale të komuniteteve minoritare ose të grupeve të tjera të cënuara.
- Vendbanimet joformale të grupeve të minoriteteve të cënuara janë legalizuar dhe rregulluar.

Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore

- Trashëgimia kulturore e Kosovës respektohet si pasuri e përbashkët e të gjitha komuniteteve etnike fetare dhe gjuhësore të Kosovës.
- Të gjitha komunitetet kanë të drejtë të ruajnë, restaurojnë dhe mbrojnë vendet me rëndësi për kulturën e tyre, trashëgiminë fetare dhe historike me ndihmën e autoriteteve përkatëse (IPVQ), në përputhje me standartet Europiane.
- Nuk do të ketë diskriminim dhe trajtim të veçantë për pasuritë e trashëguara kulturore të asnjë komuniteti.

## VII. Dialogu

Ka një dialog konstruktiv dhe të vazhdueshëm ndërmjet IPVQ dhe homlogëve të tyre në Beograd mbi çështjet praktike. Është zhvilluar më tej bashkëpunimi i Kosovës brenda rajonit. Dialogu Beograd – Prishtinë

- Ka takime të rregullta të grupeve të punës (fillimish katër: personat e zhdukur, kthimet e të shpërngulurve, energjia dhe transporti & komunikacionet) dhe të gjitha grupet e punës janë multietnike.
- Takimet zhvillohen në atmosferë bashkëpunimi konstruktiv, duke respektuar rregullat procedurale dhe duke përdorur ekspertizën ndërkombëtare në dispozicion.
- Grupet e punës bëjnë progres në zgjidhjen e çështjeve praktike të shqetësimeve të përbashkëta.

Rajonale

- Janë bërë marrëveshje funksionale për të siguruar bashkëpunim të avancuar në fushat e: lirisë së lëvizjes (përfshirë kalimet kufitare), tregëtisë dhe ekonomisë, policisë dhe drejtësisë, administrimit publik, dhe shkëmbimeve parlamentare rajonale. Ka një pjesëmarrje në marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale për të mirën e stabilitetit në rajon.

## VIII. Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) përmbushin mandatin e tyre, i cili është i caktuar në Kornizën Kushtetuese, si “ një organizatë civile për emergjencë, e cila e cila kryen në Kosovë detyra e veprimit të shpejtë në rastet e fatkeqësive për siguri publike në kohë emergjence dhe asistencë humanitare.” TMK vepron në mënyrë transparente, të disiplinuar dhe profesionale dhe është përfaqësuese e të gjithë popullatës së Kosovës. TMK është e aftë të veprojë me disiplinë dhe financohet plotësisht në mënyrë transparente.

- TMK ushtron funksionet e mandatuara në përputhje të plotë me rregullat e vendosura me ligj.
  - Të gjitha komunitetet e Kosovës janë plotësisht dhe më së miri të përfaqësuara në TMK pa qënë subjekt diskriminimi.
  - Financimi është transparent dhe i audituar në mënyrë të pavarur.

- Numri i përfaqësive të TMK-së është ulur me të paktën një të tretën; numri i kontigjentit është ulur me 3,052 pjesëtarë aktivë dhe 2,000 pjesëtarë rezervistë.
- Sjelljet e papëlqyeshme dënohen, në bazë të një Kodi Disiplinor dhe një Sistemi Rishikimi të Zbatimit të Punës. TMK ka nisur një fushatë gjithëpërfshirëse rekrutimi në komunitetet etnike minoritare.
- TMK i ka kushtuar një pjesë proporcionale të aktivitetit rindërtues komuniteteve etnike minoritare.
- Është miratuar dhe zbatuar një Rregullore për Ligjin e Shërbimit për pjesëtarët aktivë dhe rezervistë.

## REFERENCA

- Banka Botërore. 2003a. “Politikat dhe Institucionet Tregtare në vendet e Europës Juglindore në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit në BE.” Washington, D.C.
- Banka Botërore. 2003b. “Studimi i Tregut të Punës në Kosovë: Sfidat e Politikave për Punësim Formal dhe Joformal.” Washington, D.C.
- Collier, P., dhe A. Hoeffler. 2002. “Ndihma, Politika, dhe Rritja në shoqëritë Postkonfliktuale.” Dokument Punues i Hulumtimeve të Politikave. Banka Botërore, Washington, D.C.
- Demekas, D.G., Herderschee, J. dhe D. F. Jacobs. 2002. “Institutet dhe Politikat për Rindërtim dhe Rritje.” Fondi Monetar Ndërkombëtar, Washington, D.C.
- Kolev, A. dhe C. Sagent. 2003. “Drejt një Kuptimi më të Mirë të Natyrës, Shkaqeve dhe Pasojave të Disavantazheve të Tregut të Punës për të Rinj: Evidencë për Europën Juglindore.” Mimeo e Bankës Botërore, Washington, D.C.
- Michaolpoulos, C. 2003. “Një Strategji për Integrimin e Tregtisë në Europën Juglindore: Arritjet dhe Sfidat e Ardhshme.” ELIAMEP Dokument i Politikave Nr 4.
- RIINVEST. 2002. “Investimet e Huaja Direkte në Kosovë.” *Raport Hulumtues*, Prishtinë.
- RIINVEST. 2003a. “Politikat Tregtare dhe Nxitja e Eksporteve në Kosovë.” *Raport Hulumtues*, Prishtinë.
- RIINVEST. 2003b. “Tregu i Punës dhe Papunësia në Kosovë.” *Raport Hulumtues*, Prishtinë.
- Rojas-Suarez, L. 2003. “Politika Monetare dhe Kurset e Këmbimit: Parimet Drejtuese për një Regjim të Qëndrueshëm” në Pas Konsensusit të Washington-it: Rifillimi I Rritjes dhe Reformës në Amerikën Latine, edituar nga P. Kuczynski dhe J. Williamson, 2003.